

Komiteti i juristëve për të drejtat e njeriut
PETICIONET DHE PROPOZIMET: E DREJTA DHE PRAKTIKA

Botues

Komiteti i juristëve për të drejtat e njeriut

Svetogorska 17, 11000 Beograd

Tel: +381-11-3344-235

Fax: +381-11-3344-425

E-mail: yucomoffice@gmail.com

Web site: <http://www.yucom.org.rs/>

Për botuesin

Milan Antonijević

Këshilli editorial

dr Dejan Milenković

Katarina Golubović

Hana Čopić

Nina Đurđević Filipović

Përpunimi grafik

Wolfgang Klotz

Shtypi

„Dosije studio“, Beograd

Tirazhi 500

COBISS.SR - ID 180209420

ISBN 978-86-83-209-31-6

Këtë manual e kanë përgatitur Komiteti i juristëve për të drejtat e njeriut dhe Fondacioni Hajnrih Bell në kuadër të projektit „Përfshirja e qytetarëve dhe qytetareve në jetën shoqërore dhe politike përmes përfaqësimit të të drejtave në peticione dhe propozime“, i cili realizohet me ndihmën financiare të Unionit Evropian.

Përbajtja e këtij dokumenti paraqet vetëm përgjegjësinë e YUCOM-it, Hajnrih Bellit dhe partnerëve të tyre projektues dhe në asnjë mënyrë nuk paraqet qëndrimet e Unionit Evropian.

Peticionet dhe propozimet e drejta dhe praktika



Beograd • 2010

 **YUCOM** | Lawyers' Committee
for Human Rights



 **HEINRICH BÖLL STIFTUNG**
JUGOISTOČNA EVROPA

PËRMBAJTJA

Peticionet dhe propozimet – e drejta dhe praktika

	Parafjala	5
	Fjala e deputetes popullore	8
	Mbi projektin	11
1.	DEMOKRACIA E DREJTPËRDREJT	13
1.1.	Format e demokracisë së drejtpërdrejt në Serbi	13
1.2.	Demokracia e drejtpërdrejt – studim komparativ	23
1.3.	Peticionet dhe propozimet si instrumente të demokracisë së drejtpërdrejt	28
1.4.	Koncepti	32
2.	SERBIA: E DREJTA DHE PRAKTIKA	40
2.1.	Si veprohet me peticionet dhe propozimet	40
2.1.1.	Niveli republikan	41
2.1.2.	Niveli krahinor	53
2.1.3.	Niveli lokal	66
2.2.	Procesi i bërjes së peticioneve dhe propozimeve	81
2.2.1.	Mendimi i Komisionerit për informacione me rëndësi publike dhe mbrojtjen e të dhënave mbi personalitetin	82
2.2.2.	Hulumtimi i YUCOM-it	85
3.	DREJTËSIA E UE DHE DREJTËSIA KRAHASUESE	90
3.1.	Çka e përbën demokracinë?	90
3.2.	UE – shkruarja e peticionit Parlamentit evropian	91
3.3.	Shembulli i praktikës së mirë: Zelanda e Re	98
3.4.	Shembulli i praktikës së mirë: Bremen	105
3.5.	Shembulli i praktikës së keqe: Kalifornia	112
3.6.	Shembulli i praktikës së keqe: Hamburg	117
4.	REKOMANDIMET	119

Publikimi „*Peticionet dhe propozimet – e drejta dhe praktika*“ është paraqitur në kuadër të realizimit të projektit „Përfshierja e qytetarëve dhe qytetareve në jetën shoqërore dhe politike përmes transparencës së përfaqësimit të së drejtës në peticione dhe paraqitje“. Projekti realizohet nga ana e Komitetit të juristëve për të drejtat e njeriut dhe Fondacioni Hajnrh Bell duke filluar nga dhjetori i vitit 2009, me përkrahje financiare të Delegacionit të Unionit Evropian në Serbi.

Publikimi paraqet rezultatin e kontributit të të gjithë akterëve¹ të cilët kanë marrë pjesë në realizimin e projektit:

☞ Përfaqësuesve të organizatave joqeveritare dhe sindikateve, gazetarëve dhe qytetarëve të interesuar (*Panonija, LSVO NS, Fondi për zhvillimin e sektorit jopropitabil, Rrjeti i gjelbër i Vojvodinës, Klubi i Vojvodinës, Qendra edukative e Zrenjaninit, Këshilli i Helsinkut për të drejtat e njeriut – Novi Sad, Oaza e sigurisë, OUP Sloga, Shoqata e paraplegjikëve dhe kuadriplegjikëve „Kraguj“, Asociacionet e studentëve, NEC – RP, Nga rrethi Kragujevc, Qendra Informativë Rome, Shoqëria romo-serbe „Stablo“, Iniciativa e të rinjve për të drejtat e njeriut (Preshevë), Shoqata e distrofikëve Nish, Këshilli për të drejtat e njeriut Nish, Shoqata e shoqërisë serbo-bullgare „Rila“, Shoqata e luftëtarëve të luftës së vitit 1999 Nish, Shoqata e romeve „Osvit“, Shoqata e nënave të vetme Nish, Shoqata për zhvillimin e kreativitetit, Shoqata për mbrojtjen e ambientit jetësor „Stara Planina“ – Piro, Shoqata qytetare e paralizës cerebrale tek fëmijët, Lëvizja evropiane në Serbi – Nish, Link Publishing, Bashkë bashkë, Bibija, CRNPS, Iniciativat qytetare, Qendra për demokraci, Rinia e gjelbër e Serbisë, Eko Urban, Qendra regjionale, Sindikati i pavarur i punëtorëve rrugor të Serbisë, Sindikati „Sloga“, Online solutions, Femrat në veper, Qendra regjionale për pakica, UG Përgjegjësia për ardhmëri, Asociacioni i sindikateve të lira dhe të pavarura – ASNS) të cilët morrën pjesë në punëtoritë dhe morrën pjesë në hulumtimin e praktikës së deritanishme të veprimit sipas peticioneve dhe propozimeve gjatë muajve shkurt-mars 2010;*

1 Autorët dhe autoret e këtij publikimi, para së gjithash për shkak të ekonomicitetit, kanë vendosur të përdorin gjuhën neutrale nga aspekti gjinor, por e konsiderojnë të detyrueshme të cekin që gjatë shfrytëzimit të këtij formulimi në asnjë mënyrë nuk përjashtojnë asnjë gjini, prandaj lusin lexuesit dhe lexueset që ta kenë parasyshë gjuhën sensitivo-gjinore.

- ☞ Përfaqësuesve të qeverisë republikane, organeve krahinore dhe organeve të njësive të qeverisë lokale (*Ministrisë së mbrojtjes, Kuvendit të KA të Vojvodinës, Fondit për zhvillimin e sektorit joprofitabil APV, Fondit për zhvillimin e KA të Vojvodinës, Sekretariatit krahinor për arsim, Sekretariatit krahinor për punë, punësim dhe barazi gjinore, Sekretariatit krahinor për arkitekturë, urbanizëm dhe ndërtimtari, Zyra e mbrojtësit të qytetarëve të Kragujevcit, Mbrojtësja e qytetarëve të Nishit, Zyra e mbrojtësit të qytetarëve Nish, Mbrojtësja e qytetarëve Të Vracarit, administrate e qytetit të Kragujevcit, Enti republikan për statistikë – reparti në Kragujevc dhe zëvendësja e prefektit të Kragujevcit, komuna Bač, shërbimi informativ i qytetit të Kragujevcit, Kuvendi komunal i komunës së Preshevës, administrate e qytetit të Nishit, Sekretari i këshillit komunal, Kuvendi komunal i Nishit, Këshilli i qytetit LDP-Nish, Komuna e Pantelejit – Nish, Komuna e Medianës, NP „Enti për ndërtimin e qytetit” – Novi Sad), organizatat joqeveritare dhe gazetarët (Nga rrethi, Qendra edukative e mospirjes së dubanit, Asociacioni studentor, Qendra informative rome, OUP Sloga, Shoqata e paraplegjikëve dhe kuadriplegjikëve Kragujevc, Šumadija Press, P.A.K. Kragujevac, Organizata e skautëve Rodoljub Boba Popović, Stablo, DZS „Mali i lashtë“, Shoqata „Rila“, Këshilli për të drejtat e njeriut Nish, Shoqata e qytetit për fëmijët me paralizë cerebrale – Nish, Shoqata e lufëtarëve të luftës së vitit 1999 – Nish, Koalicioni kombëtar për decentralizim, Qendra studentore rome, Shoqata e nënave të vetme Nish, Protecta, Lëvizja evropiane në Serbi – Nish, Klubi i Vojvodinës, Këshilli i Helsinkut për të drejtat e njeriut në Serbi, Esperanca, NDNV, Iniciativa e të rinjve për të drejtat e njeriut – Preshevë, gazetarët e pavarur, Kombet e Bashkuara OHCHR, Sindikatet e bashkuara të Serbisë Sloga, Peščanik, Fraktal, Fondi për të drejtë humanitare, Shkolla e hapur e Beogradit, Miqtë e fëmijëve Vozhdovac, Miqtë e fëmijëve Zemun, Qendra e Beogradit për të drejtat e njeriut, Cemir, Iniciativat qytetare, punëtorja EcoUrbana OJQ, Gratë në të zezë, Qendra Queeria, Këshilli i Helsinkut në Serbi – Beograd, Monitor, Praxis) të cilët morrën pjesë në panel diskutimet në Kragujevc, Nish, Novi Sad, Preshevë dhe Beograd gjatë muajve maj dhe qershor të vitit 2010;*
- ☞ Deputetëve të Parlamentit të Republikës së Serbisë Saša Dujović – kryetar i Këshillit për paraqitje dhe propozime;
- ☞ Deputetëve të KA të Vojvodinës Maja Sedlarević – nënkryetare e Kuvendit të KA të Vojvodinës dhe Milan Đukić – kryetar i Këshillit për paraqitje dhe propozime;
- ☞ Shërbimit profesional të Këshillit për paraqitje dhe propozime të Parlamentit të Republikës së Serbisë në krye me dr Novica Kulić dhe shërbimit profesional të Këshillit për paraqitje dhe propozime të KA të Vojvodinës në krye me zonjën Svetlana Popadić Ležimirac;

☞ Zyret e Komisionerëve për informacione me rëndësi publike dhe mbrojtjen e të dhënave mbi personalitetin.

Theks të vecantë dhe kontribut në realizimin e projektit kanë dhënë deputetja popullore Vesna Pešić dhe docenti i Fakultetit të shkencave politike dr Dejan Milenković (aktivist shumëvjeçar i YUCOM-it) përmes pjesëmarrjes në punëtori dhe panel diskutime, këmbimit të informacioneve dhe dhënien e mendimit profesional gjatë kohëzgjatjes së projektit dhe hartimit të këtij publikimi.

Të gjithë akterëve të Komitetit të juristëve për të drejtat e njeriut me partner Fondacionin Hajnrih Bell i falënderojmë për kontributin. Poashtu, i falënderojmë për ndihmën e dhënë në organizimin e panel diskutimeve Kuvendin e KA të Vojvodinës, Qytetin e Kragujevcit, Qytetin e Nishit dhe komunën e Preshevës, si dhe organizatën joqeveritare Shoqata demokratike e Romëve nga Beogradi dhe Iniciativën e të rinjve për të drejtat e njeriut në Preshevë, të cilat me angazhimin e tyre siguruan praninë e grupeve të pakicave në panel diskutimet.

Me përmbajtjen që ka, publikimin ia kushtojmë të gjitha qytetarëve dhe qytetarëve të Republikës së Serbisë. Përhapja dhe fuqizimi i ndikimit të të gjithë qytetarëve dhe qytetareve në politikat publike të Serbisë, ishte vetëm një nga qëllimet tona dhe qëndrimet e vlefshme të kryetares së Komitetit të juristëve për të drejtat e njeriut - Biljana Kovačević-Vučo e cila ndërroi jetë në prill të vitit 2010. E falënderojmë Biljanën për idetë e saj të qarta dhe fuqinë e madhe lëvizëse e cila do t'ia lehtësojë rrugën atyreve që ndjekin rrugën e saj në përfaqësimin e së drejtës në drejtësi.

Ekipe të YUCOM-it dhe Fondacionit Hajnrih Bell



Foto: Aleksandar Andić – Vreme

Kur më ftuan për herë të parë nga YUCOM-i dhe Fondacioni Hajnrih Bell që të flas mbi të drejtën në peticion në panelet e verës së vitit 2010 e pyeta veten athua kishin njohuri për faktin se në vitet e 80-ta kam shkruar mbi lëvizjen e peticionit dhe se libri edhe më tutje nuk është publikuar. Në ato vite të 80-ta, të qenit peticionues dhe shkruarja mb liritë dhe të drejtat e qytetarëve, si dhe të merresh publikisht me ato ishte ndërmarrje e rrezikshme. Peticionet qytetare politike në vitet e tetëdhjeta të shekullit të kaluar tundën tërë shtetin; takoheshin të gjitha komitetet e mundura partiake që të gjykojnë “peticionistët”, kurse unë isha peticioniste, gjegjësisht nënshkruaja peticione politike. Peticioni më i njohur ishte ai në të cilin kërkonim ndërprerjen e deliktit verbal, gjegjësisht nenin 133 të Ligjit penal, sipas të cilit ndokush vetëm për një fjalë të folur, vizatim apo këndim të të një këngeje ka mundur të fitojë burgim shumëvjeçar. Nuk janë burgosur njerëz për shkak të peticionit, por të dhënat mbi ata janë përpunuar dhe futur në dosje. Peticionet politike ishin të rrezikshme për regjimin e atëhershëm jodemokratik, ngase kishim gjetur metodën e lejuar që të kërkojmë demokraci, ngase edhe atëherë, sikurse sot peticionet ishin të garantuara me kushtetutë. Mirëpo askush nuk mendonte se peticionet, paraqitjet, kërkesat dhe ankesat e qytetarëve do të rriteshin në një lëvizje për liritë dhe të drejtat e qytetarëve.

Sot në Serbi mbizotëron mosndjeshmëria e qeverisë ndaj asaj të cilën e shprehin qytetarët përmes peticioneve politike, ndoshta edhe për arsye se sot ekzistojnë më shumë kanale përmes të cilave mund të dëgjohen kërkesat e tilla, nga zyret në bashkësitë lokale deri te institucionet e ombudsmanit, por sidoqoftë, përmes partive politike. Format e demokracisë së drejtpërdrejt janë përkeqësuar edhe me faktin se demokracia përfaqësuese në Serbi nuk është vendosur në baza demokratike. Neni 102 i Kushtetutës i dha zyrtarëve më të lartë të partive lirinë që të caktojnë se kush do ta fitojë mandatin e deputetit pas përfundimit të zgjedhjeve dhe, përmes atyre dorëheqjeve të zbrazëta, të ndikojnë vendosmërisht në veprimin dhe përcaktimin e deputetëve në

debatin parlamentar dhe në votim. Pasi që deputetët nuk mund të ndikojnë në atë se kush do të jetë deputet, por partitë, tani hasim në situatën absurde ku prej 250 deputetëve – 80 prej tyre janë nga qendra e Beogradit, derisa shumë komuna dhe territore të Serbisë nuk e kanë përfaqësuesin e tyre në parlament. Më tutje, madje edhe nëse ekziston përfaqësuesi në Parlament, një numër i vogël i qytetarëve dhe qytetareve mund të komunikojë në mënyrë direkte me deputetin e tyre (lokal). Dhe në fund, edhe pse deputetët kanë të drejtën që t'i bëjnë pyetje Qeverisë çdo javë (të martën dhe të enjten), së pari, sipas Rregullores duhet të marrin lejen e shefit të grupit deputetor para se t'u lejohet bërja e pyetjes. Demokracia deputetore në Serbi është e kufizuar, gjë që kufizon edhe demokracinë e drejtpërdrejt.

Në anën tjetër Këshilli i Kuvendit të Serbisë për paraqitje dhe propozime nuk ka mbajtur asnjë mbledhje që nga viti 2007 deri në maj të vitit 2010. Vetëm atëherë është zgjedhur ai Këshill dhe mundi të fillojë me punën. Peticionet dhe propozimet e qytetarëve i kanë pranuar zyrtarët e Kuvendit dhe me siguri ata i janë përgjegjur atyre, por organi zyrtar i Parlamentit nuk mund ta bënte një gjë të tillë ngase ende nuk ishte formuar. Në rendin e ditës së Kuvendit të Serbisë kurrë nuk është vendosur asnjë nga propozimet ligjore të organizatave joqeveritare, si dhe asnjë propozim ligji të cilin e ka dërguar Kuvendi i Vojvodinës, apo deputeti popullor, kurse kishte edhe iniciativa ligjore të qytetarëve të cilat poashtu nuk u shqyrtuan kurrë. Ky fakt më së miri flet mbi qëndrimin e organeve shtetërore ndaj iniciativave të qytetarëve dhe të drejtën e tyre kushtetuese në peticione.

Me iniciativën dhe përkrahjen financiare të Institutit demokratik nacional nga SHBA disa deputetë janë angazhuar në zyret lokale në disa qytete, dhe aty i kanë pranuar qytetarët dhe peticionet e tyre, propozimet dhe ankesat. Deputetët e angazhuar në atë mënyrë një apo dy herë në muaj i kanë pritur qytetarët në ato zyre, gjë e cila në njëfarë mënyre paraqet lëvizje në zhvillimin e formave të demokracisë së drejtpërdrejt, dhe kontaktit të qytetarëve me përfaqësuesit e Kuvendit. Qytetarët mund të komunikojnë drejtpërdrejt me deputetët në zyre, mirëpo problemi është se puna e tyre nuk shihet nëse qeveria komunale në qytet nuk është e partisë së njëjtë si deputetët. Kjo për arsye se pushtetet lokale janë më të gatshme që të zgjidhin ndonjë problem të qytetarëve nëse problemin ia përcjell deputeti i partisë së vet se sa nga opozita. Zgjidhjen e ndonjë problemi të qytetarëve e llogarisin si „fushatë për partinë e tyre“, në vend se si ndihmë për të gjithë qytetarët.

Në demokraci, demokraci të zhvilluara, e edhe në Serbi ku demokracia ende po zhvillohet, insistojmë në këtë të drejtë e cila është në të vërtetë një lloj i së drejtës elementare – që të keni të drejtë t'i drejtoheni zyrtarëve dhe të merrni përgjegje. Mendoj se kjo e drejtë është shumë e rëndësishme – sepse nëse keni sistem dhe zgjedhje

shumpartiake, nëse keni mekanizma tjerë të ndryshëm që të ndikoni në politikë, në jetën publike, por nuk mund ta shfrytëzoni të drejtën elementare që t'i drejtoheni organeve shtetore, atëherë nuk jam e sigurtë që ndonjëri prej atyre mekanizmave më komplekse dhe më moderne funksionon. E drejta e qytetarëve që t'i drejtohen organeve shtetore është shumë e rëndësishme prandaj dhe nuk ekziston asnjë sistem partiak i cili është aq i depërtueshëm dhe i cili mund të jetë aq i hapur që qytetarët më të mos kenë nevojë të përdorin të drejtën në peticion dhe iniciativa. Madje edhe po të merrnim situatat ideale dhe demokracitë ideale, gjithnjë do të vinim deri te ajo ku qytetarët kanë propozimet e tyre, kanë iniciativat e tyre, dëshirojnë të zgjidhin problemet e veta dhe ai është kanali i cili gjithmone duhet të jetë i rregulluar dhe i hapur në mënyrë që qytetarët edhe në demokracitë më të zhvilluara të mund të zgjidhin problemet e tyre.

Në fund do të theksoja që ky projekt është shumë i rëndësishëm pikërisht për arsye se merret me promovimin e së drejtës në peticion, e cila bën pjesë në korpusin e të drejtave jashtëzakonisht të rëndësishme për qytetarët dhe qytetaret. Kërkesat e tyre paraqesin pasqyrën e situatës momentale në shoqëri, kurse sipas hulumtimeve të cilat i kam bërë në Kuvendin popullor, numri më i madh i kërkesave është bërë falë faktit se qytetërimi është i pakënaqur me punën e organeve shtetore, privatizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe thyerjen e të drejtave punëtore. Në dy vitet e fundit, qytetarët dhe qytetaret ia kanë dorëzuar më shumë se një mijë lëndë Kuvendit popullor, kurse adresimi i vet deputetëve dhe deputeteve nuk është i zakonshëm. Në anën tjetër, qytetarët kanë shfrytëzuar të drejtën e tyre në iniciativë popullore, të garantuar me Kushtetutë. Mirëpo Parlamenti, në asnjërin nga ato raste nuk ka vendosur mbi ligjet të cilat i kanë propozuar qytetarët dhe qytetaret. Një situatë e këtillë nuk kontribuon në përmirësimin e shoqërisë demokratike në Serbi.

dr VESNA PEŠIĆ

Rreth projektit „Kyçja e qytetarëve dhe qytetareve në jetën shoqërore dhe politike përmes përfaqësimit të së drejtës për peticione dhe propozime“

Komiteti i juristëve për të drejtat e njeriut - YUCOM dhe Heinrich Böll Stiftung në muajin dhjetor të vitit 2009 kanë filluar projektin „Kyçja e qytetarëve dhe qytetareve në jetën shoqërore dhe politike nëpërmjet përfaqësimit të së drejtës për peticione dhe propozime“ që financohet nga Delegacioni i UE në Serbi. Kohëzgjatja e paraparë e projektit është 12 muaj.

Pas hulumtimit të implementuar të rregullativës juridike që rregullon realizimin e këtyre të drejtave të garantuara me kushtetutë dhe mbajtjes së 5 punëtorive gjatë shkurtit të vitit 2010 me përfaqësuesit e organizatave joqeveritare, sindikateve dhe publikut të gjërë në Beograd, Nish, Preshevë, Kragujevc dhe Novi Sad, është arritur konkluzioni që nuk ekziston kornizë juridike që rregullon këto të drejta, si edhe që praktika e veprimit me peticione dhe propozime të qytetarëve tregon në shkallë të lartë injorim të kësaj të drejte nga organet e qeverisjes publike.

Gjatë majit dhe qeshorit të vitit 2010, YUCOM dhe Heinrich Böll Stiftung kanë organizuar panel diskutime në qytetet e lartëpërmendura. Qëllimi i panel diskutimeve ka qenë krijimi i dialogut konstruktiv mes përfaqësuesve të qeverisjes publike dhe qytetarëve dhe qytetareve rreth modeleve të realizimit të së drejtës kushtetuese në dorëzim të peticioneve dhe propozimeve. Është provuar, që nëpërmjet dialogut konstruktiv të shmangen vetëm disa nga mëdyshjet që ekzistojnë: 1. a kanë organet e qeverisjes publike procedura që rregullojnë përgjigjet ndaj peticioneve dhe propozimeve tjera; 2. çfarë janë përvojat e organeve të qeverisjes publike me veprimet sipas peticioneve dhe propozimeve tjera; 3. cilat janë pengesat kryesore për dhënie të përgjigjes ndaj peticioneve dhe propozimeve.

Gjithashtu, gjatë kohëzgjatjes së projektit janë bërë disa sesione informative rradhazi me aktorët kyç të realizimit të kësaj të drejte. Rezultatet e këtyre aktiviteteve janë prezentuar në kapitullin e këtij publikimi.

Në të njëjtën kohë, YUCOM dhe Heinrich Böll Stiftung kanë inicuar internet portalin www.uticaj.rs. Internet portali uTicaj, së pari është paraparë për ata që dëshirojnë të vendosin ose/dhe të nënshkruajnë peticione (propozime, ankesa dhe padi), e në këtë sens në portal mund të gjenden informata ose ndihmë gjatë shkrimit ose përcaktimit se kujt duhet një peticion të caktuar t’ja drejtojmë. Gjithashtu, ka

shumë informata për të drejtën për peticion në Sërbë, regjion, Union European dhe më gjërë, dhe në përgjithësi rreth demokracisë së drejtëpërdrejtë që është një temë e pa anashkalueshme kur është fjala për peticionet – në rast se termi i përgjithshëm peticion përdoret për të përshkruar dhe iniciativat qytetare për ndryshime ligjesh.

Gjatë tetorit të vitit 2010. kanë filluar përgatitjet për themelimin e **Call Qendrës në numrin 0 700 400 700 që fillon me punë në nentor të vitit 2010.** Aktiviteti është i paramenduar që të ofroj mbështetje qytetarëve dhe të gjitha palëve të interesuara që dëshirojnë të informohen rreth procesit së paraqitjes së peticioneve dhe propozimeve organeve të qeverisjes dhe rreth mekanizmave që janë vendosur për monitorim të veprimit në bazë të peticioneve dhe propozimve të paraqitura. Call qendrën e udhëheqin ekspertët ligjor të YUCOM-it. Mbështetja që ofrohet nëpërmjet këtij aktiviteti përfshinë: këshilla ligjore dhe udhëzime lidhur me peticionet dhe format e tjera të iniciativave qytetare; asistencë gjatë përgatitjes së peticioneve dhe formave tjera të iniciativave qytetare; përfaqësim për zgjidhje të peticioneve dhe rasteve tjera që dorëzohen në institucionet relevante dhe bërje e presionit publik nëpërmjet mediave.

Këto janë vetëm disa nga aktivitetet me të cilat YUCOM dhe Heinrich Böll Stiftung dëshirojnë të mundësojnë pjesëmarrje të qytetarëve në procesin e vendim-marrjes në të gjitha nivelet e qeverisjes nëpërmjet adoptimit të rregullativës ligjore të patjetërsueshme dhe vendosjen e mekanizmave funksionale për rregullimin e të drejtës për peticione dhe propozime.

Rreth aktiviteteve të mëtuqjeshme informohuni në www.yucom.org.rs dhe www.boell.rs dhe në portalin e përbashkët www.uticaj.rs.

1. DEMOKRACIA E DREJTPËRDREJT

1.1. FORMAT E DEMOKRACISË SË DREJTPËRDREJT NË SERBI

Format e demokracisë së drejtpërdrejt – korrelativ demokracisë së ndërmjetme

Demokracia, si formë e qeverisjes, sipas definicionit përfaqëson qeverisjen e popullit¹. Sot, në asnjë vend të botës, nuk ekziston demokraci në formën e saj burimore të ndërmjetme. Profesionalizimi i të gjitha aspekteve të jetës bashkëkohore imponon demokracinë e përfaqësuar si domosdoshmëri.

Nga ana tjetër, ndarja e shtresës së zgjedhur qeverisëse nga nevojat e gjithanshme të qytetarëve, e krijuar gjatë planeve strategjike paraprakisht të defnuara dhe proceseve politike të jashtme, lind rrezikun nga mospërputhja e politikave publike me nevojat reale të qytetarëve. Së bashku me këtë fenomen në rritje e sipër, paraqiten apele të fuqishme që format e demokracisë së drejtpërdrejtë në shtete, si dhe në unione shtetesh, të themelohen në mënyrë të mundësojnë pjesëmarrje efikase të vullnetit të qytetarëve në krijimin e politikave publike. Në këtë mënyrë, politikat publike do të siguronin legjitimitet dhe me këtë do të mundësonin efektivitet dhe efikasitet në implementim. E gjithë kjo tregon se format e demokracisë së drejtpërdrejtë nuk përfaqësojnë kundërshtime dhe kundërpeshë, por mbështetje potenciale ndaj demokracisë së ndërmjetme, nëse rezultatet e përfaqësuesve të zgjedhur maten në kohë afatgjate.

Në Sërbë format e demokracisë së ndërmjetme dallojnë në nivelin republikan dhe lokal.

1. Niveli republikan: Referendumi dhe iniciativa popullore

Sipas nenit 2 paragrafi 1 i kushtetutës së Republikës së Sërbisë, suvereniteti rrjedh nga qytetarët që e zbatojnë duke bërë referendum, iniciativa qytetare dhe nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të zgjedhur në mënyrë të lirë.

¹ Shikuar historikisht, fillet e demokracisë shenonin sundimin e të gjithëve – në Greqinë antike – ku qeverisja në kuadër të qytetëve-shteteve realizohej nëpërmjet takimeve në të cilët nuk kishin drejtë pjesëmarrjeje gratë, fëmijët dhe skllëvërit.

Sipas fjalëve të prof. dr Marijana Pajvaçiq, „**referendumi** është karakteristik për nga fakti se qytetarët kanë mundësi që vendosmërisht të ndikojnë në të se a do të miratohet apo jo një vendim i caktuar”.

Lidhur me referendumin, kushtetuta rregullon:

- ☞ pyetjet rreth të cilave vendoset në referendumin kushtetues shtesë të detyrueshëm (ne. 203 pa. 7);
- ☞ pyetjet rreth të cilave vendoset në referendumin kushtetues fakultati, kushtet për shpallje të tij dhe subjekteve në kërkesë të së cilëve ai shpallet (ne. 203 pa. 6)
- ☞ pyetjet rreth të cilave detyrimisht vendoset në referendum (ne. 182 pa 3 dhe 4)
- ☞ kushtet nën të cilat për të gjitha çështjet tjera shpallet referendum fakultativ dhe subjektet që mund të kërkojnë shpalljen e tij. (ne. 99 pa. 1 pika 2, dhe pa. 108)
- ☞ pyetjet që nuk mund të jenë çështje të vendimit në një referendum. (ne. 108 pa. 2).¹

Me kushtetutë përcaktohet se referendumi fakultativ, si një formë e deklarimit të drejtpërdrejtë të qytetarëve për çështjet brenda juridiksionit të Asamblesë Kombëtare, shpallet me kërkesë nga ana e shumicës së deputetëve popullor ose një numri të caktuar të qytetarëve (në “niveлин” e Republikës së Sërbis duhet që një kërkesë të tillë ta mbështesin më së paku 100.000 zgjedhës).

Iniciativa popullore është formë e vendosjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve, karakteristike për shkak se qytetarët me të vetëm se e fillojnë marrjen e vendimeve (inicojnë vendim-marrje ose paraqesin propozim formal që nis procesin e vendim-marrjes)

Kushtetuta përmban një dispozitë të përgjithshme mbi iniciativën popullore, e në veçanti rregullon disa forma të iniciativave popullore – ato të cilat i përmbushin kushtet për fillimin e procesit të marrjes së vendimeve:

- iniciativa legjislativë – e drejta e qytetarëve të propozojn ligje (ne. 107 pa. 1);
- iniciativa kushtetuese – e drejta e qytetarëve të propozojn revidimin e kushtetutës (ne. 203 pa. 1)
- kërkesa për shpallje të referendumit – e drejta e qytetarëve të kërkojnë shpallje të referendumit republikan (ne. 108 pa. 1).²

Nga dispozitat kushtetuese mund të nxirret interpretimi se iniciativa popullore është formë e adresimit kolektiv drejt trupit ligjvënës me qëllim propozim të ligjeve gjegjësisht akteve tjera të përgjithshme nga kuadër të kompetencave të trupit ligjvënës (në nivel republikan – nga kompetencat e Asamblesë Kombëtare të RS), si dhe formë e

1 Krahaso: M. Pajvaçiq, “Komente Kushtetutës së Republikës së Sërbis”, Fondacioni Konrad Adenauer, Beograd, 2009.

2 Krahaso: M. Pajvaçiq, “Komente Kushtetutës së Republikës së Sërbis”, Fondacioni Konrad Adenauer, Beograd, 2009

kërkesës së qytetarëve që legjislacioni të zgjidh një pyetje të caktuar nëpërmjet shpalljes së një referendumi.

Kushtetuta përcakton që për iniciativë popullore (legjislative) nevojitet mbështetja e së paku 30.000 zgjedhësve: „Të drejtën e propozimit të ligjeve, rregulloreve tjera dhe akteve të përgjithshme e ka secili deputet popullor, Qeveria, kuvendi i krahinës autonome ose **së paku 30.000 zgjedhës**”.¹

Procesi i zbatimit të referendumit dhe iniciativës popullore më së afërmi përcaktohet me Ligjin mbi referendum dhe iniciativë popullore („Gazeta zyrtare e RS”, nr. 48/94, 11/98). Ky ligj përcakton: “Në mënyrën e përcaktuar me këtë ligj, qytetarët propozojn ndryshimin e Kushtetutës, ligjeve, rregulloreve tjera dhe akteve të përgjithshme nga kompetencat e Asamblesë Komëtare, gjegjësisht kuvendit të krahinës autonome, komunës apo qytetit, shpallje të referendumit për një pyetje të caktuar dhe të paraqesin propozime tjera në përputhshmëri me Kushtetutën, ligjin dhe statutin (ne tekst tutje: iniciativa popullore).”²

Ligji mbi referendumin dhe iniciativën popullore parasheh procedurë të ndërlikuar të krijimit të propozim ligjeve dhe akteve tjera nga ana e qytetarëve dhe një afat shumë të shkurt dhe proces të komplikuar në të cilin qytetarët mund të organizojn mbledhjen e nënshkrimeve të qytetarëve tjerë që mbështesin këtë iniciativë. Kjo praktikisht don të thotë që për iniciativën popullore si një nga “format” e petitionit, është e nevojshme një infrastrukturë organizative me qëllim mbledhje të shpejtë të nënshkrimeve si dhe shkallë e lartë e diturisë “juridike” të qytetarëve të cilët, në formë propozimi i dorëzojnë akte trupit ligjvënës të mbështetur me nënshkrime të qytetarëve, të cilët pastaj legjislacioni i miraton ose i refuzon.

Në mënyrë të veçant, Ligji mbi referendumin dhe iniciativën popullore parasheh që qytetarët për të arritur realizimin e iniciativës popullore (legjislative) janë të obliguar që së pari të themelojnë komitetin inicues nga më së paku tre anëtar që kanë të drejtë vote. Komiteti inicues mund të themeloj komitete të veçanta për mbledhje të nënshkrimeve në vende të caktuara.

Propozimi për ndrim ose miratim të një akti adekuat, gjegjësisht **propozimi i dytë** i përfshirë me iniciativën popullore duhet të jetë i krijuar në mënyrë që nga ai të shihen qartë drejtimit e ndryshimeve, gjegjësisht vendimet rreth të cilave organi kompetent duhet të deklarohet. Propozimin e nënshkruajn anëtarët e komitetit inicues. Në kuptimin terminologjik, duket që shprehja “propozimi i dytë” duhet të paraqes mundësinë e qytetarëve për të propozuar shpalljen e referendumit për një pyetje të caktuar nga kompetencat e trupit ligjvënës.

1 Krahaso: *Kushtetuta e Republikës së Serbis*, nr. 98/2006, ne. 2 dhe ne. 107.

2 Krahaso: *Ligji mbi referendumin dhe iniciativën popullore*, „Gazeta zyrtare e RS”, nr. 48/94, 11/98, ne. 31-41.

Komiteti inicues paraqet **propozimim** organit kompetent për miratim aktesh (trupit ligjvënës, në përputhje me termin iniciativa popullore më parë të definuar me ligj), gjegjësisht për zgjidhje rreth pyetjes për të cilën propozimi drejtohet (organi kompetent) me qëllim informimi që për këtë propozim po mblidhen nënshkrime. Organi kompetent vërteton pranimin e propozimit për të cilin po mblidhen nënshkrime në faqën a parë të tekstit të propozimit dhe vërteton çdo faqe të tekstit të propozimit në aq kopje në sa e dorëzon komiteti inicues. Organi kompetent e mban një kopje të propozimit për të cilin po mblidhen nënshkrime. **Pas paraqitjes së propozimit për të cilin po mblidhen nënshkrime, propozimi nuk mund të ndryshohet as të shtohet.**

Komiteti inicues lajmëron mbledhjen e nënshkrimeve në Ministri të punëve të brendshme – njësisë organizative në komunë në teritor të së cilës do të mblidhen nënshkrimet. Lajmërimi paraqitet më së voni tri ditë para mbledhjes së nënshkrimeve. Në lajmërim cekën: emri i organit kujt i drejtohet propozimi për të cilin po mblidhen nënshkrime dhe numri pranues nën të cilin ai propozim udhëhiqet, vendi dhe mënyra e mbledhjes së nënshkrimeve; të dhënat personale të personit që do të mbledh nënshkrime dhe masat që komiteti inicues i ndërmerret me qëllim pengimi të keqpërdorimeve eventuale lidhur me mbledhjen e nënshkrimeve.

Lajmërimin e nënshkruajn anëtarët e komitetit inicues, gjegjësisht anëtarët e komitetit që do të mbledh nënshkrime. **Lista e nënshkruesve të iniciativës popullore përmban:** 1) përcaktimi i propozimit për të cilin po mblidhen nënshkrime me numrin pranues të organit kompetent; 2) të dhënat mbi nënshkruesit e iniciativës, që shenohen me shkronja të lexueshme të shtypit dhe vërtetohet me nënshkrimin e tij personal; adresa e nënshkruesit të iniciativës; numri personal i nënshkruesit të iniciativës nëse posedon një të tillë; numrin e leternjoftimit të nënshkruesit të iniciativës; 3) data dhe vendi i mbledhjes së nënshkrimeve; 4) deklaratën e komitetit inicues, gjegjësisht komitetit që ka mbledh nënshkrime që të gjithë nënshkruesit në listë kanë të drejtë pjesëmarrjeje në iniciativë popullore në përputhje me ligjin dhe se janë nënshkruar vetëm një herë në listë, si dhe vërejtjen mbi tërheqjen eventuale të nënshkrimit të qytetarit; 5) nënshkrimet e anëtarëve të komitetit inicues, gjegjësisht komitetit që ka mbledh nënshkrime.

Mbledhja e nënshkrimeve të qytetarëve që marrin pjesë në iniciativë popullore zgjat **më së shumti shtatë ditë** duke llogaritur nga dita që në lajmërimin Ministrisë së punëve të brendshme është cekur si dita a parë e mbledhjes së nënshkrimeve. Qytetari mund të nënshkruhet vetëm një herë në listën e nënshkruesve të iniciativës popullore. Qytetari mund të tërheq nënshkrimin e tij deri në mbarimin e ditës së fundit të caktuar për mbledhje nënshkrimesh. Nënshkrimi tërhiqet në formë të shkruar, ndërsa komiteti për mbledhje të nënshkrimeve konstaton këtë gjë në listën e nënshkruesve të iniciativës popullore.

Ne vendin ku mbliidhen nënshkrime **teksti i propozimit** për të cilin mbliidhen nënshkrime, i vërtetuar nga organi kompetent dhe i pajisur me numër pranues, duhet të jetë i dukshëm që qytetarët të kenë çasje. Qytetari ka të drejtë që të lajmërojë organin kompetent për lëshime dhe mangësi në procesin e mbledhjes së nënshkrimeve për propozimin e përfshir në iniciativën popullore. Komiteti inicues dorëzon listën e nënshkruesve të iniciativës popullore tek organi kompetent. Organi kompetent verifikon se a është përpiluar lista e nënshkruesve të iniciativës popullore në përpuethshmëri me dispozitat e atij ligji dhe se a është mbledhur numri i duhur i nënshkrimeve, ku edhe merr në konsideratë kundërshtimet eventuale të qytetarëve mbi procesin e mbledhjes së nënshkrimeve.

Nëse qytetari, gjegjësisht komiteti inicues mendon se organi kompetent ka vepruar padrejtësisht gjate kryerjes së veprimeve, mund të ankohet në Gjyqin suprem. Gjyqin suprem zgjidh çështjen në afat prej 48 orësh nga pranimi i ankesës. Vendimi i Gjyqit suprem sipas ankesës është definitiv.

Përkundër procedurës së komplikuar, në praktikë ekzistojnë shembuj të dorëzimit të propozimeve të ligjeve nga ana e qytetarëve. Kështu, në nëntor të vitit 2007, Koalicioni për liri në çasje të informacioneve¹ ka arritur që nëpërmjet iniciativës popullore të mbështetur nga ana e 35870 votuesve të dorëzoj Propozim ligjin mbi ndryshimet dhe shtesat e Ligjit mbi çasjen e lirë në informacione me rëndësi publike dhe Propozim ligjin mbi klasifikimin e informatave të Asamblesë kombëtare të Republikës së Serbis. Këta propozime gjatë kanë qenë „të humbura në ndonjë sirtar” në ndërtesën e Asamblesë kombëtare. Vetëm në vitin 2009, pas kampanjës së koalicionit të përmendur, këta propozime janë gjendur në faqën e internetit të Asamblesë. Në momentin e shkrimit të këtij publikacioni propozimet akoma qëndrojnë në faqën e internetit të Asamblesë, dhe për to nuk është vendosur, por jo nga arsya e mosekzistimit të nevojës për rregullim të këtyre dy fushave. Në fakt, në gusht të vitit 2009 është miratuar ligji mbi fshehtësinë e të dhënave, propozues i të cilit ka qenë Qeveria. Nga ana tjetër, edhe Ligji për çasje të lirë tek informatat me rëndësi publike deri diku është ndryshuar në vitin 2009 dhe 2010. E gjithë kjo tregon se iniciativa popullore në Serbi nuk rrespektohet. Edhe pse propozim ligjet ekzistojnë, ata kurr nuk janë vendosur në rend të ditës, dhe as që Koalicioni ka pas bazë ligjore të ndikojë në vendosjen e këtyre propozimeve në rendin e ditës së kuvendit.

1 Koalicioni për liri të çasjes në informacione momentalisht bashkon: Qendrën e Beogradit për të drejtat e njeriut, Qendra e Beogradit për politikë të sigurisë, Qendra për avansim të studimeve juridike, Qendra për edukim civil – Vršac, Qendra për veprim antiluftë, Shoqata civile e Hungarezëve në Serbi „Argus”, Qendra për politikë praktike, Iniciativa e të rinjëve për të drejtat e njeriut, Fondi për shoqëri të hapur–Serbi, Forumi iuris–Novi Sad, Këshilli qytetarë i komunës së Krlevës, Iniciativat Qytetare, Komiteti i juristëve për të drejtat e njeriut, Parlamenti popullor – Leskoc, Praxis, Transparenca Serbi, Qendra e rrethit të Toplicës për demokraci dhe të drejta të njeriut, Resurs qendra – Negotin, Shoqata e qytetarëve „Sretenje”- Pozhegë.

Në korrik të vitit 2010 është miratuar rregullorja e re e punës së Asamblesë kombëtare. Duket se sipas Rregullores së re, ekziston mundësia e ndikimit në rendin e ditës nga ana e qytetarëve si paraqitës të propozimit të ligjit. Sipas nenit 92 paragrafi 2 i rregullores parashihet që: „Deputeti popullor, Qeveria dhe **propozuesit e tjerë të autorizuar** mund të propozojnë tërheqjen e pikëve të caktuara nga rendi i ditës i propozuar, **plotësimin e rendit të ditës të propozuar**, bashkim diktimesh, zhvillim të hulumtimit të detaleve menjëher pas mbarimit të shqyrtimit bazë të ndonjë propozim ligji të caktuar dhe ndryshimin e orarit të pikëve të caktuara të rendit të ditës të propozuar”. Edhe pse kjo dispozitë nuk mundëson ndryshimin final të rendit të ditës, mund të thuhet se kjo Rregullore mundëson qytetarët të jenë së paku një hap më afër me Asamblenë kombëtare.

Njëkohësisht, në vijim është procesi i krijimit të Ligjit të ri mbi referendumin dhe iniciativën popullore. Gjatë kohë, ky fakt është „fshehur” nga ana e sektorit joqeveritarë, sidomos atyre organizatave që kanë bërë modelin e Ligjit mbi iniciativat popullore¹. Por, duke i falenderuar komisionit Venecian, që ka dhënë mendimin mbi skicën e ligjit, sektori civil është njohur me përmbajtjen e tij. Pritet një diskutim mbi këtë ligj në të ardhmën e afërt.²

2. Niveli lokal: iniciativat qytetare, kuvendi i qytetarëve dhe referendumi

*Ligji mbi vetëqeverisjet lokale*³ në kuadër të pjesës që ka të bëjë me pjesëmarrjen direkte të qytetarëve në realizimin e vetëqeverisjes lokale (ne. 67-68) parasheh si forma të kësaj pjesëmarrje: **iniciativën qytetare, kuvendin e qytetarëve dhe referendumin**. Mënyra e realizimit të formave të përmendura të pjesëmarrjes së qytetarëve në krijimin e politikave lokale rregullohet me ligh dhe statut.

Ne lidhje me mënyrën e realizimit “të iniciativës popullore” që proklamohet me Kushtetutë si formë e realizimit të “suverenitetit popullor”, me analizë të rregullave pozitivno-juridike, mund pikë së pari të vërehet se ky nocion nuk është “unik” gjegjësisht që nuk ekziston “unifikim terminologjik” i tij.

Në ligjet me të cilat rregullohet fusha e qeverisjes lokale, përdoret edhe një “term” – ai është termi “**iniciativa qytetare**”. Duke shikuar dispozitat e Kushtetutës, Ligjit mbi referendumin dhe iniciativën popullore dhe dispozitat e ligjit në lidhje me

1 Skicën e ligjit mbi iniciativën popullore e ka përgatit Parlamenti Popullor – Leskoc, Qendra për avansim të studimeve juridike (CUPS), Sretenje dhe Resurs Qendra Negotin.

2 Lexuesit e interesuar në faqën e internetit të Komitetit të juristëve për të drejtat e njeriut dhe Fondacionit Hajrih Bel www.uticaj.rs që është krijuar në kuadër të projektit “Krycja e qytetarëve dhe qytetareve në jetën shoqërore dhe politike nëpërmjet përfaqësimit të së drejtës për peticione dhe propozime” mund të informohen mbi përmbajtjen e këtyre propozimeve si dhe mbi vendimet në legjislacionin komparativ (Çeki dhe ngjajshëm).

3 Krahaso: *Ligji mbi vetëqeverisjen lokale*, “Gateta zyrtare e RS”, nr. 129/07, ne. 44-45.

vetqeverisjen lokale, vijnë deri te konkluzioni se këto fjalë përdoren si “sinonim”, gjegjësisht që kanë domethënie të njejtë.

Siç ceket në Ligjin e e vetqeverisjes lokale: “Qytetarët nëpërmjet iniciativës qytetare i propozojnë kuvendit të njësisë së vetqeverisjes lokale miratimin e aktit me të cilin do të rregullohet një pikë e caktuar nga kompetencat e njësisë së vetqeverisjes lokale, ndryshimin e statutit ose akteve tjera dhe shpallje të referendumit në përputhje me ligjin dhe statutin. Rreth propozimit nga pika e mëparme, kuvendi është i obliguar të mbajë diskutim dhe të paraqes arsyetim në përgjigje ndaj qytetarëve në afat prej 60 ditëve nga pranimi i propozimit”

Me statut të vetqeverisjes lokale vërtetohet numri i nënshkrimeve të qytetarëve i nevojshëm për nisje kuptimplotë të iniciativës qytetare, që nuk mund të jetë më i ulët se 5% e votuesve.

Ngjajshëm është e vërtetuar edhe me Ligjin mbi Kryeqytetin.¹ Format e pjesëmarrjes direkte në realizimin e vetqeverisjes lokale janë: iniciativa qytetare, kuvendi i qytetarëve dhe referendumi. Format e vetqeverisjes direkte rregullohen me ligj dhe Statut. Qytetarët nëpërmjet iniciativës qytetare i propozojnë Kuvendit të qytetit miratimin e aktit me të cilin do të rregullohet një pyetje e caktuar nga kompetencat e qytetit, ndryshimin e Statutit ose akteve tjera dhe shpalljen e referendumit në përputhje me ligjin dhe Statutin. Rreth propozimit, Kuvendi i qytetit është e obliguar të mbajë diskutim dhe të paraqes arsyetim në përgjigje ndaj qytetarëve në afat prej 60 ditëve nga pranimi i propozimit. Me statut të qytetit verifikohet numri i nënshkrimeve të qytetarëve i nevojshëm për nisje kuptimplotë të iniciativës qytetare, që nuk mund të jetë më i vogël se 30.000 votues.

Gjithashtu, me Statut të qytetit të Beogradit,² vërtetohet që qytetarët përmes iniciativës qytetare (ne. 111-114) propozojnë Kuvendit të qytetit miratim të akteve me të cilat do të rregullohet një pyetje e caktuar nga kompetencat e qytetit, ndryshim Statuti ose akteve tjera dhe shpallje te referendumit në përputhje me ligjin dhe këtë statut. Administrata komunale ofron ndihmë profesionale qytetarëve gjatë peripilimit të propozimit të përmbajtur në iniciativë. Për nismë kuptimplotë të iniciativës qytetare janë të nevojshme së paku 30.000 votues, që janë të shënuar në listën zgjedhore në ditën e dorëzimit të iniciativës, përveç nëse me ligj apo me këtë statut nuk është caktuar numër tjetër. Qytetarët marrin pjesë në iniciativën qytetare me nënshkrimin e propozimit adekuat. Propozimi duhet të jetë i arsyetuar dhe i përgatitur në mënyrë që nga ai të shihen qartë drejtimet e ndryshimeve, gjegjësisht vendimet rreth të cilave Kuvendi komunal duhet të deklarohet.

1 Krahaso: Ligji mbi kryeqytetin, “Gazeta zyrtare e RS”, nr. 129/07, ne. 44-48.

2 Krahaso: Statuti i qytetit të Beogradit, „Fleta zyrtare e qytetit të Beogradit“, nr. 39/2008. ne. 111-114.

Me qëllim realizimi të iniciativës qytetare, qytetarët themelojnë komitetin inicues që ka pesë anëtar që kanë të drejtë vote. Komiteti inicues mund të themelojë komitete të posaçme për mbledhje të nënshkrimeve, në përputhje me ligjin. Komiteti inicues i paraqet listën e nënshkruesve të iniciativës qytetare Kuvendit të qytetit.

Me ligj është e definuar se si Kuvendi i qytetit vepron bazuar në iniciativë. Kuvendi i qytetit është i obliguar të mbajë diskutim dhe të paraqes arsyetim në përgjigje ndaj qytetarëve në afat prej 60 ditëve nga pranimi i propozimit.

Me statut të qytetit të *Novi Sadit*¹ është caktuar që me iniciativë qytetare, qytetarët mund të i propozojnë Kuvendit miratimin e akteve që do të rregullojnë çështje të caktuara nga fushveprimi i Qytetit, ndryshimin e Statutit dhe akteve tjera, shpallje të referendumit mbi një pyetje të caktuar dhe zgjidhje të çështjeve tjera, në përputhje me ligjin dhe këtë statut. Për nismë të iniciativës qytetare është e nevojshme që iniciativën qytetare ta nënshkruajn më së paku 10% të qytetarëve nga territori i qytetit. Iniciativa qytetare me të cilën propozohet miratimi i ndonjë akti të përgjithshëm gjegjësisht ndryshim i Statutit apo ndonjë akti tjetër të përgjithshëm, i dorëzohet kryetarit të Kuvendit i cili e dorëzon në Këshill të Qytetit, në trupin punues kompetent të Kuvendit dhe Komisionit për rregullore për shkak të dhënies së mendimit. Iniciativa qytetare është e pranuar atëherë kur pro saj deklarohen më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të këshilltarëve. Rreth propozimit, Kuvendi duhet të mbajë diskutim dhe të paraqes arsyetim në përgjigje ndaj qytetarëve në afat prej 60 ditëve nga pranimi i propozimit

Gjithashtu, me Statut është e caktuar që qytetarët marrin pjesë në kryerjen e punëve të Komunës së qytetit me referendum, iniciativë qytetare, në kuvend të qytetarëve dhe perms përfaqësuesve të tyre në Këshillin e Komunës së qytetit. Për nismë të iniciativës qytetare është e nevojshme që iniciativën qytetare ta nënshkruajnë së paku 10% e qytetarëve nga rajoni i Komunës së Qytetit.

Statuti i qytetit të Kragujevcit,² pikësëpari parasheh që qytetarët, nëpërmjet iniciativës qytetare i propozojnë Kuvendit të qytetit miratimin e akteve me të cilat do të rregullohen çështje të caktuara nga fushveprimi burimor i Qytetit, ndryshim të Statutit ose akteve tjera, shpallje të referendumit, në përputhje me ligjin dhe këtë Statut. E drejta e nisjes së iniciativës qytetare realizohet në përputhje me ligjin me të cilin rregullohet referendumi dhe iniciativa qytetare (popullore). Për nismë të iniciativës qytetare është e nevojshme që propozimi i kyçur në iniciativë qytetare ta nënshkruajn më së paku 25% e qytetarëve me drejtë vote dhe vendbanim në territorin për të cilin propozohet rregullimi i çështjes

1 *Statuti i qytetit të Novi Sadit*, „Fleta zyrtare e Novi Sadit“, nr. 43/08, čl. 68 i ne. 90.

2 *Statuti i qytetit të Kragujevcit*, „Fleta zyrtare e qytetit të Kragujevcit“, nr. 18/08, 10/09, neni 55-57

së caktuar, në ditën e lajmërimit të mbledhjes së nënshkrimeve organit kompetent. Rreth propozimit të përfshirë në iniciativën qytetare Kuvendi i qytetit është i obliguar të mbajë diskutim dhe të paraqes arsyetim në përgjigje ndaj qytetarëve në afat prej 60 ditëve nga pranimi i propozimit.

Kuvendi i qytetarëve paraqet bashkim qytetarësh që ftohet për pjesë më të vogla të teritorit të komunës për diskutime dhe dhënie të propozimeve rreth çështjeve nga kompetencat e organeve të komunës apo qytetit. *Me ligjin mbi vetqeverisje lokale është paraparë që kuvendi i qytetit me shumicë votash të të pranishmëve miraton kërkesa dhe propozime dhe i udhëzon ato drejtë kuvendit apo organeve tjera dhe shërbimeve të njësisve të vetqeverisjes lokale. Organet dhe shërbimet e njësisve të vetqeverisjes lokale janë të obliguar që në afat prej 60 ditëve nga mbajtja e kuvendit të qytetarëve, të shqyrtojnë kërkesat dhe propozimet e qytetarëve dhe rreth tyre të marrin qëndrim, gjegjësisht të marrin vendimin apo masën e caktuar dhe për këtë ta lajmërojnë qytetarët.*

Roli i kuvendeve përfshin dy faza të procesit të vendim-marrjes – diskutimi dhe propozimi, por jo edhe fazën e tretë të këtij procesi – vendim-marrjen. Për këtë ato drejtohen kah mbledhja e mendimeve dhe propozimeve, pra kah konsultimi i qytetarëve. Këtyre propozimeve mund tu dilet përball ose me ndërmarrjen e masave të caktuara, ose me rregullimin e ndonjë çështje në aktet juridike të komunës.

Me ligjin mbi vetqeverisjet lokale rregullohet që përpunimi i pyetjeve me rëndësi për kuvendet e qytetarëve vijon nëpërmjet dispozitave të statutit të komunë, gjegjësisht nëpërmjet vendimeve rreth mbajtjes së kuvendeve. Por, në statutet e komunave, kryesisht, nuk është saktësisht e konkretizuar tema e kuvendeve të qytetarëve, kështu që në ta, në princip, mund të diskutohen të gjitha pyetjet nga kompetencat e cilit do organ të komunës.

Kuvendet e komunave në statute nuk kanë rregulluar as pyetjet nga kompetencat e tyre për të cilat është patjetër të mbahet kuvendi për shkak të marrjes së mendimit të qytetarëve, por më shpesh kjo pyetje është e rregulluar si sipas mundësisë. Me statute më së shpeshti është definuar që kuvendi mund të mbahet dhe në të të merren konkluzat të plotëvlefshme nëse marrin pjesë së paku 10% të votuesve nga rajoni në të cilin po mbahet kuvendi. Në statute nuk janë të definuara as çështjet e verifikimit të kforumit dhe as procesi i deklarimit në kuvend.

Praktika tregon se kuvendet e qytetarëve nuk janë në mënyre adekuate të përfaqsuara, përveç në kuadër të bashkësive lokale ku rëndësia e kuvendit të qytetarëve kalon rrolin e tyre konsultativ dhe propozues.¹

¹ Krahaso: “Pjesëmarrja e drejtpërdrejt e qytetarëve në jetën publike në nivelin lokal”, Konferenca e përhershme e qyteteve dhe komunave, 2006, fq. 22.

Kuvendi i njësisë së vetqeverisjes lokale mund që me iniciativë të saj të shpall **referendum** rreth çështjeve nga kompetencat e veta. Referendum mbi pyetjet nga kompetencat e veta, kuvendi i njësisë së vetqeverisjes lokale është i obliguar ta shpall me propozim që paraqesin së paku 10% e votuesve nga numri total i trupit zgjedhor në njësinë e vetqeverisjes lokale në mënyrë të definuar me ligj dhe statut. Vendimi përmes referendnumit merret nëse për të janë deklaruar shumica e qytetarëve që kanë votuar, me kusht që të ketë votuar më tepër se gjysma e numrit të përgjithshëm të qytetarëve. Vendimi i marrë me referendum është obligativ, ndërsa kuvendi i njësisë së vetqeverisjes lokale nuk mund ta shfuqizojë, as me ndryshime dhe shtesa ta ndrojoj thelbin e saj në një periudhë vijuese prej një viti pas marrjes së vendimit.¹

KATARINA GOLUBOVIĆ
dr DEJAN MILENKOVIĆ

1 Krahaso Ligji mbi vetqeverisjen lokale "Gazeta zyrtare e RS", nr. 129/07, pa. 69.

Çka nënkuptojmë me demokraci të drejtpërdrejt?

Mund të dallohen dy kuptime të ndryshme të termit „demokraci e drejtpërdrejt“. Në njërën anë, me demokraci të drejtpërdrejt konsiderohet lloji specifik i mbizotërimit politik në të cilin vetë fuqia politike në mënyrë të drejtpërdrejt dhe obliguese ushtrohet me ndërmjetësimin e gjithë qytetarëve dhe qytetareve me të drejtë vote, dhe jo me ndërmjetësimin e përfaqësuesve të caktuar apo numrit më të vogël të tyre apo bartësve të funksioneve. Termi i kundërt i demokracisë së kuptuar në këtë mënyrë është demokracia përfaqësuese. Në anën tjetër, me „demokraci të drejtpërdrejt“ nënkuptojmë procesin politik të marrjes së vendimeve ku qytetarët dhe qytetaret përmes referendumit pavarësisht nga zgjedhjet vendosin mbi çështjet konkrete të cilat kanë të bëjnë me politikën dhe përmbajtjen e saj. Atë koncept të politikës nuk duhet kuptuar si kundërshtim në krahasim me demokracinë përfaqësuese. Përkundrazi, procesi i marrjes së vendimeve i konstruktuar sipas parimit të plebiscitit (gjerm. *Volksabstimmung*, angl. *plebiscite*) mund të parashihet si instrument plotësues i pjesëmarrjes politike në format e ndryshme të sistemeve politike të demokracisë përfaqësuese.

Cilat instrumente të demokracisë së drejtpërdrejt – të kuptuara si forma të pjesëmarrjes politike – mund të dallohen? Para së gjithash është e rëndësishme të bëhet dallimi mes votimit të personave dhe çështjeve konkrete. Votimi i cili ka të bëjë me personat në demokraci, merr pjesë në zgjedhje. Mirëpo, demokracia e drejtpërdrejt tejkalon kornizat e zgjedhjeve, ngase zgjedhjet paraqesin themelin e sistemeve përfaqësuese, që do të thotë se qytetaret dhe qytetarët zgjedhin parlamentarët, shefat e shteteve dhe të qeverisë, prefektët dhe ashtu me radhë, të cilët prap, nga ana e tyre marrin vendime politike si përfaqësues të qytetarëve dhe qytetareve. Për dallim nga kjo, demokracia e drejtpërdrejt nënkupton vendimet direkte të qytetarëve dhe qytetareve mbi çështjet konkrete me ndërmjetësim të plebisciteve.

☞ *Propozime* konsiderohen plebiscitet mbi propozim ligjet ku rezultatet e votimit nuk janë të obligueshme për organet shtetërore.

☞ *Me anë të referendumit* vendimi i parlamentit mbi ligjin apo rendin kushtetues mund t'i nënshtrohet votimit publik plebiscitar. Pra, populli me ndërmjetësimin e plebiscitit mundet pastaj të pohojë apo të kundërshtojë vendimin të cilin e ka marrë parlamenti. Nëse qytetarët dhe qytetaret me të drejtë votë janë të autorizuar të shpallin një referendum të tillë, është fjala për referendumin fakultativ, të cilin e njohin kushtetutat e Zvicrës, Italisë, Lihtenshtajnit si dhe

25 shteteve të SHBA-ve. Nëse një plebiscit i tillë është i rregulluar me norma juridike – sipas rregullës me kushtetutë – si i obligueshëm, siç është kryesisht rasti tek ndryshimet kushtetuese apo marrëveshjet ndërkombëtare, është fjala për referendumin e obliguar. Ajo formë e referendumit haset në kushtetutat e Zvicrës, Austrisë, Danimarkës, Australisë, Lihtenshtajnit, në 49 shtete të SHBA-ve, si dhe në kushtetutat krahinore të Bavarisë dhe Hesenit në RS të Gjermanisë.

☞ *Me iniciativë* nënkuptohet procesi i drejtpërdrejt demokratik i marrjes së vendimeve të cilat mund të lëvizin individët/et, grupet apo organizatat – pra, procedura nuk lëvizet nga “lartë“, por nga mes, nga populli – dhe me të cilin në mënyrë aktive dhe direkte mund të futen propozime konkrete në procesin legjislativ. Për lëvizjen e proceseve zakonisht kërkohet numri i caktuar i nënshkrimeve; varësisht nga sistemi politik, parlamenti, apo, prap, populli në kuadër të referendumit vendosë mbi atë propozim. Kur është fjala për ligjet kushtetuese, atë lloj të iniciativës e njohin kushtetutat e Zvicrës, 17 shtete të bashkuara të SHBA-ve, Lihtenshtajni si dhe disa kushtetuta krahinore të RS të Gjermanisë. Në pikëpamjen e ligjeve të thjeshta, ajo është mundësuar në të gjitha krahinat e bashkuara të Gjermanisë, 21 shtete të bashkuara të SHBA-ve, Lihtenshtajni, si dhe në nivelin e kantoneve në Zvicërr.

☞ *Mbi plebiscitin* flitet kur qytetarët dhe qytetaret me të drejtë vote nuk kanë autorizim për shpalljen e plebiscitit me qëllim të ndryshimit të kushtetutës apo ligjit të thjeshtë, por atë e vlerëson organi shtetror (për shembull qeveria, kryetari i shtetit, shumica parlamentare). Një plejadë e tillë lejon organeve shtetnore përgjegjëse që plebiscitin ta shfrytëzojnë në imponimin politik me organet tjera shtetnore edhe si çështje të besimit – dhe në atë mënyrë edhe si burim i legjitimitetit të pozitës personale dhe vet personit. Kjo është treguar si e saktë, për shembull, tek referendumi në Republikën e pestë franceze, i cili është futur jo aq për pjesëmarrjen më të madhe politike të qytetarëve dhe qytetareve, por përkundrazi, me qëllim që të vendi i theksuar i kryetarit të shtetit në sistemin politik të verifikohet dhe të forcohet.

Krahasimi i shteteve evropiane

Do të vështrojmë më afër përhapjen e demokracisë së drejtpërdrejt duke u mbështetur në studimin krahasues të cilin e ka realizuar grupi punues i Fondacionit *Initiative & Referendum Institute Europe* nën udhëheqjen e Andreas Grosit (Andreas Gross) dhe Bruno Kaufmanit (Bruno Kaufmann) në vitin 2002 në 15 shtete anëtare të

UE, 13 shtete kandidate si dhe anëtarët e EFTA (European Free Trade Association – Asociacioni evropian për tregti të lirë) edhe atë në Islandë, Norvegji, Lihtenshtajn dhe Zvicërrj. Në 32 shtete është analizuar

- ☞ A ekzistojnë instrumente të demokracisë së drejtpërdrejt dhe procedurat në nivelin e shtetit;
- ☞ A është fjala mbi atë të cilën mund ta shpallin qytetarët dhe qytetaret – siç janë iniciativat popullore dhe referendumi fakultativ;
- ☞ A është rrënjësuar instrumenti u referendumit të obliguar.

Rezultati i analizës është se vetëm në dy shtete në të gjitha tri pyetjet mund të merret përgjegje pozitive (Lihtenshtajn dhe Zvicërr). Pas atij grupi të parë të shteteve vjen i dyti ku qytetarët dhe qytetaret nga parlamenti dhe qeveria mund të shpallin plebiscit në nivel të shtetit (Italia, Sllovenia, Letonia), si dhe grupi i tretë i shteteve në të cilat është rrënjësuar instrumenti i referendumit të obliguar (Irlanda, Danimarka, Lituania dhe Sllovakia). Duhet cekur edhe Holandën, ku me 1. janar të vitit 2002 është futur referendumi i përkohshëm dhe për organet shtetërore i paobligueshëm, gjë e cila është bërë me një ligj i cili vlente deri në vitin 2005;

Pas asaj ndarjeje paksa të ashpër, shtetet e zgjedhura u analizuan sipas diferencimit të katalogut kualitativ dhe kuantitativ të kriterëve në pikëpamjen e kualitetit të procedurave të cilat kanë të bëjnë me demokracinë e drejtpërdrejt dhe janë të ndara në gjashtë familje shtetesh:

- ☞ *Avangarde* me spektër të gjerë të procedurave lidhur me demokracinë e drejtpërdrejt: Lihtenshtajni dhe Zvicërra.
- ☞ *Demokratike* në të cilat qytetarët dhe qytetaret madje edhe pjesërisht disponojnë me mundësitë që edhe pa pranimin e organeve shtetërore të shpallin plebiscite në nivelin shtetëror dhe ku ekziston referendumi i obliguar: Italia, Sllovenia, Letonia, Irlanda, Danimarka, Lituania dhe Sllovakia.
- ☞ *Të kujdesshme*, ku ekzistojnë përvojat me instrumentet e demokracisë së drejtpërdrejt, por ato kryesisht përdoren në mënyrë plebiscitare, që do të thotë me ndërmjetësimin e parlamentit apo qeverisë, dhe jo ndërmjetësimin e vetë qytetareve dhe qytetarëve: Franca, Spanja, Austria, Suedia, Norvegjia, Hungaria.
- ☞ *Frigacake* në të cilat ekzistojnë shenja të instrumenteve të demokracisë së drejtpërdrejt, por elitat politike deri më tani janë frikësuar nga ndërtimi më i fuqishëm i demokracisë së drejtpërdrejt: Polonia, Britania e Madhe, Finlanda, Estonia, Belgjika, Islanda, Luksemburgu, RS e Gjermanisë, Greqia dhe Republika e Cekisë.

- ☞ *Të pashpresa*, ku praktikisht nuk ekziston procedurë institucionale apo përvojë me demokraci të drejtpërdrejt, në të cilat kornizat politike dhe kulturore janë të papërshtatshme për ndërtimin e sistemit demokratik, por ku së paku deri diku ekziston debate mbi demokracinë e drejtpërdrejt: Rumania, Portugalia, Bullgaria dhe Malta.
- ☞ *Në fund* janë ato tek të cilat në çastin e hulumtimit (2009) nuk ekzistojnë aspak shenja për drejtimin e zhvillimit të demokracisë së drejtpërdrejt: Qipro dhe Turqia.

Arritjet e demokracisë së drejtpërdrejt

Në çfarë mund të jenë arritjet e demokracisë së drejtpërdrejt nëse krahasojmë përvojat ndërkombëtare?

- ☞ Instrumentet e demokracisë së drejtpërdrejt dhe përdorimi i tyre krijojnë mundësi pjesëmarrëse tematikisht specifike, politikisht përmbajtëse për qytetaret dhe qytetarët. Ata mund të aktivizojnë edhe ato qytetare dhe ata qytetarë „të rëndë“, që anojnë në mënyrë individualiste, anëtarë dhe anëtare të gjeneratës në të cilën ndërrohen vlerat për pjesëmarrje politike, që dëshirojnë të marrin përgjegjësi në politikë, por në gjërat të cilat kanë të bëjnë me ata personalisht, dhe poashtu dëshirojnë që drejtpërdrejt, duke mos kaluar në filterin e cilësdo parti politike, të shprehin mendimin e tyre. Kështu, demokracia e drejtpërdrejt mund të përfshijë burime të reja të pjesëmarrjes dhe potenciale për identifikimin në rrugën prej demokracisë „vëzhguese“ dhe „politike“ kah ajo „pjesëmarrëse“ dhe „qytetare“.
- ☞ Ajo kontribuon në hapjen e strukturave partiake demokratike të fuqisë, ashtu që e shtyejnë qeverinë dhe parlamentin që nën presion më të madh të arsyetojnë para qytetareve dhe qytetarëve diskursin udhëheqës relevant dhe që edeh ata t'i kycin në diskursin mbi vendimet politike, që me zgjidhjet e propozuara t'i bindin se elitat politike nuk dëshirojnë t'i nënshtrohen rrezikut që të humbin në vendvotimin e referendumit.
- ☞ Instrumentet e demokracisë së drejtpërdrejt mbështesin procesin politik transparent dhe të hapur, si dhe imponimin politik, pasi që të gjithë akterët të cilët marrin pjesë në demokracinë e drejtpërdrejt, procesin e vendimarrjes duhet ta „ushqejnë“ me informacione dhe argumente plotësuese dhe në atë mënyrë të krijojnë bazën për diskursin i cili intensifikon kontrollin politik, diskursin përfshirës mes elitave politike dhe qytetarëve dhe qytetareve.
- ☞ Me ndërmjetësimin e procesit të gjerë dhe intenziv të debatit i cili i paraprinë referendumit, dhe me pjesëmarrjen e drejtpërdrejt të të gjithë qytetareve dhe

qytetarëve në vendimarrje, elementet e demokracisë së drejtpërdrejt fuqizojnë integrimin politik të qytetërimit.

- ☞ Përdorimi i instrumenteve të demokracisë së drejtpërdrejt bashkë me pranimin e domosdoshëm të informacioneve, krijimin e kriterëve për vlerësimin dhe matjen e argumenteve mundëson proceset e mësimit politik publik dhe krijimin e përgjegjësisë shtetërore-qytetare për mirëqenien e përgjithshme.

Pasojat në sistemin politik

Shembulli i Zvicrrës na tregoi se demokracia e drejtpërdrejt e fuqishme është e mundur edhe në sistemin modern të shoqërisë; kjo gjithësesi kishte cmimin e saj sa I përket ndarjes së barrës në sistemin politik. Shembulli i Zvicrrës na mëson se ekziston lidhje reciproke mes demokracisë së drejtpërdrejt dhe asaj të harmonizuar. Madje edhe atëherë kur në atë lidhje nuk kritikohet automatizmi, ekzistimi i instrumenteve të demokracisë së drejtpërdrejt nga perspektiva e elitave politike, sidoqoftë rekomandohet angazhimi kooperativ i intereseve dhe organizatave të cilat janë për referendumin në procesin politik, dhe në atë mënyrë edhe dobësimin adekuat të vijave konkurente të demokracisë. Njëherit, krijimi i elementeve të demokracisë së drejtpërdrejt do të thotë fuqizimin e fuqive të qytetarëve/eve në llogari të fuqisë së parlamentit dhe elitave politike të cilat udhëheqin me ato: atë të cilën e fitojnë qytetarët/et, parlamentet e humbin, ngase gjithmonë kur parlamenti është i drejtuar në aprovimin e popullit në kuadër të plebiscitit, ai ndalon së qenit „sovrani“ në lirinë e marrjes së vendimeve. Nga perspektiva e elitave politike futja e elementeve të demokracisë së drejtpërdrejt, pra, në përgjithësi mund të kuptohet si humbje e fuqisë. Poashtu e tendosur është edhe koegzistenca mes demokracisë së drejtpërdrejt të fuqishme dhe kufizimit më të fortë të lirisë së vendosjes së qeverisë legislative dhe ekzekutive me ndërmjetësimin e Gjykatës së fuqishme Kushtetuese, siç është rasti, për shembull, me Gjykatën federale kushtetuese në RS të Gjermanisë. Tensioni nuk është i kursyer as nga lidhjet e demokracisë së fuqishme të drejtpërdrejt me federalizmin e fuqishëm, sidomos në variantën e RS të Gjermanisë ku rruga përmes së cilës krahinat ndikojnë në legjislacionin federal çon përmes parlamenteve krahinore. Ajo rrugë gjermane e pasur me traditë, në rastin e formimit më të fuqishëm të demokracisë së drejtpërdrejt, do të duhej të ndërrohej me atë zvicerane, e cila për plebiscite të caktuara në vend të pjesëmarrjes së qeverive të njësive federale, kërkon shumicën e dyfishtë të popullit dhe kantoneve në plebiscite dhe në atë mënyrë siguron pjesëmarrjen e krahinave në pushtetin legjislativ në nivelin federal.

HELGE BAT

(Përktheu nga gjermanishtja dhe përgatiti Hana Čopić)

PETICIONET DHE PROPOZIMET SI INSTRUMENTE TË DEMOKRACISË SË DREJTPËRDREJTË

Kuptimi latin i fjalës *peticion* është *lutje me shkrim, ismena molba, ankesë me shkrim, lutje e një grupi të qytetarëve drejt trupit kryesues*.

Vet definimi i tillë i nocionit *peticion* tregon që kjo fjalë ka kuptime të shumëfishta dhe të numërta. Nga njëra anë, ai mund të definohet si formë e adresimit të qytetarëve si individë në formën e *kërkesave apo lutjeve* drejt një organi të caktuar shtetëror (publik). Ajo në të njëjtën kohë paraqitet si ankesë me shkrim, në kuptimin e **ankesës** së qytetarëve si individë drejtuar ndonjë organi të caktuar shtetëror. Megjithatë, fjala *peticion* paraqet dhe **adresim kolektiv, grupor** apo kërkesë të qytetarëve ndaj ndonjë organi të caktuar, para se gjithash trupit kryesues me qëllim zgjidhjes së pyetjeve të caktuara të interesi të ngusht apo të gjërë shoqërore, gjegjësisht interes i përgjithshëm në nivel nacional apo nivele më të ulta të qeverisjes. Përveç termave të përmendur, shpesh përdoret fjala **propozim** e cila, duket se sublimon të gjitha format e ndryshme të adresimit individual dhe grupor drejt një organi të caktuar shtetëror ose një trupi publik pa përcaktim të veçant të përmbajtjes së saj terminologjike.

Mu për këtë arsye, që termat e ndryshëm paraqesin forma të ndryshme dhe qëllime të adresimit të qytetarëve drejt organit shtetëror, trupit kryesues apo cilit do trupi tjetër publik, ekziston nevoja për definim të qartë terminologjik dhe përmbajtës të tij. Nga ana tjetër, shtrohet pyetja, në çfarë afati kohor, më çfarë procesi dhe në çfarë mënyre organet shtetërore kanë obligim dhe detyrim që në këso kërkesa të qytetarëve apo grupeve të qytetarëve të përgjigjen. Dhe në vijë të fundit, si „benefit“ që e kanë qytetarët nga përgjigja në këso kërkesa të qytetarëve. Me një fjalë, kjo don të thotë se vetëm një ligj i posaçëm mund të zgjidh dilemat e caktuara por edhe mënyrën e veprimit të organeve shtetërore me rastin e kërkesave të ndryshme për shkak të cilave u janë drejtuar qytetarët.

E drejta në paraqitje të peticioneve dhe propozimeve tjera, në shumë demokraci perendimore, edhe sot kan rrol të rëndësishëm në promocion, mbrojtje dhe përparimin e të drejtave të njeriut nga një anë dhe krijimit të shoqërisë demokratike, moderne dhe të hapur nga ana tjetër. Zhvillimi i teknologjisë informatike, në kohën e fundit ka nis edhe pyetjen e rregullimit juridik të mundësisë së paraqitjes së peticionit dhe projekteve tjera duke kyçur dhe mbledhjen e nënshkrimeve nëpërmjet internetit.

Për fat të keq, edhe pse kjo e drejtë, në të kaluarën e edhe sot në Sërbë, njihet si një nga të drejtat fundamentale, politike, të garantuara me kushtetutë, kjo kryesisht

ka mbetur e marginalizuar, para se gjithash sepse nuk ka pas përgjigje adekuate të qeverisë në lidhje me përcaktimin terminologjik të formave të ndryshme të adresimit drejt trupave publike, të “zhanreve” të ndryshme, mënyrës së realizimit të tyre dhe promovimit të kësaj të drejte.

Kushtetua e dikurshme e RSJ nga viti 1992 (i cili ka vlejtur deri në themelimin e bashkësisë së shteteve të Sërbisë dhe të Malit të Zi në vitin 2003), në korpusin e të drejtave të njeriut ka “identifikuar” *të drejtën në ankesa, peticione dhe propozime* në këtë mënyrë: “Qytetarët kanë të drejtë publikisht të kritikojnë punën e organeve shtetërore dhe organizatave dhe funksionerëve dhe t’ju paraqesin ankesa, peticione dhe propozime e në këto të marrin përgjigje nëse e kërkojnë një të tillë”.

Nga një formulim i tillë jo i qartë, mund të konkludohet se peticionet, ankesat dhe propozimet gjegjësisht format e kritikës (së lejuar) publike të qytetarëve, individuale apo grupe drejt organeve shtetërore, por pa përcaktim më të afërt se çka nënkuptohet me këta nocione. Por, Kushtetuta e RSJ ka paraparë dhe obligimet e organeve shtetërore, organizatave dhe funksionerëve të përgjigjen në to, nëse parashtruesi i tyre e kërkon këtë.

Kushtetua e Sërbisë nga viti 2006 në paragrafin 56 vërteton si një nga të drejtat e garantuara të njeriut – *të drejtën për peticion*. Duket se ky emërtim kushtetues është shumë i ngushtë, që tregon dhe përpunimi normativ i këtij paragrafi, sepse në këtë paragraf të kushtetutës vërtetohet jo vetëm e drejta në peticion por edhe paraqitja e propozimeve tjera. Propozimi tjetër nuk është peticion, por formë tjetër e shkruar, ndërsa vet Kushtetuta nuk përpunon tutja as termin *peticion* e as termin *propozime tjera*. Meqë ligji i veçant nuk ekziston, mbetet e paqartë dhe çfarë don të thotë peticion, dhe dilemë edhe me e madhe ekziston me shprehjen *“propozime tjera”*. Si edhe kushtetuta e RSJ, edhe kushtetuta e Sërbisë nga viti 2006, parasheh obligimin e organeve shtetërore dhe organizatave që ju është besuar kryerja e autorizimeve publike të japin përgjigje ndaj parashtruesit të ankesës apo propozimit nëse e kërkon pala, por për këtë nuk është vërtetuar e as përpunuar procedura e veçant.

Rregullimi kushtetues thotë: *“Secili ka të drejtë që i vetëm apo së bashku me të tjerë, të drejtojë peticione dhe propozime tjera drejt organeve shtetërore, organizatave të cilave i janë besuar autorizimet publike, organeve të krabinës autonome dhe organeve të njësisve të vetqeverisjes lokale dhe nga to të merr përgjigje kur e kërkon. Për shkak të adresimit të peticioneve dhe propozimeve askush nuk mund të përballë me pasojat e dëmshme. Askush nuk mund të vuaj pasojat të dëmshme për qëndrimet e shfaqura në peticionin apo propozimin e paraqitur, përveç nëse nuk është bërë veprë penale.”*

Në Sëri nuk ka rregullim ligjor të veçant i cili në mënyrë të përgjithshme vërteton sistemin e kompletuar të realizimit të kësaj të drejte të njeriut. Ligji i fundit që merrej me

ankesat dhe propozimet e tjera, është miratuar çysh në kohën e periudhës komuniste (1977), dhe nuk vazhdon nga viti 2002. Ligji i ri kurr nuk është miratuar, e as sot nuk është në fazë përpunimi. Sipas kësaj, meqë nuk ka ndonjë ligj të veçant që rregullon mënyrat e realizimit të së drejtës kushtetuese në peticione dhe propozime tjera, mbetet pyetja se në çfarë mënyre kjo e drejtë mundet të realizohet.

Fakti se nuk ekziston rezhim juridik, në masë të madhe “pengon” realizimin e të drejtës për paraqitje të peticioneve dhe propozimeve tjera. Rregulla të caktuara vetëm pjesërisht janë të vërtetuara, si për shembull, *Me ligjin për vetqeverisje lokale* nga viti 2007, i cili peticioneve dhe propozimeve tjera ja kushton “plotë” dy paragrafe. Kur themi në “kuptimin më të gjërë” kjo don të thotë që ligji i lartpërmendur nuk flet direkt për peticionet dhe propozimet por për format e pjesëmarrjes direkte të qytetarëve në formën e iniciativave qytetare.

Me rregullorën e vjetër të Asamblesë Kombëtare, është vërtetuar që një nga trupat e përhershme është edhe Këshilli për ankesa dhe peticione, i cili është konstituuar në maj të vitit 2010 (me vonesë prej 2 vjetësh), dhe i cili në bazë të Rregullores së re të Asamblesë kombëtare do të ndaloj së ekzistuari nga thirrja e re. Megjithatë, me rregullorën e re është paraparë që funksioni i çdo këshilli është që në kuadër të fushveprimit të saj të shqyrtoj iniciativën, peticionin, ankesat dhe propozimet nga fushveprimi i saj.

Ligji mbi Qeverinë dhe Rregullorja e punës së Qeverisë së Republikës së Serbis, edhe pse qeveria është një nga gjashtë organet më të larta shtetërore të caktuara me Kushtetutën e Republikës së Serbis nuk përmban asnjë normë e cila do të rregulloj realizimin e së drejtës në propozime dhe peticione.

Ligji mbi administratën shtetërore përmban dispozitat për të drejtën në ankesë, por parashtrohet pyetja përmbajtësore se çfarë në bazë të formave ligjore është ankesa qytetare.

Në proceset e ndryshme gjyqësore, palët mundën nëpërmjet ankesave të i drejtohen për shembull kryetarit të Gjyqit. Në kuptimin e gjërë, ankesat gjithashtu kanë karakter “të propozimeve tjera” e çfarë janë këto propozime tjera, duke marr parasysh faktin se ne lidhje me realizimin e kësaj të drejte nuk ka ligj të kompletuar i cili do të definonte nocionet peticion, ankesë, propozim dhe ngajshëm, krijohet *një zbrastësirë e rëndësishme juridike që në masë të madhe pamundëson dhe humb kuptimin e kësaj të drejte të njeriut.*

Mosekzistimi i i afateve kohore të caktuara me ligj, në të cilat, organet shtetërore, organizatat të cilave ju është besuar autorizimi publik, organet e krahinave autonome dhe organet e njesive të vetqeverisjes lokale do të ishin të obliguara të ju përgjigjen parashtruesve, mosekzistimi i formës së caktuar juridike dhe ngajshëm vetëm se janë

pasoja të mosekzistimit të një rezhimi juridik të veçant të realizimit të kësaj të drejte të njeriut.

Plotësisht është e qartë se arsya qëndron në faktin se për promovimin dhe avansimin e kësaj të drejte të njeriut nuk ekziston interes i veçant i organeve të qeverisjes publike, por realizimi i kësaj të drejte kërkon edhe detyrime dhe përgjegjësi të reja. Në fakt, kjo e drejtë jep dy lloje obligimesh për organet e qeverisë: të shqyrtoj peticionin, parashtrësën, propozimin ose ankesën dhe të japin përgjigje parashtruesve të tyre në afate reale të përshtatshëm.

Praktika tregon se rregulloret komunale dhe të qyteteve këtë pyetje e rregullojnë kryesisht në formë të përgjithshme, dhe se format e peticioneve, parashtrësave, ankesave ose propozimeve, sipas rregullave nuk përcaktohen, e as edhe procesi e as mënyra sipas së cilës organet e qeverisjes publike vepron pas pranimi të tyre. Për këtë arsye e drejta për parashtrësë dhe propozime tjera, as në nivel të shtetit e as në nivel të komunës, komunës së qytetit apo qytetit nuk ka në praktikë atë rëndësi të cilën ja ofron Kushtetuta dhe ato që realisht duhet ti ketë – pra të jau mundësoj thelbësisht qytetarëve të nisin iniciativa aktive dhe bartësve të qeverisë të ju jap propozime konstruktive dhe kualitative të zgjidhjes së çështjeve të interesit të përbashkët dhe të përgjithshëm, që është me rëndësi për kalimin e demokracisë formale në demokraci reale, si edhe për ndërtim të institucioneve të një shoqërie të hapur dhe të lirë.

Qytetarët nëpërmjet parashtrësave, peticioneve, ankesave dhe propozimeve, individualisht dhe kolektivisht, mund të japin propozime joformale për miratim apo ndryshim të rregulloreve komunale, të paraqesin lutje dhe sugjerojnë zgjidhjen e problemeve konkrete të caktuara në teritorin e komunës, propozojnë mënyra të zgjidhjes të ndonjë çështje me rëndësi për qytetarët e komunës së qytetit, qytetit ose komunës ku drejtohen kritikrat dhe ankesat për veprime të padrejta dhe të pazakonta të organeve të qeverisë ndaj tyre.

Për këtë arsye, aksioni afirmativ që garanton fuqizim të aktivizmit qytetarë, në kuptimin e paraqitjes më të shpeshtë të parashtrësave, propozimeve, peticioneve dhe ankesave nga qytetarët, është me rëndësi të madhe për ngritjen e vetëdijës tek qytetarët që qytetari në kohë bashkëkohore nuk është subjekt por një pjesëmarrës aktiv i proceseve shoqërore, posaçërisht në nivel të bashkësive lokale.

dr DEJAN MILENKOVIĆ

A) PETICION**Çfarë është peticioni?**

Peticion është të drejtuarit me shkrim, me të cilën një grup i qytetarëve/qytetareve kërkon nga organet e qeverisjes publike të nis proces apo të ndërmarr masa ose veprime nga kompetencat e tyre.

Cila është baza ligjore për peticion?

Kushtetuta e Republikës së Serbis. E drejta për peticion është e drejtë e garantuar me Kushtetutë e vërtetuar me paragrafin 56 të Kushtetutës së Republikës së Serbis. “Secili ka të drejtë, që vet apo së bashku me të tjerë, të adresojë peticione dhe propozime tjera ndaj organeve shtetërore, organizatave që ju është besuar autorizimi publik, organeve të krahinës autonome dhe organeve të njësisve të vetqeverisjeve lokale dhe nga ato të marrin përgjigje kur të ju kërkohet.”

A është peticioni formë e adresimit kolektiv i qytetarëve dhe cilave institucione ju drejtohet?

Peticioni është adresim kolektiv, grupor drejtuar ndonjë organi të caktuar, para se gjithash trupit përfaqësues me qëllim zgjidhjes së një çështje nga rëndësia me interes shoqëror të ngusht dhe të gjërë, gjegjësisht interesit të përgjithshëm në nivel nacional dhe niveleve më të ulta të qeverisë. Nga Kushtetuta e Republikës së Serbis, megjithatë, del se ajo mund të i drejtohet secilit organ shtetëror, organizatave që ju është besuar kryerja e autorizimeve publike, organeve të krahinave autonome dhe njësisve të qeverisjes lokale. Në Serbi, pra, peticioni nuk paraqet vetëm mundësinë e adresimit të kuvendeve si trupa të përfaqësuesve në të gjitha nivelet e qeverisë por edhe tek organet e tjera të përmendura.

Çfarë duhet të përmbaj peticioni?

Forma e peticionit nuk është e përcaktuar me ligj. Pasiqë peticioni nuk është çfarë është dhe iniciativa popullore apo qytetare, forma e peticionit nuk duhet të jetë aq „strikte“ siç është rasti me kërkesën për nisje të iniciativës legjislative. Për këtë arsye, peticioni duhet të përmbaj vetëm disa elemente bazë: 1) emri i organit kujt po i drejtohet peticioni; 2) baza kushtetuese për paraqitje të peticionit me kërkesën që në peticion të përgjigjet; 3) kërkesë qartësisht e formuluar, propozime dhe të ngjashme nga parashtruesi; 4) shpjegimi

i kërkesës së propozimit dhe të ngjajshme nga paraqitësi i parashtrësës, nëse është e nevojshme; 5) emri dhe mbiemri i nënshkruesit, nënshkrimi i tyre dhe adresa e banimit (cilado e dhënë tjetër në bazë të formës së peticionit nuk do të jetë e domosdoshme); 6) nëse nga organet e qeverisjes publike kërkohet të i përgjigjen peticionit, qartë të theksohet kjo kërkesë; 7) emri dhe mbiemri, nënshkrimi, adresa dhe numri i amzës i personit që ka nisur peticionin – përfaqësuesve tjerë të nënshkruesve me rastin e kërkesës konkrete.

Çfarë mund tjetër të përmbaj peticioni?

Në epokën e teknologjive informatike, kur nga organet kërkohet përgjigje, përfaqësuesi i nënshkruesit të peticionit mund të cek edhe të dhëna të tjera ne peticion, si për shembull numri i telefonit fiks ose e-mail adresa.

SHEMBUJTË MUNDËSHEM TE FORMULARËVE TË PETICIONIT

emri i organit të cilit po i drejtobët peticioni

adresa e organit

Në bazë të nenit 56. të Kushtetutës së Republikës së Sërbisë, qytetarët e poshtënëshkruar paraqesin dhe kërkojnë përgjigje në

PETICION

(kërkesë qartë e caktuar, propozime dhe të ngjajshme nga parashtruesi)

(shpjegim i kërkesës së parashtruesit kur është e nevojshme)

PARAQITËSIT E PARASHTRËSËS

Emri dhe Mbiemri	Adresa e banimit	Nënshkrimi

Vendi dhe data _____

Në emër të përfaqësuesit të paraqitësit: _____
 emri dhe mbiemri _____
 adresa _____
 numri i amzës _____
 numri i letërnjoftimit _____
 e-mail adresa (fakultative) _____
 numri i telefonit (fakultative) _____

B) PROPOZIM

Çfarë është propozim?

Propozim është të drejtuarit me shkrim me të cilën qytetari/ja kërkon nga organet e qeverisjes publike të nis proces ose të ndërmarr masa apo veprime nga kompetencat e veta.

Cila është baza ligjore e propozimit?

Kushtetuta e Republikës së Serbis. E drejta për paraqitje të propozimit vjen nga Kushtetuta e Republikës së Serbis. Me Kushtetutë, e drejta për petition është e garantuar si e drejtë themelore e njeriut në paragrafin 56 të Kushtetutës së Republikës së Serbis dhe me formulacionin kushtetuesjanë të kyçura dhe propozimet tjera, nën të cilët nënkuptohen dhe propozimet dhe format tjera si për shembull, parashtresat ose ankesat. Neni 56 i Kushtetutës thot: “Secili ka të drejtë, që vet apo së bashku me të tjerë, të adresojë peticione dhe propozime tjera ndaj organeve shtetërore, organizatave që ju është besuar autorizimi publik, organeve të krahinës autonome dhe organeve të njëjësive të vetqeverisjeve lokale dhe nga ato të marrin përgjigje kur të ju kërkohet.”

A është propozimi formë e adresimit kolektiv të qytetarëve dhe cilëve organe ju drejtohet?

Propozimi është formë e adresimit individual të qytetarit (personave juridike). Por, kur me propozim kërkohet që të nisen procese që kanë të bëjnë me vetëm se disa persona, e jo për çështje nga interesi i gjërë shoqërorë, duket se propozim mund të paraqesin edhe disa qytetarë/e. Nga Kushtetuta e Republikës së Serbis del që propozimi mund të drejtohet drejt cilit do organ shtetëror, organizatës që ju është besuar kryerja e autorizimeve publike, organeve të krahinave autonome dhe njëjësive të vetqeverisjes lokale.

Çfarë duhet të përmbaj propozimi?

Forma e propozimit në kontekst që po e përmendim, nuk është e definuar me ligj. Ajo është një formë e adresimit „joformal“ drejt organeve pra as vet mënyra e adresimit nuk duhet të jetë aq „strikte“. Propozimi duhet të përmbaj vetëm disa elemente bazë:

- ☞ emrin e organit kujt propozimi po i drejtohet;
- ☞ baza kushtetuese për paraqitje të propozimit me kërkes që në propozim të përgjigjet;
- ☞ formulim të qartë se çka po kërkohet me propozim;
- ☞ shpjegim i kërkesës së propozimit dhe të ngjajshme nëse është e nevojshme;
- ☞ emri dhe mbiemri i paraqitësit, nënshkrimi i tij/saj dhe adresa e banimit.

Çfarë tjetër mund të përmbaj propozimi?

Në epokën e teknologjive informatike, kur nga organet kërkohet përgjigje, paraqitësi i propozimit mund të cek edhe të dhëna të tjera ne propozim, si për shembull numri i telefonit fiks ose e-mail adresa, ose për shembull të kërkohet përgjigje nëpërmjet e-mailit.

SHEMBUJTË MUNDSHËM TË FORMULARIT TË PROPOZIMIT

emri i organit të cilit po i drejtohet peticioni

adresa e organit

Në bazë të nenit 56. të Kushtetutës së Republikës së Sërbisë, qytetarët e poshtënëshkruar paraqesin dhe kërkojnë përgjigje në

PROPOZIM

(propozim i definuar qartë)

(shpjegim i propozimit kur është nevoja)

Vendi dhe data _____

Paraqitësi: _____

emri dhe mbiemri _____

adresa _____

numri i amzës _____

numri i leternjoftimit _____

e-mail adresa (fakultative) _____

numri i telefonit (fakultative) _____

C) PARASHTRISA

Çfarë është parashtrisa?

Parashtrisë është të drejtuarit me shkrim që qytetari/ja ose më shumë persona adresojnë drejt organeve të qeverisjes publike duke shprehur mospajtim në mënyrën e të punuarit dhe veprimit të ndonjë organi të caktuar ose mënyra e tyre e punës dhe veprimit kritikohet nga ana e qytetarëve/qytetareve (mund të quhen edhe vërejtje)

Cila është baza ligjore e parashtrisë?

Kushtetuta e Republikës së Serbis. E drejta për paraqitje të parashtrisë vjen nga Kushtetuta e Republikës së Serbis. Me Kushtetutë, e drejta për petition është e garantuar si e drejtë themelore e njeriut në paragrafin 56 të Kushtetutës së Republikës së Serbis dhe me formulacionin kushtetuesjanë të kyçura dhe propozimet tjera, nën të cilët nënkuptohen dhe parashtriset. Neni 56 i Kushtetutës thotë: “Secili ka të drejtë, që vet apo së bashku me të tjerë, të adresojë peticione dhe propozime tjera ndaj organeve shtetërore, organizatave që ju është besuar autorizimi publik, organeve të krahinës autonome dhe organeve të njëjësive të vetqeverisjeve lokale dhe nga ato të marrin përgjigje kur të ju kërkohet.” Mund të bëhet fjalë për ligje të caktuara, por atëherë ajo merret vetëm me subjekte konkrete, siç është e paraparë me Ligjin mbi radiodifuzion. Përveç shprehjes parashtrisë në ligjet e Serbis përmenden edhe shprehjet tjera, si për shembull vërejtje ose kundërshtim.

A është parashtrisa formë e adresimit kolektiv të qytetarëve dhe cilëve organe ju drejtohet?

Parashtrisa është formë e adresimit individual ose kolektiv të qytetarëve (personave juridik). Ajo me të cilën kjo formë e adresimit me shkrim dallohet nga të tjerat si formë e realizimit të demokracisë participative, është fakti se me këtë shprehet mospajtim apo kritikohet mënyra e punës apo veprimi i ndonjë organi të caktuar të qeverisjes publike nga ana e qytetarëve dhe qytetareve / personave juridik. Nga Kushtetuta e Republikës së Serbis, del që parashtrisa mund të drejtohet drejt cilitdo organ shtetëror, organizatës që ju është besuar kryerja e autorizimeve publike, organeve të krahinave autonome dhe njëjësive të vetqeverisjes lokale. Parashtrisa duhet të dorëzohet drejtëpërsëdrejti tek organi puna e të cilit po kritikohet, gjegjësisht me punën e të cilit paraqitësi i parashtrisë nuk pajtohet.

Çfarë duhet të përmbaj parashtrisa?

Forma e parashtrisë në kontekstin në të cilin po e përmendim nuk është e definuar me ligj. Ajo është një formë e adresimit „joformal“ drejt organeve pra as mënyra e adresimit nuk duhet të jetë aq „strikt“. Parashtrisa duhet të përmbaj vetëm disa elemente bazë: 1) emrin e organit kujt po i drejtohet parashtrisa; 2) baza kushtetuese

për paraqitje të parashtrësës me kërkesen për përgjigje ndaj parashtrësës përveç nëse parashtrësja është anonime; 3) formulim të qartë të kritikës apo mospajtimit që nuk guxon të jetë e drejtuar në formë kërcënimi apo të shprehurit vulgarë; 4) shpjegim të mospajtimit, gjegjësisht kritikës, nëse është e nevojshme; 5) emri dhe mbiemri i paraqitësit, nënshkrimi i tij/saj dhe adresa e banimit (parashtrësja mund të jetë anonime. por në këtë rast nga organi të cilit i është drejtuar nuk mund të kërkohej përgjigje). Parashtrësën mund ta paraqesin edhe më tepër persona. Kur e paraqesin më shumë persona, parashtrësja duhet të përmbajë elemente që përmban edhe peticioni.

Çfarë tjetër mund të përmbajë parashtrësja?

Në epokën e teknologjive informatike, kur nga organet kërkohej përgjigje, mund të paraqitet edhe numri i telefonit fiks ose e-mail adresa, ose për shembull të kërkohej përgjigje nëpërmjet e-mailit.

SHEMBUJ TË MUNDSHËM TË FORMULARIT TË PARASHTRËSJA

emri i organit të cilit po i drejtobet parashtrësja

adresa e organit

Në bazë të nenit 56. të Kushtetutës së Republikës së Serbis, më
poshtë paraqes dhe kërkoj përgjigje në

PARASHTRËSË

(kritikë qartë e definuar ose mospajtim me punën
apo veprimet e organit pa shprehur kërcënime apo shprehje vulgare)

(shpjegim i parashtrësës nga paraqitësi kur mendon se është e nevojshme)

Vendi dhe data _____

Paraqitësi i parashtrësës: _____
emri dhe mbiemri _____
adresa _____
numri i amzës _____
numri i letërnjoftimit _____
e-mail adresa (fakultative) _____
numri i telefonit (fakultative) _____

D) ANKESA

Çfarë është ankesa?

Ankesa është të drejtuarit me shkrim që qytetari/ja drejton organeve të qeverisë publike, dhe në të cilën ceket që me ndonjë akt apo veprim të këtyre organeve është dëmtuar ndonjë e drejtë apo interes juridik.

Cila është baza ligjore e ankesës?





Kushtetuta e Republikës së Serbis. E drejta për paraqitje të ankesës vjen nga Kushtetuta e Republikës së Serbis. Me Kushtetutë, e drejta për petition është e garantuar si e drejtë themelore e njeriut në paragrafin 56 të Kushtetutës së Republikës së Serbis dhe me formulacionin kushtetuesjanë të kyçura dhe propozimet tjera, nën të cilët nënkuptohen dhe ankesat dhe format tjera si për shembull, parashtresat ose ankesat. Neni 56 i Kushtetutës thot: “Secili ka të drejtë, që vet apo së bashku me të tjerë, të adresojë peticione dhe propozime tjera ndaj organeve shtetërore, organizatave që ju është besuar autorizimi publik, organeve të krahinës autonome dhe organeve të njësisive të vetqeverisjeve lokale dhe nga ato të marrin përgjigje kur të ju kërkohet.” Megjithatë, baza ligjore e ankesës vjen nga Ligji për Administratë Shtetërore, Ligjin mbi Mbrojtësin e qytetarëve dhe ligjeve tjera.

A është ankesa formë e adresimit individual dhe cilave organe ju drejtohet?

Ankesa është formë e adresimit individual të qytetarëve (personave juridik). Ankesa në bazë të formës së saj i drejtohet thyerjes konkrete të ndonjë të drejte dhe interesit ligjot me ndonjë akt apo veprim të organit. Ankesa para se gjithash drejtohet kah organet në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe organizatave të cilave ju është besuar kryerja e autorizimeve publike. Megjithatë, në disa ligje, ankesa ka kuptimin e letrës konkrete me të cilën inicohet një proces konkret (si për shembull procesi para Mbrojtësit të qytetarëve), ose ankesat në punën e organeve të administratës shtetërore të vërtetuara me ligjin mbi administratën shtetërore.

Çfarë duhet të përmbaj ankesa?

Forma e ankesës mund të jetë e definuar me ligje të veçanta (psh. ankesa Mbrojtësit të qytetarëve). Por nuk ekziston formë unike e ankesës që do të përfshinte të gjitha organet siç del nga Kushtetuta. Ankesa duhet të përmbaj:

-  emrin e organit kujt ankesa po i drejtohet;
-  veprimi apo sjellja e organit që ka qenë bazë kushtetuese për paraqitje të ankesës;
-  përshkrim i detajuar i situatës në të cilën me ndonje veprim apo sjellje ka ardh deri tek cenimi i të drejtave apo interesave ligjore të qytetarit/es;
-  emri dhe mbiemri i paraqitësit, nënshkrimi i tij/saj dhe adresa e banimit.

Çfarë tjetër mund të përmbaj ankesa?

Në epokën e teknologjive informatike, kur nga organet kërkohet përgjigje, paraqitësi i ankesës mund të cek edhe të dhëna të tjera në ankesë, si për shembull numri i telefonit fiks ose e-mail adresa, ose për shembull të kërkohet përgjigje nëpërmjet e-mailit.

**SHEMBULL I MUNDSHËM I FORMULARIT TË ANKESËS
(VETËM NË RAST KUR FORMA E ANKESËS NUK ËSHTË
POSAÇËRISHT E CAKTUAR ME LIGJ)**

emri i organit të cilit po i drejtohet ankesa

adresa e organit

Në bazë të nenit 56. të Kushtetutës së Republikës së Serbis, më poshtë
paraqes dhe kërkoi përgjigje në

ANKESË

(emri i organit kundër të cilit ankesa drejtohet dhe arsya (akti apo veprimi të cilin paraqitësi e sheh si arsye e thyerjes së të drejtës së tij apo interesit juridik))

(përshkrim i detajuar i situatës në të cilën me punën apo veprimin e organit ka ardh deri tek cenimi i të drejtës apo interesave ligjore të qytetarit)

Vendi dhe data _____

Paraqitësi i ankesës: _____

emri dhe mbiemri _____

adresa _____

numri i amzës _____

numri i leternjoftimit _____

e-mail adresa (fakultative) _____

numri i telefonit (fakultative) _____

2.

SERBIA: E DREJTA DHE PRAKTIKA

2.1.

SI VEPROHET ME PETICIONET DHE PROPOZIMET – E DREJTA DHE PRAKTIKA

Mungesa e kornizës së veçantë ligjore me të cilën do të rregullohej veprimi me petitionet dhe propozimet e qytetarëve rezulton në shumë keqkuptime në fushën e zbatimit, por edhe në qëllimet e ekzistimit të kësaj të drejte kushtetutore. Padyshim se para vendosjes së kornizës ligjore për procesimin e peticioneve dhe propozimeve duhet të jepet përgjegjia në pyetjen – cili është qëllimi i peticioneve dhe propozimeve të qytetarëve.

Peticionet dhe propozimet duhet të kenë dobi të dyfishtë – njërën për qytetarët dhe tjetrën për vet pushtetin. Njëra anë dhe tjetra shpeshherë janë të konfrontuara, por përmes peticioneve dhe propozimeve ato mund të bëhen palë-bashkëpunëtoare në ndërtimin e politikave më të mira. Ai ideal mund të arrihet para së gjithash me anë të qasjes sistemike në propozimet dhe problemet e shtruara nga ana e individëve apo grupeve të qytetarëve – me shqyrtimin e tyre të përgjithshëm, mbledhjen dhe kyçjen e zgjidhjeve të mundura gjatë krijimit të politikave publike. Në të vërtetë, pushteti shikon peticionet si pengesë në aplikimin e politikave të hartuara paraprakisht, dhe para peticionistëve, për mosprocesimin e kërkesave të tyre në kohën më të re arsyetohet me ftesat tanimë të realizuara për pjesëmarrje në diskutimet mbi dokumentet strategjike me të cilat janë themeluar politikat dhe masat e realizimit. Mirëpo, qytetari nuk duhet të jetë ekspert dhe nuk mund të pritët që paraprakisht të shtrojë mendimin profesional mbi dokumentin strategjik: debati mbi dokumentet strategjike do të përfshijë qytetarin si anëtarë të organizatës joqeveritare eksperte. Pushteti, pra, nuk mund të presë nga qytetari që të përmbahet nga kundërshtimi i masave të pushtetit.

Ajo që imponohet si zgjidhje e palëve të konfrontuara dhe intereseve legjitime dhe legale është që me vështirimin paraprak të nevojave reale të qytetarëve, të shprehura përmes peticionit dhe propozimeve, të zvogëlohet kundërshtimi i mundur ndaj masave gjatë realizimit të politikave.

Në Serbi, edhe pse nuk ekziston sistem i veçantë i veprimit me peticionet dhe propozimet, gjatë realizimit të projektit janë hasur qasje të ndryshme në realizimin e të drejtave në nivelet e ndryshme të pushtetit – nivelin republikan, krahinor dhe lokal. E përbashkët për të gjitha nivelet e pushtetit është që procesuimi i peticioneve dhe propozimeve t'i besohet kryesisht organit përfaqësues – Kuvendit popullor të Serbisë, Kuvendit të KA të Vojvodinës dhe kuvendeve të qyteteve, komunave dhe komunave qytetare.

Pra, edhe pse përgjegjja e dhënë në peticione dhe propozime është obligim kushtetues e të gjitha organeve të pushtetit publik, qasja sistematike e përpunimit dhe procesuimit haset para së gjithash në trupat përfaqësuese, gjë e cila është identike me përvojën paralele juridike. Edhe një karakteristikë tjetër e përbashkët e qasjes institucionale të procesuimit të peticioneve dhe propozimeve është që, kur ekzistojnë trupat e pavarur – mbrojtësit e qytetarëve (ombudsmeni) – poashtu kanë qasje sistematike në përpunimin e peticioneve dhe propozimeve. Mirëpo, duke pasur parasyshë përgjegjësitë e definuara qartë të këtij institucioni, informacionet mbi problemet të cilat nuk janë nën atë kompetencë mbesin të përpunuara si numra në raport dhe shpeshherë resurs i pashfrytëzuar i informacioneve mbi nevojat e qytetarëve. Në disa nivele të pushtetit (më saktë atë krahinor) kjo mungesë „ligjore sistematike” është tejkaluar me vendosjen e bashkëpunimit të obliguar dhe *ad hoc* me zyren e ombudsmanit.

Në kuadër të këtij kapitulli është dhënë shqyrtimi i kornizës institucionale për përpunimin e peticioneve dhe propozimeve në të gjitha nivelet e pushtetit, edhe atë në kornizën e trupit përfaqësues – të cilat, sipas mendimit të autores – janë edhe më të ftuarat që t'i përgjigjen peticioneve dhe propozimeve – përmes krijimit të politikave publike.

KATARINA GOLUBOVIĆ

2.1.1.

Niveli republikan

Me Rregulloren e vjetër të Kuvendit popullor,¹ si një nga trupat e përhershëm, është definuar ekzistimi i Këshillit për parashtrësia dhe peticione. Sipas nenit 67 të kësaj Rregulloreje: „Këshilli për parashtrësia dhe propozime shqyrton parashtrësat dhe propozimet të cilat i janë drejtuar Kuvendit popullor dhe i propozon Kuvendit popullor dhe organeve përgjegjëse masat për zgjidhjen e çështjeve të pëmbajtura në të, dhe mbi të informon dorëzuesit nëse e kanë kërkuar këtë. Mbi vëzhgimet e veta mbi

1 Krahaso: *Rregullorja e Kuvendit popullor* (teksti i pastruar), “Gazeta zyrtare e RS”, nr. 14/09.

parashtresat dhe propozimet Këshilli I dorëzon raport Kuvendit popullor së paku një herë gjatë secilës mbledhje të rregulltë. Këshilli ka 15 anëtarë.”

Mirëpo, ky këshill nuk është takuar një kohë të gjatë, ose për shkak se nuk ka qenë i konstituuar (pas zgjedhjeve në maj të vitit 2008), ose për arsye se, gjatë një periudhe, roli i këtij këshilli ishte i marginalizuar. Këto mungesa të identifikuar në punën e këshillit, ekspertët juridik të YUCOM-it ia kanë theksuar në shumë deklarata për media gjatë realizimit të projektit në shkurt të vitit 2010, me qëllim që ato të eliminohen. Disa herë, YUCOM-i ka kontaktuar Kuvendin popullor, me qëllim që nga ana e shërbimeve përgjegjëse të grumbullohen informacione mbi punën e këtij këshilli. Pikërisht në këtë periudhë, më saktësisht në maj të vitit 2010, pas 2 viteve nga mbajtja e zgjedhjeve, Këshilli për parashtresa dhe propozime është konstituuar.

Sipas fjalëve të dr Novice Kulić, kreut të punëve legjislativo-juridike të Kuvendit popullor të RS, edhe pse nuk ishte konstituuar, punët e këshillit i kryente shërbimi i Kuvendit popullor, të cilit çdo ditë i drejtoheshin qytetarët, në mënyrë gojore dhe të shkruar. Secila parashtresë e qytetarëve regjistrohej dhe shqyrtohej, theksojnë në shërbim.

Në anën tjetër, mbi drejtimin e qytetarëve Kuvendit popullor para konstituimit të Këshillit për parashtresa dhe propozime, dhe masave të ndërmarra, raport ka kërkuar deputetja popullore Vesna Pešić. Raporti është dhënë në vazhdim, me qëllim të dhënies së pasqyrës më të plotë të punës së Kuvendit popullor për parashtresat e qytetarëve.

Shpejtë pas konstituimit, kryetari i Këshillit për parashtresa dhe propozime, deputeti popullor Saša Dujović, theksoi në panel diskutimin (i cili u mbajt në Beograd më 15.06.2010 në organizim të YUCOM-it dhe Fondacionit Hajnrih Bell) se puna e këtij këshilli në periudhën e ardhshme do të jetë intenzive dhe e llojlojshme dhe do të nënkuptojë kyçjen e drejtpërdrejt të deputetëve popullor në zgjidhjen e problemeve të qytetarëve. Janë paraparë ditët e dymë të hapura, kur deputetët drejtpërdrejt do të pranojnë palë në ndërtesën e Kuvendit popullor. Poashtu, Dujović theksoi se takimet e Këshillit do të mbahen edhe jashtë Beogradit.

Pas konstituimit, Këshilli u takua me përfaqësuesit e YUCOM-it dhe Fondacionit Hajnrih Bell, me qëllim të vendosjes së formave të mundura të bashkëpunimit. Këto dy organizata kanë ofruar ndihmën e tyre konsultative dhe dhënien e informacioneve mbi përvojat e shteteve tjera në fushën e procesimit të peticioneve dhe propozimeve, si dhe rekomandimet për përmirësimin e punës së këtij Këshilli, të ndërtuara përmes identifikimit të shembujve të praktikës së mirë në botë por edhe në Serbi.

Që më 04.11.2010 është mbajtur mbledhja e Këshillit për parashtresa dhe propozime jashtë Beogradit – në Nish. Është vendosur bashkëpunimi i Këshillit për parashtresa dhe propozime me trupa tjerë të pavarur.

Këto janë hapat e parë në vendosjen e mekanizmit efikas për procesimin e peticioneve dhe propozimeve nga ana e trupit përfaqësues. Në vazhdim, me qëllim të kuptimit të rolit të Këshillit për parashtresa dhe propozime, është dhënë raporti i parë i cili është dorëzuar nga ana e këshillit Kuvendit popullor për aprovim.

Kjo kuptueshmëri dhe zhvillimi i rolit të Këshillit për parashtresa dhe propozime është shumë e rëndësishme për arsye se, sipas Rregullores së re të Kuvendit popullor¹, ky Këshill do të ndërpresë ekzistimin e tij pas mbledhje së re. Mirëpo, me Rregulloren e re është paraparë që funksioni i çdo këshilli është që në kuadër të fushëveprimit të tij, të shqyrtojë iniciativat, peticionet, parashtresat dhe propozimet nga fushëveprimi i tij. Nëse vet Këshilli për parashtresa dhe propozime brenda 2 viteve (gjatë kohës e cila, siç parashihen gjërat, do të kalojë deri tek zgjedhjet e reja) ndërton mekanizëm efikas për shqyrtimin e peticioneve dhe propozimeve, përvoja e tij e shënuar në masë të madhe do t'i shërbejë trupave të ardhshëm të cilët do t'i kryejnë përgjegjësitë në kuadër të fushëveprimit të tyre.

KATARINA GOLUBOVIĆ

REPUBLIKA E SERBISË

KUVENDI POPULLOR

01 Numër 9-1402/10

19. maj, viti 2010

Beograd

GRUPI I DEPUTETËVE

PARTIA LIBERALE DEMOKRATIKE

- Deputetes popullore, zonjës Vesna Pešić -

Lënda: Kërkesë për dhënien e informacioneve mbi punën e Këshillit për parashtresa dhe propozime si dhe informacione mbi parashtresat dhe propozimet të cilat qytetarët ia kanë drejtuar Kuvendit popullor në tri deri pesë vitet e fundit, 01 Numër 9-1402/10 nga 18 maji i vitit 2010;

Enderuar,

Lidhur me kërkesën Tuaj e cila ka të bëjë me parashtresat dhe propozimet e qytetarëve të drejtuara Kuvendit popullor në tri deri pesë vitet e fundit, Ju japim të dhënat në vazhdim:

¹ Krahaso: *Rregullorja e Kuvendit popullor* (teksti i pastruar), "Gazeta zyrtare e RS", nr. 52/10

1. Kur ka humbur apo është ndërprerë puna e Këshillit për parashtrësia dhe anketa të qytetarëve?

Lidhur me këtë pyetje, tregojmë në faktin se në Kuvendin popullor të Republikës së Serbisë gjithnjë ka ekzistuar trupi punues, gjegjësisht Këshilli i cili në fushëveprimin e tij kishte shqyrtimin e parashtrësive dhe propozimeve të cilat qytetarët ia kanë drejtuar Kuvendit popullor të Republikës së Serbisë.

2. Sa kohë nuk ka ekzistuar ai Këshill dhe cila është arsyeja e mosekzistimit të tij?

Siç kemi treguar në Kuvendit popullor të Republikës së Serbisë gjithnjë ka ekzistuar këshilli i cili merrej me çështjet e parashtrësive dhe propozimeve të qytetarëve të cilat janë drejtuar Kuvendit popullor të Republikës së Serbisë.

3. Kur është themeluar këshilli i ri, kush është kryetar i tij, data e themelimit, cilat janë detyrat e tij kryesore dhe kush janë kryetari dhe anëtarët e Këshillit?

Këshilli për parashtrësia dhe propozime i kësaj mbledhje është konstituuar pjesërisht në atë mënyrë që është bërë verifikimi i anëtarëve të këshillit në mbledhjen e Këshillit të cilën e ka ftuar kryetarja e Kuvendit popullor dhe është mbajtur më 28 tetor të vitit 2008.

Pasi që në çastin e dhënë ende nuk ekzistonte pajtueshmëria lidhur me zgjedhjen e kryetarit dhe zëvendësit të tij, Këshilli ndaloi punën dhe në vazhdim të asaj mbledhjeje, dhe më 13 maj të vitit 2010, zgjodhi kryetarin e Këshillit dhe zëvendësin e tij.

Këshilli për parashtrësia dhe propozime ka 15 anëtarë, për kryetar të Këshillit është zgjedhur deputeti popullor Saša Dujović kurse zëvendës i tij deputeti popullor Kenan Hajdarević. Anëtarët e Këshillit janë:

Dujović Saša, kryetar i Këshillit
Hajdarević Kenan, zëvendës i kryetarit
Budimirović Jelena,
Videnović Maja,
Vuković Slobodan,
Jovišić Jadranka,
Marčok Pavel,
Mojsilović Radoslav,
Mitrović Branislav,
Nikolić Tijana,
Paunković-Milosavljević Gordana,
Petrov Zoran,
Prelić Dobrisav,
Spaho Sulejman,
Stojanović Svetlana.

Fushëveprimi i Këshillit është definuar me Rregulloren e Kuvendit popullor të Republikës së Serbisë, nenin 67, me të cilin është rregulluar që Këshilli të shqyrtojë parashtrësas dhe propozimet të cilat i janë drejtuar Kuvendit popullor dhe i propozon Kuvendit popullor dhe organeve përgjegjëse masat për zgjidhjen e çështjeve të dhëna në ato, dhe mbi atë informon dorëzuesit, nëse e kanë kërkuar këtë. Mbi vëzhgimet e tyre gjatë parashtrësave dhe propozimeve, Këshilli i dorëzon raport Kuvendit popullor së paku një herë gjatë secilës mbledhje të rregulltë.

4. A ekziston numër i përafërt i ankesave dhe parashtrësave të cilat qytetarët ia kanë drejtuar Kuvendit popullor në periudhën e vitit të fundit apo, nëse ka mundësi pesë vitet e fundit?

Lidhur me këtë pyetje, japim të dhënat ne vazhdim:

Në vitin 2006, Këshillit për parashtrësas dhe propozime i janë dorëzuar 447 parashtrësas;

Në vitin 2007, Këshillit për propozime dhe parashtrësas i janë dorëzuar 450 parashtrësas;

Në vitin 2008, Këshillit për propozime dhe parashtrësas i janë dorëzuar 316 parashtrësas;

Lapovo	Njegoševa 18, 34220 Lapovo, office@lapovo.org	Jo	
Ljubovija	Vojvode Mišića 48, 15320 Ljubovija, opsljubovija@ptt.rs	Po	Komisioni për paraqitje dhe ankesa
Luçani	Jugoslovenske Armije 5, 32240 Lučani, solucani@eunet.rs	Po	Komisioni për paraqitje dhe ankesa
Majdanpek	Trg oslobođenja bb, 19250 Majdanpek, majdanpekso@ptt.rs	Po	Komisioni për paraqitje dhe ankesa
Mali Zvornik	Kralja Petra I 38, 15318 Mali Zvornik, jurosevic.miladin@gmail.com	Po	Komisioni për paraqitje dhe ankesa
Medvegja	Jablanička 48, 16240 Medveđa, medvedja@medvedja.org.rs	Po	Komisioni për paraqitje, propozime dhe ankesa
Meroshina	Cara Lazara 12, 18252 Merošina	Po	Komisioni për paraqitje dhe ankesa
Mionica	Vojvode Mišića 30, 14242 Mionica, somionica@ptt.rs	Po	Komisioni për paraqitje dhe ankesa
Negotin	19300 Negotin, Trg Stevana Mokranjca 1, informatikang@yahoo.com	Po	Komisioni për çështje statutare, normative, paraqitje dhe ankesa
Nova Varosh	4. decembar bb, 31320 Nova Varoš, ounvaros@gmail.com	Po	Komisioni për paraqitje dhe ankesa
Novi Beçej	Žarka Zrenjanina 8, 23272 Novi Beçej, sonovibecej@novibecej.rs	Po	Komisioni për paraqitje dhe ankesa
Odzaci	Knez Mihajlova 24, 25270 Odžaci, protokol@odzaci.info	Po	Komisioni për paraqitje dhe ankesa
Paraçin	Tome Živanovića 10, 35250 Paraćin, info@opstinaparacin.info	Jo	x
Peçinci	Slobodana Bajića 5, 22410 Pećinci, opstina@pecinci.org	Po	Komisioni për paraqitje dhe ankesa
Petrovac na Mlavi	Srpskih Vladara 165, 12300 Petrovac, info@petrovacnamlavi.rs	Jo	x
Pirot	Srpskih vladara 82, 18300 Pirot, kabinet@pirot.rs	Po	Komisioni për paraqitje dhe ankesa
Plandishte	Srpskih vladara 82, 18300 Pirot, kodeks@lamanet.biz	Po	Komisioni për paraqitje dhe ankesa

Komuna	Kontakti	A ekziston organ i posaçëm	Emri i organit
Preshevo	M. Tita 36, 17523 Preševo, muhamedi-ab@hotmail.com	Po	Komisioni për peticione dhe propozime
Priboj	12. januara 108, 31330 Priboj, opstinapb@ptt.rs	Po	Këshilli për paraqitje dhe propozime
Raça	Karadordeva 44, 34210 Raça, predsednik.opštine@raca.rs	Po	Komisioni për paraqitje dhe propozime
Razhanj	SO Ražanj, 37215 Ražanj, predsednik@razanj.rs	Po	Komisioni për çështje administrative, paraqitje dhe ankesa
Ruma	Glavna 255, 22400 Ruma, privorgruma@neobee.net	Po	Komisioni për paraqitje dhe ankesa
Senta	Glavni Trg 1, 24400 Senta, info@zenta-senta.co.rs	Po	Këshilli për paraqitje dhe ankesa
Šid	Karadordeva 2, 22240 Šid, kabinet@nadlanu.com	Po	Këshilli për paraqitje dhe ankesa
Sokobanja	Svetog Save br.23, 18230 Sokobanja info@opstinasokobanja.com	Po	Komisioni për paraqitje dhe ankesa
Srbobran	Trg Slobode 2, 21480 Srbobran, info@srbobran.rs	Po	Komisioni për paraqitje dhe ankesa
Surdulica	Kralja Petra I br.1, 17530 Surdulica, office@surdulica.org.rs	Po	Komisioni për paraqitje dhe ankesa
Svrljig	Radetova 31, 18360 Svrljig, predsednik@svrljig.rs	Po	Komisioni për paraqitje dhe ankesa
Temerin	Novosadska 326, 21235 Temerin, opst.tem-sekretar@parabolonet.com	Po	Komisioni për paraqitje dhe ankesa
Topola	Bulevar Kralja Aleksandra I, broj 9, 34310 Topola, predsednik@topola.com	Po	Komisioni për paraqitje dhe ankesa
Trstenik	Kneginje Milice bb, 37240 Trstenik, kabinet.ts@sbb.rs	Po	Komisioni për paraqitje dhe ankesa
Tutin	Husein-bega Gradaševića 7, 36320 Tutin, opstinatutin@nadlanu.com	Po	Komisioni për paraqitje dhe ankesa
Zhitishte	Cara Dušana 15, 23210 Žitište, opština. zitište@gmail.com	Po	Komisioni për paraqitje dhe ankesa
Lajkovac	Omladinski trg 1, 14224 Lajkovac	Po	Komisioni për paraqitje dhe ankesa
Zhabari	Kneza Miloša 103, 12374 Žabari	Po	Komisioni për paraqitje dhe ankesa
Seçanj	Vožda Karadorda 57, 23240 Sečanj	Po	Komisioni për paraqitje dhe ankesa
Ub	ul. 3. oktobra br.4, 14210 Ub	Jo	X
Prokuplje	Nikodija Stojanovića Tatka br. 2, 18400 Prokuplje	Jo	X

Komuna	Kontakti	A ekziston organi i posaçëm	Emri i organit
Zhabalj	Nikole Tesle 45, Žabalj	Po	Komisioni për paraqitje dhe ankesa
Svilajnac	Ulica Svetog Save 102, 35210 Svilajnac	Jo	X
Krupanj	Maršala Tita 2, 15314 Krupanj	Po	Komisioni për paraqitje dhe ankesa
Kurshumlija	Proleterskih brigada bb	Po	Komisioni për paraqitje dhe ankesa
Koceljeva	Nemanjina 74, 15220 Koceljeva	Po	Komisioni për paraqitje dhe propozime
Zhagubica	Trg oslobodenja 1, 12320 Žagubica	Po	Komisioni për paraqitje dhe propozime
Titel	Glavna 1, 21240 Titel	Jo	X

ORGANET E POSAÇME NË KUADËR TË KOMUNAVE QYTETARE PËRGJEGJËSE PËR SHQYRTIMIN E PARAQITJEVE, PETICIONEVE DHE PROPOZIMEVE

Komuna qytetare	Kontakti	A ekziston organi i posaçëm	Emri i organit
Lazarevac	Karadorëva 42, 14230 Lazarevac, protokol@lazarevac.rs	Po	Komisioni për paraqitje dhe ankesa
Nishka Banja	Sindeliçeva 3, 18205 Niška Banja, pitanja@goniskabanja.org.rs	Jo	X
Obrenovac	Vuka Karadžića 74, 11500 Obrenovac, zjovetic@obrenovac.org.rs	Po	Komisioni për paraqitje dhe ankesa
Palilula - Beograd	Takovska 12, 11000 Beograd, info@palilula.org.rs	Po	Komisioni për paraqitje dhe propozime
Rakovica	Miška Kranjca 12, 11090 Rakovica	Po	Komisioni për rregulla, paraqitje dhe propozime
Savski venac	Kneza Miloša 69, 11000 Beograd	Po	Komisioni për paraqitje dhe propozime
Stari Grad	Makedonska 42, 11000 Beograd	Jo	X
Surçin	Vojvodanska 79, 11271 Surçin	Jo	X
Vračar	Njegoševa 77, 11000 Beograd, sovracar@vracar.rs	Po	Komisioni për paraqitje dhe ankesa
Zemun	Magistratski trg 1, 11080 Zemun, info@zemun.rs	Po	Komisioni për paraqitje dhe propozime


Komuna qytetare	Kontakti	A ekziston organi i posaçëm	Emri i organit
Çukarica	Šumadijski trg 2, 11030 Beograd	Jo	X
Vozhdovac	Ustanička 53, 11000 Beograd	Po	Komisioni për paraqitje dhe ankesa
Grocka	Bulevar Oslobođenja 39, 11306 Grocka	Po	Komisioni për paraqitje dhe propozime
Crveni Krst (grad Nish)	Bulevar 12. februar 89, 18000 Niš	Jo	X
Palilula (Nish)	Branka Radičevića 1, 18000 Niš,	Jo	X
Mladenovac	Janka Katića 6, 11400 Mladenovac	Po	Komisioni për paraqitje dhe propozime
Zvezdara	Bulevar Kralja Aleksandra 77, 11000 Beograd info@zvezdara.org.rs	Jo	X
Novi Beograd	Bulevar Mihaila Pupina 167, Novi Beograd 11070	Po	Komisioni për paraqitje dhe ankesa

ORGANET E POSAÇME NË KUADËR TË QYTETEVE PËRGJEGJËSE PËR SHQYRTIMIN E PARAQITJEVE, PETICIONEVE DHE PROPOZIMEVE TË QYTETARËVE

Qytete	Kontakti	A ekziston organi i posaçëm	Emri i organit
Kraljevo	Trg Jovana Sarića 1, 36000 Kraljevo, gradonacelnik@kraljevo.org	Po	Komisioni për paraqitje dhe ankesa
Krushevac	Trg kosovskih junaka 1, 37000 Kruševac, protokol@krusevac.org.rs	Po	Komisioni për paraqitje dhe ankesa
Loznica	Vlade Zečevića 2, 15300 Loznica, office@loznica.rs	Po	Komisioni për paraqitje dhe ankesa
Novi Pazar	Stevana Nemanje 2, 36300 Novi Pazar, office@novipazar.org.rs	Po	Komisioni për paraqitje dhe ankesa
Novi Sad	Žarka Zrenjanina 2, 21000 Novi Sad	Po	Komisioni për paraqitje dhe propozime
Pančevo	Trg Kralja Petra 2-4, 26000 Pančevo, gradonacelnik@pancevo.rs	Po	Komisioni për paraqitje dhe ankesa
Pozharevac	Drinska 2, 12000 Požarevac, uprava@pozarevac.rs	Po	Komisioni për paraqitje dhe propozime
Shabac	Gospodar Jevremova 6, 15000 Šabacopstina@ sabac.org	Po	Komisioni për paraqitje dhe propozime
Smederevo	Omladinska 1, 11300 Smederevo, nacelnikgu@smederevo.org.rs	Jo	x

Qytete	Kontakti	A ekziston organi i posaçëm	Emri i organit
Sombor	Trg Cara Uroša 1, 25000 Sombor, info@so-sombor.com	Po	Këshilli për paraqitje, propozime dhe iniciativat e qytetarëve
Çaçak	Župana Stracimira 1, 32000 Čačak	Po	Komisioni për ankesa dhe propozime
Jagodina	Kralja Petra 6, 35000 Jagodina, sojagodina@ptt.rs	Po	Komisioni për paraqitje dhe ankesa
Nish		Jo	x
Valjevë	Karadordeva 64, 14000 Valjevo	Po	Komisioni për paraqitje dhe ankesa
Vranjë		Po	Komisioni për paraqitje dhe propozime

Duke patur parasyshë përvojën e deritanishme me Këshillin për paraqitje dhe propozime të Kuvendit Popullor¹, kemi bërë një **vështrim të gjendjes mbi kohën e konstituimit** të organeve të posaçme të njërive të qeverive lokale.



- Komunat
- ▨ Komunat qytetare
- ▧ Qyteti

¹ Këshilli për paraqitje dhe propozime i Kuvendit Popullor të Serbisë nuk është takuar që nga viti 2007, kurse në formimin e ri të Kuvendit, pas zgjedhjeve në maj të vitit 2008, është konstituuar në maj të vitit 2010.


	Komunat	Komunat qytetare	Qyteti	Gjithësej
Prej vitit 2008	43	3	2	48
Prej vitit 2009	3	2	2	7
Prej vitit 2010	3	1	0	4
Nuk është konstituuar	3	0	0	3
Nuk është përgjegjur	27	14	9	50

Kur është në pyetje **përbërja** e këtyre organeve zakonisht kanë prej 4 deri 6 anëtarë. Është e shpeshtë dukuria që anëtarët e organit të posaçëm janë zgjedhur nga radhët e qytetarëve (2-3), ku kryetari dhe nënkryetari janë nga radhët e këshillëtarëve.¹

Mirëpo, shumica e këtyre trupave nuk ka publikuar raport mbi punën e vet. Në përgjegje ceket se këta trupa **1.** nuk janë të detyruar të publikojnë raporte të posaçme mbi punën dhe **2.** nuk kanë pasur nevojë për publikimin e raportit, pasi që nga konstituimi nuk kanë marrë asnjë paraqitje.

- ☞ Është interesante se madje 57 nuk janë përgjegjur në këtë pyetje.
- ☞ Është parë se komunat në territorin e Vojvodinës i dërgojnë raport mbi punën e tyre çdo vit Kuvendit të KA Vojvodinës – Këshillit për paraqitje dhe propozime, në formularin adekuat. Komunikimi i vendosur dhe i formalizuar me Këshillin për paraqitje dhe propozime të Kuvendit Popullor të RS dhe trupave të posaçëm në kuadër të njësive të qeverisë lokale – nuk ekziston.
- ☞ Si shembull i praktikës së mirë, gjatë hulumtimeve kemi dashur të theksojmë shembullin e qytetit të Vranjës. Sipas shkresës së kreut të administratës së qytetit të Vranjës: „Komisioni dorëzon raport vjetor mbi punën e tij të cilin e shqyrton dhe aprovon Kuvendi i qytetit të Vranjës. Pas çdo takimi komisioni konkluzionet e tij i publikon në faqen zyrtare të qytetit www.vranje.org.rs“ Sidoqoftë, në faqen e Qytetit të Vranjës nuk ndodhet asnjë informacion mbi konkluzionet dhe takimet e Komisionit etj.


1 Psh. Negotin, Majdanpek, Priboj, Raça, Senta, Zhitishte, Zhabari, Brus, Crna Trava, Kikinda etj.



	Komunat	Komunat qytetare	Qyteti	Gjithësej
I publikuar raporti mbi punën	5	1	3	9
Nuk është publikuar raporti mbi punën	46	5	5	56
Nuk ka përgjegje	37	14	6	57


Siç është thënë më parë, sipas çështjes së **numrit të paraqitjeve**, shumica e njësive të qeverive lokale ka cekur se që nga konstituimi nuk ka pasur paraqitje të pranuar të qytetarëve. Siç duket, puna e trupave të posaçëm dhe ekzistimi i tyre nuk janë transparente, prandaj edhe nuk ekziston vetëdija e qytetarëve mbi ekzistimin e tyre. Gjatë punëtorive dhe panel diskutimeve, qytetarët si problem më të madh kanë cekur mungesën e njohurisë mbi përgjegjësitë e organeve të cilëve dëshirojnë t'i drejtohen dhe u shprehën se një trup i specializuar për pranimin, shqyrtimin dhe drejtimin e paraqitjeve është i domosdoshëm për përfshirjen e qytetarëve në krijimin e politikave publike, ngase më të vërtetë lehtëson qasjen në institucione.

Në pajtim me përgjegjet se a publikohet raporti mbi punën dhe numrin e paraqitjeve të pranuar, kemi bërë një **pasqyrë të kohës së publikimit të raportit mbi punën e organeve të posaçme**.



- Kanë pranuar paraqitje
- Nuk kanë pranuar paraqitje
- Nuk janë përgjegjor

	Komunat	Komunat qytetare	Qyteti	Gjithësej
Kanë pranuar paraqitje	7	1	3	11
Nuk kanë pranuar paraqitje	44	5	5	54
Nuk janë përgjegjor	31	14	11	56



- Komunat
- Komunat qytetare
- Qyteti

Pas analizave të bëra të kornizës ligjore e cili rregullon fushën e peticioneve dhe propozimeve dhe një varg panel diskutimesh të cilat janë mbajtur anembanë Serbisë gjatë projektit, është identifikuar se nuk ekzistojnë rregulla për bërjen e peticioneve dhe propozimeve. Kjo mungesë dukshëm paralizon realizimin e kësaj të drejte, sikur për qytetarët ashtu edhe për pushtetin.

Problemin të cilin qytetarët (sidomos organizatat joqeveritare) e theksojnë, është vështirësia në grumbullimin e nënshkrimeve për peticione, ngase ekziston frika e qytetarëve që nënshkrimet e tyre do të keqpërdoren. Në anën tjetër, ekziston edhe frika e organizatave joqeveritare se në mënyrë joligjore grumbullojnë të dhëna personale të caktuara, dhe se për atë arsye mund të përgjegjen për shkeljen e të drejtës në privatësi të qytetarëve në pjesën e mbrojtjes së të dhënave mbi personalitetin.

Me rastin e kësaj çështjeje, YUCOM kërkoi mendimin e zyres së Komisionerit për qasje të lirë në informacionet me rëndësi publike dhe mbrojtjen e të dhënave mbi personalitetin, dhe kërkoi përgjegje në pyetjen: *„A është i lejuar grumbullimi dhe dërgimi i të dhënave personale të dorëzuesve dhe nënshkruesve të peticioneve/propozimeve, edhe atë të të dhënave personale në vazhdim: emri, mbiemri, numri I letërnjoftimit, JMBG, adresa, qyteti, adresa elektronike, si dhe cilat të dhëna personale të bërësit dhe nënshkruesve të petitionit/propozimit duhet të sigurohen me qëllim të paraqitjes së këtyre personave, gjegjësisht legjitimitimin e tyre para organeve të pushtetit publik?“*

Në vazhdim është dhënë përgjegja, e cila do të duhej të jetë bazë për rregullimin juridik të kësaj fushe.

Një numër i madh i qytetarëve morri pjesë, në kuadër të organizatës së vet apo individualisht, në nënshkrimin e peticioneve; mirëpo, përgjegjet zkaonisht kanë munguar. Më tutje në kuadër të këtij kapitulli janë dhënë rezultatet e hulumtimit të YUCOM-it mbi përvojën e qytetarëve në bërjen e peticioneve. Gjatë bisedës me petitionistët, është parë se problemi më i shpeshtë është definimi i adresës së petitionit. Kjo përgjegje është në të vërtetë bazë për *de lege ferenda* zgjidhjen që petitionet dhe propozimet të shqyrtohen në mënyrë automatike si **trupa përfaqësues** kompetent shërbimet e të cilëve do të dërgonin më tutje peticionet dhe propozimet e pranuar tek organet kompetente për zgjidhjen e kërkesave të shprehura në ato. Në atë mënyrë do të arrihej dobja e dyfishtë – vështrim i përfaqësuesit të popullit në kërkesat dhe nevojat reale të qytetarëve dhe lehtësimin e komunikimit të qytetarëve me pushtetin gjatë zgjidhjes së problemeve të tyre dhe realizimin e propozimeve.

KATARINA GOLUBOVIĆ

2.2.1.

Mendimi i Komisionerit për informacione me rëndësi publike dhe mbrojtjen e të dhënave mbi personalitetin

Republika e Serbisë

Komisioneri për informacione me rëndësi publike dhe mbrojtjen e të dhënave mbi personalitetin
Svetozara Markovića 42
11000 Beograd



Tel: +381 (0) 11 3408-900
Faks:+381 (0) 11 2685-023
office@poverenik.rs
www.poverenik.rs
Adresa postale:
Nemanjina 22-26, Beograd

Numri: 011-00-00106/2010-05

Data:20.05.2010.

KOMITETI I JURISTËVE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Svetogorska 17
11000 Beograd

Të nderuar,

Me rastin e kërkesës suaj numër 504/10 nga 04. maji i vitit 2010 të cilën ia keni drejtuar Komisionerit për informacione me rëndësi publike dhe mbrojtjen e të dhënave mbi personalitetin (më tutje: Komisioneri) me qëllim të marrjes së mendimit mbi çështjet se a është i lejuar grumbullimi dhe përcjellja e informacioneve personale përpiluesit dhe nënshkruesit të peticionit / propozimit, edhe atë të dhënave të ardhshme: emrin, mbiemrin, numrin e letërnjoftimit, numrin personal të qytetarit, adresën, qytetin, adresën elektronike, si dhe cilat të dhëna personale të bërësit dhe nënshkruesit të peticionit / propozimit duhet grumbulluar me qëllim të paraqitjes së këtyre personave, gjegjësisht legjitimimin e tyre para organeve të pushtetit publik, ju informojmë se:

Baza kushtetuese për mbrojtjen e të dhënave mbi personalitetin, për grumbullimin, ruajtjen, përpunimin dhe shfrytëzimin e këtyre të dhënave, si dhe për rregullimin e kësaj materie me ligj, është e përmbajtur në nenin 42. të Kushtetutës së Serbisë. Në bazë të kësaj rregulle kushtetuese është aprovuar Ligji mbi mbrojtjen e të dhënave mbi personalitetin („Gazeta zyrtare e RS“ nr. 97/08 dhe 104/09 - dr. ligji, më tutje: LMDHP), i cili është ligji i përgjithshëm në fushën e mbrojtjes së të dhënave mbi personalitetin. Me këtë ligj rregullohen kushtet për grumbullimin dhe përpunimin

e të dhënave mbi personalitetin, të drejtat e personave dhe mbrojtja e të drejtave të personave të dhënat e të cilëve grumbullohen dhe përpunohen, kufizimet e mbrojtjes së të dhënave mbi personalitetin, procedura para organit përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave mbi personalitetin, sigurimi i të dhënave, evidenca, nxjerrja e të dhënave nga Republika e Serbisë dhe mbikqyrja e zbatimit të këtij ligji (neni 1. LMDHP).

Në mënyrë që të lejohet përpunimi i të dhënave mbi personin, duhet të ekzistojë baza ligjore adekuate. Pasi që LMDHP është ligj i përgjithshëm në fushën e mbrojtjes së të dhënave mbi personin, një ligj i posaçëm me të cilin do të rregulloheshin këto çështje në fushën e caktuar, do të duhej të përmbante rregulla precize mbi të dhënat të cilat mund të përpunohen, mënyrën e përpunimit, qëllimin e përpunimit, mbrojtjen e të dhënave etj në fushën e lëndës. Mirëpo, ligji me të cilin do të rregullohej drejtpërdrejt realizimi i së drejtës kushtetuese në peticion, nga neni 56. i Kushtetutës së Serbisë, nuk ekziston. Megjithatë, ekziston ligji me të cilin rregullohet e drejta e qytetarit që t'i drejtohet organeve përgjegjëse dhe të japë propozime të ndryshme. Ky është Ligji mbi referendumin dhe iniciativën popullore („Gazeta zyrtare e RS“ nr. 48/94 dhe 11/98) i cili parasheh që iniciativa popullore të përmbajë propozimin për ndryshimin apo marrjen e aktit adekuat apo ndonjë propozim tjetër (neni 32). Ky ligj nuk përmbanë rregulla precize mbi përpunimin e të dhënave mbi personin të cilat janë harmonizuar më standardet bashkëkohore, dhe për atë arsye, por edhe arsye tjera, ky ligj do të duhej të ndryshohet rëndësishëm dhe të plotësohet.

Pra, në mungesë të ligjit të posaçëm, gjegjësisht ligjit të posaçëm adekuat, me të cilin në mënyrë precize dhe në pajtim me standardet bashkëkohore do të rregullohej përpunimi i të dhënave mbi personalitetin e përpiluesit të kërkesës, gjegjësisht nënshkruesit të peticionit, gjegjësisht propozimit, kemi LMDHP, i cili si ligj i përgjithshëm në fushën e mbrojtjes së të dhënave mbi personalitetin, momentalisht është ligji i vetëm i cili paraqet bazën ligjore për rregullimin e çështjes së përpunimit të të dhënave mbi personalitetin e këtyre personave.

Në pajtim me rregullat e LMDHP, përveç ligjit, si bazë ligjore për përpunimin e të dhënave mbi personalitetin, kjo mund të jetë edhe pranimi i personit me të cilin kanë të bëjnë të dhënat mbi personalitetin (neni 10. LMDHP). Personi mund të japë pranimin e tij të plotvlefshëm pasi të jetë informuar nga ana e udhëheqësit të të dhënave mbi të gjitha çështjet e cekura në nenin 15. LMDHP. Në pajtim me nenin 11. të LMDHP pranimi për përpunimin e të dhënave mbi personalitetin mund të tërhiqet.

Sidomos dëshirojmë të theksojmë faktin që LMDHP (neni 16 – 18) njeh sidomos të dhënat e ndieshme mbi personalitetin, kurse ato janë të dhënat të cilat kanë të bëjnë me përkatësinë kombëtare, racën, gjininë, gjuhën, religjionin, përkatësinë në parti politike, anëtarësinë sindikale, gjendjen shëndetësore, marrjen e ndihmës sociale,

viktimën e dhunës, dënimin për vepër penale dhe jetën seksuale. Këto të dhëna mund të përpunohen sipas regjimit rigoroz edhe atë në bazë të pranimin të lirë të personit, përveç se kur me ligj nuk është i lejuar përpunimi as me pajtimin e personit.

Me qëllim të gjetjes së përgjegjes në pyetjet tuaja duhet të merren parasyshë sidomos rregullat e nenit 8. të LMDHP mbi (mos) lejimin e përpunimit. Ky nen i LMDHP rregullon që përpunimi i të dhënave është i lejuar me pranimin e obliguar të personit; përpunimi i të dhënave nuk mund të bëhet për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat është caktuar; qëllimi i përpunimit duhet të jetë i definuar qartë; personi me të cilin kanë të bëjnë të dhënat nuk guxon të jetë i definuar apo i definueshëm pas realizimit të qëllimit të përpunimit; mënyra e përpunimit duhet të jetë e lejuar; e dhëna e cila përpunohet duhet të jetë e nevojshme dhe adekuate për realizimin e qëllimit të përpunimit; numri dhe lloji i të dhënave të cilat përpunohen duhet të përputhen me qëllimin e përpunimit, dhe e dhëna duhet të jetë e vërtetë dhe e plotë.

Duke pasur parasyshë faktin se nuk ekziston ligji, gjegjësisht një ligj i posaçëm adekuat me të cilin rregullohet përpunimi i të dhënave mbi personalitetin e përpiluesit, gjegj. nënshkuesit të peticionit, gjegjësisht propozimit, si dhe që LMDHP, si ligj i posaçëm në fushën e mbrojtjes së të dhënave mbi personalitetin, nuk përmbanë rregulla konkrete të cilat do t'i jepnin përgjegje të drejtpërdrejt pyetjeve tuaja, duhet t'i keni parasyshë rregullat e cekura më lartë të LMDHP, por edhe rregullat tjera të LMDHP, si dhe kuptimin e ligjit, si dhe që të pajisur me këto në rastin konkret të vendosni se cilat të dhëna mund të grumbullohen, të përpunohen, gjegjësisht të shfrytëzohen, dhe për atë ta siguronin pranimin e plotëvlefshëm të personit të cilin paraprakisht e informoni në pajtim me nenin 15. të LMDHP.

ZËVENDËSI I KOMISIONERIT

Aleksandar Resanović, s.r.

Njohja e instrumenteve për përfshirjen e qytetarëve në krijimin e politikave publike

Hulumtimi mbi njohjen e instrumenteve për përfshirjen e qytetarëve në krijimin e politikave publike është realizuar në periudhën shkurt – mars të vitit 2010 për nevojat e projektit „Përfshirja e qytetarëve dhe qytetareve në jetën shoqërore dhe politike përmes përfaqësimit të së drejtës në peticione dhe propozime” të cilin e realizon Komiteti i juristëve për të drejtat e njeriut – YUCOM dhe Fondacioni Heinrich Boll me mbështetjen e Delegacionit të Unionit Evropian për Republikën e Serbisë. Qëllimi i hulumtimit është që të analizojë nevojën e rregullimit juridik dhe promovimit të instrumenteve të demokracisë së drejtpërdrejt përmes analizës së diturisë së qytetarëve mbi instrumentet ekzistuese.

Rezultatet e hulumtimit janë rezultat i përgjegjeve të të anketuarve nga 5 qytete të Serbisë. Ftesa organizatave joqeveritare që të marrin pjesë në punëtoritë mbi peticionet dhe paraqitjet në Novi Sad, Kragujevc, Preshevë, Nish dhe Beograd i është drejtuar nga ana e Fondacionit Heinrich Boll përmes internetit – drejtpërdrejt në 250 e-mail adresa. Pjesëmarrësve të punëtorive nuk i është bërë e ditur realizimi i hulumtimit. Para pjesës edukative, në fillim të punëtorive, pjesëmarrësit janë ftuar të plotësojnë *Pyetësorët për punë*. Gjithësej 64 pjesëmarrës dhe pjesëmarrëse të cilët kanë marrë pjesë në punëtori i janë përgjegjur pyetësorëve plotësisht¹.

Pyetëtori për punë përmbanë pesë pyetje të cilat paraqesin kombinim të llojit të hapur dhe të mbyllur. Pyetjet janë bërë në atë mënyrë që me përgjegje të merret një pasqyrë e njohurisë teorike dhe përvojat praktike mbi përdorimin e instrumenteve të demokracisë së drejtpërdrejt.


Analiza e përgjegjeve të të anketuarve

1. A e keni të njohur termin e së drejtës në peticione dhe propozime dhe nëse po ju lutemi përshkruani çka paraqet ai term për ju?

Përqindja më e madhe e të anketuarve (60%) tregoi dituri të mjaftueshme mbi termet e peticionit dhe propozimeve, kurse një përqindje shumë e vogël e të anketuarve në mënyrë eksplicite shënoi se nuk ka aspak njohuri mbi termet. 27% e të anketuarve

¹ Nëse bëjmë krahasimin e numrit të të ftuarve me numrin e personave të cilët kanë marrë pjesë në punëtori mund të arrijmë tek përfundimi se pjesëmarrja ishte e dobët.

tregoi dituri të caktuar mbi termet por ajo nuk mund të karakterizohet si e mjaftueshme për arsye se të anketuarit kryesisht shënuan se peticioni është akt juridik, dokument formalo-juridik apo kanë shënuar kuptim krejtësisht të gabuar të koncepteve të peticionit dhe propozimit.



Njoha e termeve te peticionit dhe propozimit


- Njohuri te mjaftueshme
- Njohuri te pamjaftueshme
- Nuk ka njohuri

2. A i keni të njohura termet e shprehjeve vijuese? Nëse po ju lutemi shkurtimisht shpjegoni çka nënkuptojnë ato:

- (1) iniciativa popullore
- (2) iniciativa qytetare
- (3) peticioni
- (4) paraqitja
- (5) ankesa
- (6) kundërshtimi

Përqindja më e vogël e të anketuarve ka treguar njohuri në kuptimin e termeve të iniciativës popullore dhe iniciativës qytetare (rreth 92% e të anketuarve aspak nuk e di kuptimin e termeve) gjë që nuk është për t'u habitur pasi që të dy termet janë jstrikt juridike kurse numri më i madh i pjesëmarrësve nuk ishin jurist me profesion. Të anketuarit kryesisht i kanë përzier këto dy terme lëvizjet popullore/qytetare apo iniciativat kolektive të cilat paraqiten në shoqëri gjatë dukurive të caktuara (si shembull i iniciativës popullore është shënuar ndërrimi i Sllobodan Millosheviqit kurse për atë qytetare parade e krenarisë). Sa i përket termit të peticionit numri më i madh i të anketuarve tregoi më shumë njohuri mbi këtë term se sa në përgjigjen në pyetjen nga numri 1. Nëse krahasojmë njohurinë e të anketuarve mbi termet e ankesës, paraqitjes dhe kundërshtimit në krahasim me njohurinë mbi iniciativën popullore dhe qytetare mund të konkludojmë se dituria e të anketuarve mbi këto terme është shumë më e madhe edhe pse shpeshherë janë bërë gabime sic janë lidhja e këtyre termeve me

procesin gjyqësor apo administrativ, pastaj supozimi që këto procedura mund t'i bëjnë vetëm avokatët – në përgjithësi tek pjesëmarrësit mbizotërontë mendimi se paraqitja, ankesa dhe kundërshtimi janë terme zyrtare-juridike.




3. A mundeni shkurtimisht të shënoni dallimin mes termeve në pyetjen e dhënë më lartë?

4. A keni marrë pjesë ndonjëherë në bërjen e ndonjë peticioni apo propozimi (rrethoni përgjegjen)?

Po Jo


Nëse përgjegja është po, në këtë fushë shkurtimisht shënoni në cilin

Përqindja më e madhe e pjesëmarrësve në mënyrë eksplicite theksoi se nuk do të mundej të dallonte termet, kurse një numër shumë më i vogël i pjesëmarrësve tregoi një sasi të njohurisë mbi këtë. Sa i përket pjesëmarrësve të cilët të cilët nuk treguan njohuri të mjaftueshme, si gabime të paraqitura më së shpeshti janë konstatimet se iniciativa popullore dhe qytetare janë iniciativa spontane me ndihmën e të cilëve qytetarët mund të ndikojnë në veprimet e zyrtarëve, kurse paraqitja, ankesa dhe kundërshtimi janë dokumente formalo-juridike. Tek të anketuarit të cilët kanë theksuar se mund të dallojnë termet – për shkak të kompleksitetit të pyetjes dhe njohurisë juridike të kufizuar të pjesëmarrësve – si kriter se kanë treguar njohuri të mjaftueshme është marrë përgjegjja se iniciativa popullore, iniciativa qytetare dhe peticioni janë terme me ndihmën e të cilave qytetarët dhe qytetarët në mënyrë kolektive i drejtohen organeve shtetrorë, kurse paraqitja, ankesa dhe kundërshtimi dërgesa me ndihmën e të cilave qytetarët dhe qytetarët i drejtohen zyrtarëve në mënyrë individuale.



- Njohuri te mjaftueshme
- Njohuri te pamjaftueshme
- Nuk ka njohuri

Një përqindje më e madhe e të anketuarve (52%) u përgjegj se kanë marrë pjesë në bërjen e peticionit, kurse një përqindje më e vogël (48%) u përgjegj se kurrë nuk ka marrë pjesë në atë.




- Po
- Yo

5. A mendoni se është i nevojshëm një ligj i posaçëm sistemik i cili do të rregullonte të drejtën në bërjen e peticioneve dhe propozimeve tjera?

[] Po [] Jo

Shumica e të anketuarve (82%) është përgjegjës se është i nevojshëm një ligj i atillë kurse një numër shumë më i vogël e shprehi të kundërtën. Një numër shumë i vogël i të anketuarve (5%) u përgjigj se nuk ka qëndrim të qartë lidhur me këtë çështje.



Përmbyllja

Nha hulumtimi mund të nxjerrim konkluzionin se një numër i madh i të anketuarve në punëtori është madje edhe sipërfaqësisht i njohtuar me termet e peticionit dhe propozimit, derisa situata me termet strikte juridike – *iniciativa qytetare dhe iniciativa popullore* – është plotësisht e kundërt. Të anketuarit tregojnë njohuri pak më të mirë mbi termet sic janë paraqitja, ankesa dhe kundërshtimi derisa përqindja më e madhe nuk mundet qartë të dallojë termet e cekura më lartë. Një përqindje pak më e madhe tanimë ka marrë pjesë në bërjen e peticionit, derisa shumica (82%) mendon se është i nevojshëm një ligj I posacëm sistemik i cili do të rregullonte këtë çështje. Konkluzioni I përgjithshëm është se përqindja më e madhe e pjesëmarrësve është e njohtuar me termin e peticionit dhe propozimit të cilët nuk janë të rregulluar me ligj sistemik por me terme strikte juridike sic janë iniciativa qytetare dhe popullore të cilat plotësisht janë të rregulluar me rregullore pozitive. Tek termet paraqitja, ankesa dhe kundërshtimi njohuria është pak më e madhe por si arsye për këtë mund të jetë kuptimi gjuhësor i termeve të cekura me ndihmën e të cillit të anketuarit lehtë mund të vijnë deri te konkluzioni se cfar kuptimi kanë ato terme.

Novak Vučo

3.

DREJTËSIA E UE DHE DREJTËSIA KRAHASUESE

3.1.

ÇKA E PËRBËN DEMOKRACINË?

Pasi që demokracia definohet si mbizotërim i popullit, pra si proces në të cilin qytetarët dhe qytetaret zgjedhin politikën, atëherë demokracia e drejtpërdrejt është paradigma e saj më e mirë. Votimi gjatë zgjedhjeve për dikë që do të përfaqësojë intereset tona është, kuptohet, një nga mënyrat që edhe ne drejtpërdrejt të marrim pjesë në vendosje. Por, kurrë nuk do të mund të dijmë se në çfarë mase pajtohemi me përfaqësuesin tonë, që ai apo ajo kanë prioritete të cilat ne i dëshirojmë, e as a është votimi i tij apo i saj rezultat i demokracisë përfaqësuese apo veprimeve politike. Prandaj demokracia përfaqësuese nuk është në gjendje që plotësisht t'i përgjigjet nevojave të qytetërimit. Demokracia e drejtpërdrejt, qytetareve dhe qytetarëve i lë mundësinë që vetë t'i paraqesin propozimet e tyre çdo herë kur mendojnë se për atë ekziston nevoja. Nëse një numër i mjaftueshëm i tyre e konsideron që një çështje vlenë të nënshkruhet, atëherë edhe organi më i lartë legjislativ është i detyruar që të rrespektojë vullnetin e qytetarëve. Pra, siç duket, sistemi demokratik do të prodhojë rezultatet më të mira nëse ekziston lidhja mes demokracisë përfaqësuese dhe asaj direkte.

Edhe Unioni Evropian, i cili konsiderohet pasqyrë e demokracisë moderne, poashtu ka marrë kritika në llogari të mungesës së demokracisë. Për këtë arsye, në Marrëveshjen e Lisabonit është ofruar një instrument i ri demokratik – Iniciativa qytetare demokratike (European Citizens Initiative – ECI). Iniciativa mundëson që një milion qytetarë dhe qytetare të UE të ftojnë drejtpërdrejt Komisionin evropian në shqyrtim të iniciativës e cila është në interesin e tyre dhe njëherit nën kompetencën e UE.¹

Tekstet e dhëna në kapitullin *UE dhe e drejta komparative* paraqesin përpunimin e instrumenteve të demokracisë së drejtpërdrejt në nivel të ndryshme të pushtetit - UE (në nivelin e organizatës mbishtetrore), Zelande e Re (në nivelin nacional), Kalifornia (në nivelin e njërive federative), Bremeni dhe Hamburgu (në nivelin krahinor dhe të qytetit). Njëherit, ata paraqesin shembuj të praktikës së mirë dhe të keqe të cilat theksojnë rëndësinë e pjesëmarrjes direkte dhe aktive në krijimin e jetës (politike)

¹ Më shumë mbi Iniciativën qytetare evropiane në faqen www.uticaj.rs.

dhe marrjen e vendimeve politike – prej pyllëzimit të komunës deri te iniciativa për aprovimin apo ndryshimin e ligjit. Shembujt e Brementi dhe Zelandës së Re tregojnë ligjislacionin e përpunuar më hollësisht dhe në mënyrë precize caktojnë procedurat, gjë që duhet të kontribuojë në veprimin efikas, derisa rastet e Hamburgut dhe të Kalifornisë janë shembuj se si edhe me ndërmjetësimin e instrumenteve të demokracisë së drejtpërdrejt nuk duhen domosdoshmërisht gjithmonë të arrijnë rezultatet më demokratike – rezultatet të cilat sjellin mirëqenien e shumicës.

Mbi instrumentet e demokracisë së drejtpërdrejt në shtetet tjera mund të informoheni përmes faqes www.uticaj.rs. Me këtë rast i falënderojmë të gjithë autorët të cilët kanë dhënë pajtimin për përkthimin e veprave të tyre mbi demokracinë e drejtpërdrejt, si dhe organizatave Hajnrih Bell anembanë Evropës të cilat na mundësuan që, me kontributin tonë të vogël, qytetërimi i Serbisë të njihet me këto vepra në gjuhën shqipe.

Tekstet në këtë kapitull u përkthyen dhe përgatitën nga
HANA ČOPIĆ i NINA ĐURĐEVIĆ FILIPOVIĆ

3.2.

UE – SHKRUARJA E PETICIONIT PARLAMENTIT EVROPIAN²

E drejta në bërjen e petitionit është një nga të drejtat elementare të qytetarëve dhe qytetareve të Evropës:

Cilido qytetar apo qytetare në cilin do çast, si individ apo në grup, mund ta shfrytëzojë të drejtën e vet në dërgimin e petitionit Parlamentit evropian në pajtim me nenin 194 të Marrëveshjes mbi Bashkësinë Evropiane.

Cilido qytetar apo qytetare e Unionit Evropian, apo ndokush me vendqëndrim në një shtet anëtar, mundet individualisht apo në grup t'i drejtohet Parlamentit Evropian me petition, tema e të cilit duhet drejtpërdrejt të jetë e lidhur me atë person apo ata persona dhe të bëjë pjesë në domenin e kompetencës së Unionit Evropian. Cilado kompani, organizatë apo shoqatë poashtu gëzon të drejtën në petition të cilin e garanton Marrëveshja.

Peticioni mund të jetë në formë të ankesës apo kërkesës dhe mund të jetë i lidhur me interese publike apo private. Peticioni mund të jetë kërkesë e individit, ankesë apo vërejtje në mënyrën në të cilën po zbatohet ligji i UE apo apel Parlamentit evropian që të marrë qëndrim rreth një çështjeje. Peticionet e cekura i japin Parlamentit evropian

mundësinë që të tërheqë vëmendjen në çdo shkelje të të drejtave njerëzore të qytetarëve të Unionit evropian nga ana e shtetit anëtar apo pushteteve lokale apo institucioneve tjera.

Kush mund të bëjë petition?

Peticioni mund të bëhet nëse jeni:

- Qytetar apo qytetare e Unionit evropian
- Keni vendqëndrim në shtetin anëtar të Unionit evropian
- Anëtar apo anëtare e shoqatës, kompanisë, organizatës (person fizik apo juridik) me vendqëndrim në shtetin anëtar të Unionit evropian.

Çka mund të jetë temë e petitionit?

Përmbajtja e petitionit duhet të jetë në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi të Unionit evropian, si për shembull:

- Të drejtat tuaja, të dhëna në Marrëveshje, si qytetar apo qytetare të Unionit evropian
- Çështjet ekologjike
- Mbrojtja e konsumatorëve
- Lëvizja e lirë e personave, mallit dhe shërbimeve, tregu i përbashkët
- E drejta në punë dhe çështjet sociale
- Rrespektimi i kualifikimeve profesionale
- Problemet tjera lidhur me zbatimin e ligjit të UE

Vërejtje: Peticionet nuk kanë të bëjnë me kërkesën për qasjen e informacioneve, dhe as nuk merren me komentimin e përgjithshëm të politikës së Unionit evropian.

Peticioni duhet të shkruhet në njërin nga gjuhët zyrtare të Unionit evropian.

Si dërgohet petitioni?

Ekzistojnë dy mënyra për dërgimin e petitionit:

- Me anë të postës
- Me plotësimin e formularit në faqen e internetit

Peticioni duhet të jetë i shkruar ashtu që të ketë kuptim në shpjegimin e problemit dhe të përmbajë të gjitha faktet e rëndësishme dhe të largohet nga ato të tepërta.

Duhet të jetë i shkruar qartë dhe të jetë i lexueshëm, dhe mund ti shtohet përshkrimi i shkurtër i problemit.

Nëse peticionin e dërgoni me anë të postës:

Nëse dëshironi që peticionin ta dërgoni në formë të shkruar (në letër), nuk duhet t'i përmbaheni ndonjë forme definitive. Megjithatë, kryesisht peticioni Juaj duhet të:

- Përbajë emrin Tuaj, kombësinë dhe adresën e përhershme (nëse propozuesi i peticionit është një grup, atëherë duhet të përbajë emrin, kombësinë, adresën e përhershme të përfaqësuesit të grupit apo nënshkruesit të parë);
- Duhet të jetë i nënshkruar.

Peticionit mund t'i shtoni shtesa, përfshirë kopjet e dokumenteve të cilat i keni lidhur me rastin. Peticionin e dërgoni në adresën vijuese:

Parlamenti evropian
Kryetari i Parlamentit evropian
Rue Wiertz
B-1047 BRUSSELS

Nëse peticionin e dërgoni përmes faqes së internetit:

Nëse dëshironi të dërgoni peticionin me plotësimin e formularit në faqen e internetit, duhet të:

- Lexoni informacionet dhe udhëzimet e dhëna në faqen mbi peticionin në ueb faqen e Parlamentit evropian dhe pastaj
- Plotësoni onllajn formularin dhe klikoni „dërgo“.

Pas dërgimit të peticionit duke përdorur formularin onllajn, do të merrni konfirmimin elektronik që është pranuar formulari. Peticioni pastaj i përcillet Këshillit për peticione i cili është përgjegjës për udhëheqjen e procesit të përcjelljes së peticionit dhe formulimit të rekomandimeve dhe konkluzioneve për secilin peticion. Peticionet të cilat përbajnë fjalë fyese apo nuk kanë kuptim, Këshilli nuk do t'i përpunojë më tutje, dhe as nuk do të përgjigjet në ato.

Tërë komunikimin e mëtutjeshëm Këshilli për peticione do ta bëjë përmes postës së rregulltë.

Nëse keni informacione plotësuese apo dokumente të cilat keni dëshirë t'ia bashkangjitni peticionit, i dërgoni përmes postës (shënoni numrin e peticionit) në adresën vijuese:

Committee for Petitions
The Secretariat
Rue Wiertz
B-1047 BRUSSELS

Procedura e Parlamentit të Unionit Evropian

Pjesa VIII: Peticionet

Rregulla 201: E drejta në petition

1. Secili qytetar apo qytetare e Unionit evropian dhe secili person fizik apo juridik i cila ka vendqëndrim apo zyre të regjistruar në shtetin anëtar, ka të drejtë që, individualisht apo në grup, t'i drejtohet Parlamentit me petition edhe atë për çështjet në kompetencat e Unionit evropian, të cilat personalisht apo drejtpërdrejt i përkasin atij personi, gjegjësisht atij grupi të personave.
2. Peticionet e dërguara Parlamentit duhet të përmbajnë emrin, kombësinë dhe adresën e përhershme të çdo nënshkruesi apo nënshkrueseje.
3. Në rast se petitionin e nënshkruajnë disa persona fizik apo juridik, nënshkruesit duhet të caktojnë përfaqësuesin dhe zëvendësin e përfaqësuesit i cili do të jetë petitionuesi (kryesor) me qëllim të zbatimit të këtij neni.
Në rast se nuk është caktuar përfaqësuesi, atëherë si përfaqësues konsiderohet personi i parë i nënshkruar, apo ndonjë tjetër person adekuat për atë funksion, dhe trajtohet si petitionist (kryesor).
4. Secili person i cili ka nënshkruar petitionin në cilindo çast mund ta tërheqë nënshkrimin e tij. Në rast se përkrahjen e tërheqin të gjithë nënshkruesit, peticioni konsiderohet i pavlefshëm.
5. Peticionet duhet të jenë të shkruara në njërën nga gjuhët zyrtare të Unionit Evropian. Peticionet e shkruara në ndonjë gjuhë tjetër do të shqyrtohen vetëm nëse petitionisti ka dërguar përkthimin në njërën nga gjuhët zyrtare. Korrespondenca e Parlamentit me petitionistin do të jetë në njërën nga gjuhët zyrtare në të cilën është përkthyer peticioni. Zyra e Parlamentit evropian mund të marrë vendim që peticioni dhe korrespondenca me petitionistin të bëhen në një gjuhë tjetër e cila përdoret në shtetin e dhënë anëtar.
6. Nëse forma dhe përmbajtja e petitionit janë në pajtim me kushtet e dhëna në paragrafin 2, petitionet regjistrohen sipas radhitjes së njejtë ashtu si kanë arritur; ato të cilat nuk janë në pajtim me paragrafin 2 do të ruhen në dokumentacion dhe petitionisti do të informohet mbi arsyet për refuzim.
7. Peticionet e regjistruara kryetari pastaj ia përcjellë Këshillit përgjegjës. Pastaj Këshilli vendosë se a është peticioni në pajtim me nenin 227 të Marrëveshjes mbi funksionimin e Unionit Evropian.
Nëse Këshilli përgjegjës për petitionin e dhënë nuk arrinë njëzëri të marrë vendim mbi atë se a është peticioni në pajtim me nenin 227 apo jo, do të

konsiderohet se peticioni është në pajtim me ligjin e dhënë atëherë kur së paku një e katërta e anëtarëve të Këshillit e kërkon atë.

8. Peticionet të cilat Këshilli i konsideron të papranueshme do të ruhen në dokumentacion; peticionisti informohet mbi vendimin dhe arsyet e refuzimit. Nëse është e mundur, peticionistit do ti ofrohet mënyrë tjetër për zgjidhjen e çështjes së paraqitur.
9. Pas regjistrimit, sipas rregullës bëhen dokumente publike dhe emrin e peticionistit si dhe përmbajtjen e peticionit Parlamenti mund ta bëjë publike me qëllim të transparencës.
10. Pavarësisht rregullave nga paragrafi 9, peticionisti mund të kërkojë që emri i tij apo i saj të mos publikohet me qëllim të ruajtjes së privatësisë, dhe në atë rast Parlamenti është i detyruar që të respektojë atë kërkesë.
Nëse kërkesa për anonimitetin e peticionistin pengon hetimin mbi ankesën, peticionisti do të konsultohet lidhur me ndërmarrjen e hapave të ardhshëm.
11. Peticionisti mund të kërkojë që peticioni i tij apo i saj të përpunohet si dokument i fshehtë, dhe në atë rast Parlamenti do të ndërmarrë masa adekuate që përmbajtja e peticionit të mbrohet nga publikimi i saj. Peticionistit do t'i tregohet saktë nën çfarë rrethanash vlejné ato masa.
12. Nëse Këshilli vlerëson se është adekuate, lënda mund t'i përcillet ombudsmanit.
13. Peticionet të cilat Parlamentit ia bëjnë personat të cilët nuk janë qytetarë të Unionit evropian dhe nuk kanë vendqëndrim në shtetin anëtar apo zyre të regjistruar, do të regjistrohen veçmas dhe të shënohen si dokumente. Këshillit përgjegjës për peticione kryetari çdo muaj i dërgon raport mbi peticione të atilla, duke theksuar temën me të cilën janë duke u marrë, kurse Këshilli mund të kërkojë që të shikojë ato peticione të cilat dëshiron t'i shqyrtojë.

Rregulla 202: Shqyrtimi i peticioneve

1. Peticionet e pranueshme do t'i shqyrtojë Këshilli i dhënë në pajtim me detyrat e veta të rregullta. Këshilli përpunon peticionin duke diskutuar në takimet e rregullta apo përmes shkëmbimit të shkresave. Peticionistët mund të ftohen që t'i bashkangjiten takimeve të Këshillit nëse peticioni i tyre është në rendin e ditës si temë e diskutimit, ose ata vetë mund të kërkojnë që të marrin pjesë në takim. Kryesuesi ka të drejtë që peticionistëve t'i japë apo t'i marrë fjalën.
2. Lidhur me peticionet e aprovuara Këshilli mund të përpilojë raportin e vet mbi iniciativën, siç është rregulluar me Rregullën 48(1) apo t'i dorëzohet përmbledhja

e kërkesës me rezolutë Parlamentit nëse për atë nuk ka kundërshtime nga ana e Konferencës së kryetarëve. Kërkesat për aprovimin e rezolutës hyjnë në propozimin e rendit të ditës së gjysëm-seansave të cilat mbahen më së voni tetë javë pas aprovimit të kërkesës nga ana e Këshillit. Kërkesa vendoset në votim dhe mbi atë nuk diskutohet përveç se në situatat kur Konferenca e kryetarëve nuk vendosë që në mënyrë të jashtëzakonshme ta shfrytëzojë atë rregullë 139.

Në pajtim me Rregullën 49 dhe Aneksin VII, Këshilli mund të kërkojë mendimin e këshillave tjerë kompetencat e të cilëve kanë të bëjnë me çështjen e cila është në shqyrtim.

3. Për pjesët e raportit të cilat posaçërisht kanë të bëjnë me aplikimin apo interpretimin e ligjit të Unionit apo ndryshimeve të propozuara të ligjeve ekzistuese, këshillat të cilat janë përgjegjëse për ato tema do të ftohen për bashkëpunim, kurse në pajtim me Rregullën 49(1) dhe pikën e parë dhe të dytë të Rregullës 50. Këshilli përgjegjës do të pranojë, pa votim, propozimet të cilat kanë të bëjnë me pjesët e kërkesës për zgjidhje të cilat janë marrë nga këshilli përgjegjës për çështjet me të cilat ka të bëjë kërkesa dhe i cili vendosë mbi aplikimin apo zbatimin e të drejtave të Unionit Evropian apo ndryshimeve të ligjit të dhënë. Nëse Këshilli kryesor dhe përgjegjës për peticione nuk pranon propozimet e dhëna, këshilli ndihmës në mënyrë të drejtpërdrejt mund t'i paraqesë para seansës plenare të Parlamentit.
4. Do të sigurohet mënyra elektronike e regjistrimit përmes së cilës qytetarët dhe qytetaret mund ta japin apo ta refuzojnë përkrahjen ndaj ndonjë iniciative me vendosjen e nënshkrimit elektronik në iniciativat e pranuar dhe të regjistruara.
5. Në rastet kur hetohen peticionet, vërtetohen faktet apo kërkohen zgjidhjet, këshillat mund të organizojnë vizitë në shtetin anëtar apo regionin e caktuar të mbuluar me peticion.
6. Këshilli mund të kërkojë nga Komisioni ndihmë sidomos lidhur me informacionet mbi aplikimin apo zbatimin e rregulltë të ligjit të Unionit dhe informacione dhe dokumente të cilat janë relevante për peticionin. Përfaqësuesit e Komisionit ftohen që të marrin pjesë në takimet e këshillit.
7. Këshilli mund të kërkojë nga kryetari që t'ia përcjellë mendimin apo rekomandimin Këshillit të Komisionit, Këshillit apo qeveritarëve të shtetit të dhënë anëtar në mënyrë që të ndërmerren masa të caktuara apo të gjindet përgjegjja në pyetjen e caktuar.
8. Këshilli informon Parlamentin çdo gjashtë muaj mbi rezultatet e shqyrtimeve të tyre.

Këshilli do ta informojë veçmas Parlamentin mbi masat të cilat i ka ndërmarrë Komisioni apo Këshilli lidhur me çështjen e peticioneve të dërguara.

9. Këshilli informon peticionistin mbi vendimin të cilin e ka marrë si dhe mbi arsyet e atij vendimi.

Pas përfundimit të shqyrtimit të peticionit të pranueshëm, ajo deklarohet si e kryer dhe peticionisti informohet mbi këtë.

Rregulla 203: Informimi mbi peticionin

1. Parlamenti do të informohet mbi peticionet e regjistruara, në pajtim me Rregullën 201(6), si dhe mbi vendimet kryesore mbi procedurat të cilat duhet të përcillen lidhur me peticionin e caktuar. Informimi i cekur i Parlamentit do të futet në raportin e seansës.
2. Titulli dhe përshkrimi i shkurtër i tekstit të peticioneve të regjistruara, si dhe teksti me mendimet dhe vendimet kryesore të dërguara lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike lidhur me peticionin, do të jenë të disponueshme për publikun përmes bazës së të dhënave, me kusht që peticionisti të pajtohet me këtë. Peticionet e besueshme do të ruhen në arkivin e Parlamentit ku deputetët dhe deputetet do të mund të kenë qasje në ato.

Zelanda e Re – Bërja e petitionit Dhomës së përfaqësuesve Hyrje (mbi petitionet)

Pyetja: Çka është peticioni?

Përgjegjja: Kërkesë e nënshkruar për ndërmarrjen e masave të caktuara nga ana e Dhomës.

Peticioni është dokument dedikuar jashtëzakonisht Dhomës së përfaqësuesve të cilin e ka nënshkruar një apo më shumë persona dhe kërkon që Dhoma të ndërmerr masa të defnuara qartë për çështjen e politikës publike apo ligjit, apo të përpunojë ankesë publike apo private.

Pyetja: Kush mund të inicojë apo të nënshkruajë petitionin?

Përgjegjja: Cdokush mund ta nënshkruajë petitionin.

Cdokush pa marrë parasyshë moshën, mund t'i bëjë peticion Dhomës së përfaqësuesve,

Përfshirë edhe korporatat dhe trupat jokorporues të cilat kanë statusin e personit juridik.

Pyetje: A duhet edhe ju ta nënshkruani petitionin për Dhomën?

Përgjegjja: Mund t'i drejtoheni Dhomës së përfaqësuesve me peticion pasi t'i keni shfrytëzuar të gjitha opcionet tjera.

Shkruarja e petitionit Dhomës së përfaqësuesve do të duhej të ishte opioni i fundit. Kur nuk ka mënyrë tjetër, apo kur janë shfrytëzuar të gjitha mjetet tjera të mundësuar me Ligj, mund t'i drejtoheni Dhomës së përfaqësuesve me peticion.

Termet e përdorura në këtë publikim

Peticionisti kryesor – personi si përfaqësues i organizatës i cili inicon peticionin.

Peticionisti kryesor është kryesisht personi i cili ka inicuar apo organizuar peticionin dhe të cilin këshilli i caktuar e fton të japë informacione plotësuese mbi peticionin.

Kujdesuni që ky person të jetë i shënuar qartë në peticion. Kjo librezë është shkruar nën supozimin se Ju jeni peticionisti kryesor.

Kërkesa – Deklaratë e shkurtër në të cilën shpjegohen masat të cilat peticionisti pret t'i ndërmer dhoma.

Letra hyrëse – Pjesa e peticionit në të cilën është shënuar peticionisti kryesor, deputeti/tja i cili paraqet peticionin dhe përmasjtja e tekstit të kërkesës (Formulari OC 1).

Formulari në të cilin grumbullohen nënshkrimet – Formulari në të cilin është shënuar se kujt i drejtohet peticioni (gjegj. Dhomës së përfaqësuesve), kërkesën e peticionit, dhe poashtu vendin ku regjistrohen nënshkrimet (Formulari OC 2).

Mjetet juridike – Mjetet juridike të cilat janë të garantuara me Ligj si mjet i procesimit të peticionit. Përfshijnë edhe mundësinë që ombudsmani të hulumtojë rastin.

Deputeti/tja i cili paraqet peticionin – Deputeti i cili ka pranuar që për Juve të paraqesë peticionin dhe në atë arsyë nënshkruan tekstin hyrës.

Zyra e gjendjes civile – Sekretariati i Dhomës së përfaqësuesve. Institucioni i cili është përgjegjës për kontrollimin e peticioneve sipas parimeve të Rregullores (rregullat dhe procedurat e Dhomës së përfaqësuesve) dhe për dhënien e përkrahjes anëtarëve të këshillit relevant në përpunimin e peticioneve.

Ombudsmani – Zyra e ombudsmanit mund të hulumtojë dhe të shqyrtojë vendimet, rekomandimet apo masat e propozuara të cila janë të lidhura me administratën dhe organet qeveritare, organizatat e qeverisë dhe qeverive lokale. Në faqen www.ombudsmen.govt.nz mund të merrni informacione rreth asaj se a hyn rasti Juaj nën kompetencën e tyre apo jo, apo në zyret e Uellingtonit, Okllandit apo Krajstçerçit, apo në formë të shkruara në PO Box 10-152, The Terrace, Wellington.

Si të përgatisni peticionin

Çka duhet shkruar

Shqyrtimi i të gjitha mjeteve të dhëna juridike: shikoni të gjitha mjetet e mundura juridike, përfshirë edhe adresimin e ombudsmanit. Peticioni nuk do të pranohet nëse nuk i keni harxhuar të gjitha opcionet tjera apo nëse problemi i cili paraqitet përmes peticionit në të vërtetë e ka vendin në gjyq. Ky kufizim ka të bëjë edhe me situatat kur keni të drejtë ankese ndaj vendimit apo jeni duke pritur vendimin.

Si të shkruani kërkesën: Kërkesat duhet të jenë në gjuhën angleze apo gjuhën maore; drejtohuni me rrespekt dhe ton të matur; kërkonin nga Dhoma e përfaqësuesve që të ndërmer masa të qarta; mos shkruani mbi gjërat të cilat nuk janë temë e peticionit.

Kontrollimi i kërkesës: Kontaktoni zyren e gjendjes civile që të vërtetoni në mos Parlamenti (në këtë përbërje) ka vendosur mbi ndonjë petition me kërkesë/përmbajtje të ngjashme. (Kontakti: 04 471 9999; adresa postale:

Zyra e zyrtarëve të Dhomës së përfaqësuesve, Uellington; e-mail petitions@clerk.parliament.govt.nz)

Përgatitja e letrës hyrëse për petition dhe nënshkrim: Nënshkruani letrën hyrëse (shih Formularin OC 1) dhe shënoni adresën e kontaktit në të cilën duhet të dërgohen përgjegjet lidhur me petitionin.

Nëse petitioni rrjedh nga korporata apo organizata jokorporuese, personi zyrtar i autorizuar duhet të nënshkruajë pjesën e përparme të formularit të petitionit të dorëzuar në emër të organizatës, gjegj. korporatës.

Nëse organizata është pjesë e korporatës jashtë Zelandës së Re, avokati i autorizuar mund të nënshkruajë pjesën e përparme të formularit të petitionit të dorëzuar.

Shkruarja e kërkesës: Në letrën hyrëse të kërkesës së petitionit shkruani qartë apo shtypni.

Përgatitja e formularit në të cilin do të shkruhen nënshkrimet dhe grumbullimi i nënshkrimeve: Gjatë grumbullimit të nënshkrimeve në formulare nënshkruesit nuk janë të detyruar të shkruajnë adresën; përveç personave të cilët dëshirojnë ta mbështesin petitionin, por për shkak të rrethanave objektive nuk janë në gjendje ta nënshkruajnë petitionin (personi i cili nënshkruan për personin i cili ka dëshirë të nënshkruhet por nuk ka mundësi duhet ta shënojë atë fakt përkaj nënshkrimin); nënshkrimet duhet të jenë origjinale – nuk do të merren parasyshtë fotokopja, faksi, skenimi, i ngjitur apo në mënyrë tjetër i vendosur në letër).

Peticionet të cilat nuk janë të vlefshme:

Disa nga rrethanat nën të cilat do të refuzohen petitionet janë cekur në vazhdim.

- Peticionet duhet t'i drejtohen në mënyrë direkte Dhomës së përfaqësuesve. Peticionet të cilat adresohen në Guvernatorin gjeneral, ministritë apo cilatdo trupa tjerë apo persona, nuk janë peticione parlamentare dhe prandaj janë të papranueshme.
- Çështjet të cilat janë nën përgjegjësinë e ombudsmanit. Nëse çështja me të cilën merret peticioni Juaj është diçka që do të duhej të hulumtohet nga ana e Ombudsmanit, atëherë së pari duhet t'i drejtoheni atij apo asaj.
- Së pari duhet të përdorni të gjitha mjetet juridike. Peticioni nuk do të pranohet nëse së pari nuk i keni përdorur të gjitha mjetet juridike apo nëse çështja e

formuluar në peticion duhet të zgjidhet në gjyq. Ky kufizim ka të bëjë edhe me situatat kur keni të drejtë ankese ndaj vendimit apo jeni duke pritur vendimin.

- Peticioni Juaj duhet të dallohet nga peticionet e mëparshme të cilat i ka shqyrtuar Dhoma e përfaqësuesve. Nëse përmbajtja e peticionit është e njejtë si në ndonjë peticion të mëhershëm të cilin e ka shqyrtuar Parlamenti (ai i cili është momentalisht në pushtet) dhe ka marrë vendim mbi atë, ajo gjithsesi do të refuzohet. Peticioni i atillë ndoshta mund të pranohet nëse janë mbledhur dëshmi të reja në krahasim me shqyrtimin e tij të mëparshëm.

Paraqitja e peticionit

Roli i deputetit/es

Deputetët/et paraqesin peticionet Dhomës: Kur peticioni është plotësisht i gatshëm, do të kërkohet nga deputeti nga njësia e juaj zgjedhore që ta paraqesë atë.

Deputeti/tja paraqet peticionin ashtu që ia dorëzon zyrtarit të zyrës së gjendjes civile.

Paraqitja e peticionit nuk do të thotë që deputeti/tja pajtohet me përmbajtjen e tij.

Deputeti apo deputetja nuk është i/e detyruar të paraqesë peticionin.

Deputeti/ja i cili paraqet peticionin është i/e detyruar të nënshkruajë letrën hyrëse (shih formularin OC 1).

Roli i zyrtarit të Dhomës

Peticionet i kontrollon zyrtari i zyrës së gjendjes civile. Pasi që t'i dorëzohet peticioni, ai/ajo e kontrollon. Nëse peticioni Juaj është në pajtim me rregullat e vendosura nga ana e Dhomës, do të paraqitet. Në rast se peticioni nuk është në pajtim me rregullat, do t'i kthehet deputetit/es.

Paraqitja e peticionit Dhomës

Peticionet i dorëzohen këshillit, kurse Dhoma informohet mbi këtë. Pasi që të paraqitet peticioni, i dorëzohet këshillit të caktuar veprimtaria e të cilit është relevante për çështjen e peticionit.

Paraqitja e peticioneve të dorëzuara kryesisht është pika e parë e cdo rendit të ditës pas orës 14 gjatë secilës seansë. Zyrtari i zyrës së gjendjes civile lexon emrin e peticionisti kryesor dhe përshkrimin e shkurëtr të kërkesës së cdo peticioni. Nuka ka diskutim.

Përmes cilit proces kalon peticioni?

Si shqyrtohen peticionet nga ana e këshillave?

Këshillat mund të kërkojnë dokumente plotësuese: Kur peticioni Juaj t'i dorëzohet këshillit, është tek këshilli të vendosë se si do të veprojë më tutje. Është e mundur që nga Ju të kërkojnë informacione plotësuese (shitesë). Mund të kërkojë që të shpjegoni më hollësisht natyrën specifike të peticionit. Shitesën duhet ta dorëzoni në formë të shkruar. Këshilli poashtu mund të kërkojë dokumente nga trupat qeveritar dhe palët tjera relevante.

Informacionet plotësuese këshillat mundën edhe t'i dëgjojnë: Këshillat mundën edhe të dëgjojnë paraqitjen e dëshmimeve. Nëse dëshironi t'ju jepet mundësia që t'i drejtoheni personalisht, shënoni këtë qartë në formular. Pritet që Ju vetë t'i paguani shpenzimet rrugore dhe shpenzimet tjera lidhur me deklaratën.

Informacionet plotësuese mbi shkruarjen e parashtrës: Shembullin falas të tekstit Si të shkruani parashtrësën për këshillin parlamentar mund ta gjeni në Zyren e gjendjes civile apo në www.parliament.nz

Pyetjet plotësuese zyrtarit të zyrës së gjendjes civile: Nëse keni cfardo pyetje plotësuese lidhur me shqyrtimin e peticionit Tuaj nga ana e këshillit, ia dërgoni këshillëtarit.

Propozimet e këshillit: Kur është fjala për raportimin Dhomës së përfaqësuesve mbi peticionin, këshilli ka disa opsione. Mes tyre janë: raporti me rekomandimet dhe raporti pa rekomandime; nëse peticioni është shqyrtuar bashkë me ndonjë pikë tjetër të rendit të ditës, këshilli mund ta marrë në konsideratë dhe dhe peticionin t'ia bashkangjesë raportit mbi atë pikë. Nëse këshilli nuk përpilon asnjë rekomandim, nuk do të ndërmerren masa të më tutjeshme mbi çështjen e peticionit Tuaj.

Do të informoheni mbi paraqitjen e peticionit Tuaj: Pas paraqitjes së raportit mbi peticionin Dhomës së përfaqësuesve, këshillëtarit dot'ju informojë mbi rezultatin e shqyrtimit të tij.

Dërgimi i raportit Qeverisë

Masat e Qeverisë mbi çështjen e raporteve të pranuar mbi peticionet: Secili raport me rekomandimet e këshillit të caktuar Qeverisë, i drejtohet Qeverisë. Nëse i ka ndërmarrë ato, Qeveria duhet të raportojë mbi cilat masa për zbatimin e rekomandimeve është fjala. Raporti i Qeverisë duhet të përpilohet në afat prej 90 ditëve nga dita e paraqitjes së raportit të këshillit. Raporti i Qeverisë mbi peticionin i paraqitet Dhomës së përfaqësuesve në formën e dokumentit parlamentar (dokument i Qeverisë me të cilin paralajmërohen politikat dhe masat e reja të cilat do të ndërmerren). Mund të shtypet apo të shkarkohet nga ueb faqja e parlamentit.

Peticionet

Çka ndodhë me peticionin kur skadon mandati i Parlamentit?

Pas skadimit të mandatit të Parlamentit të gjitha punët të cilat presin të zgjidhen para Dhomës së përfaqësuesve, përfshirë edhe punën e këshillave të caktuara, vazhdojnë me punën e përbërjes së re të Parlamentit. Nëse peticioni Juaj gjendet para këshillit të caktuar, edhe ai duhet të presë takimin e përbërjes së re, dhe pastaj përbërja e re e parlamentit do të vendosë se a do ta shqyrtojë. Nëse pas ndërrimit të përbërjes peticioni Juaj nuk është shqyrtuar, mund ta përsëritni dërgimin e peticionit të njejtë.

Informacione plotësuese

Në Shtesën 3 gjendet i tërë procesi për bërjen e peticioneve i shkruar sipas radhitjes së ngjarjeve. Nëse keni nevojë për më shumë informacione mbi procedurës, konsultohuni me referentin kryesor në zyrën e gjendjes civile të Dhomës së përfaqësuesve, (04) 471 9999.

Publikimet në faqen e internetit

Zyra e zyrtarëve publikon materiale të ndryshme mbi punën e Parlamentit. Mund t'i gjeni në faqen e internetit www.parliament.nz

Shtesa 1

(Formulari OC 1)

Letra hyrëse – formati i rekomanduar

Dhomës së përfaqësuesve

Dorëzuesi i peticionit: EMRI (JU LUTEMI SHKRUANI QARTË)

ADRESA: (JU LUTEMI SHKRUANI QARTË)

NËNSHKRIMI:

I – SHËNONIN NUMRIN – TË TJERËVE

Me rrespekt kërkojmë:

Që

Shtesa 2

(Formulari OC 2)

Formulari për nënshkrime – formati i rekomanduar

Dhomës së përfaqësuesve

(LISTA E KËRKESAVE)

Ky formular duhet të dorëzohet bashkë me formularin OC 1 apo me formular të ngjashëm drejtuar Dhomës së përfaqësuesve, me emrin dhe adresën e personit i cili merr përsipër gjithë komunikimin e mëtutjeshëm lidhur me peticionin.

Shtesa 3

1. Peticionisti kryesor fillon peticionin, grumbullon nënshkrime dhe nënshkruan peticionin.
2. Zyra e gjendjes civile jep këshilla.
3. Peticionisti hyn në kontakt me anëtarin e Parlamentit i cili do të bëjë paraqitjen e peticionit.
4. Peticioni i dorëzohet zyres së gjendjes civile dhe kontrollohet.
5. Nëse peticioni nuk është në pajtim me rregullat...
6. ...Peticioni i kthehet deputetit/es.
7. Nëse peticioni plotëson të gjitha kushtet formale...
8. Peticioni paraqitet dhe i dorëzohet këshillit të caktuar.
9. Është e mundur që nga peticionisti kryesor nënshkruesit/palët e interesuara të kërkohen dokumente plotësuese.
10. Këshilli shqyrton peticionin.
11. Këshillin Dhoma e përfaqësuesve mund ta informojë mbi peticionin dhe t'i rekomandojë masat të cilat duhet të ndërmerren.
12. Nëse këshilli nuk jep rekomandim...
13. Peticioni përfundon aty?.
14. Nëse këshilli jep rekomandim...
15. ...peticioni i paraqitet Qeverisë.
16. Qeveria është e detyruar që në afat prej 90 ditëve nga paraqitja e rekomandimeve të këshillit, të raportojë mbi masat e ndërmarra (nëse i ndërmerr) me qëllim të zbatimit të rekomandimeve të këshillit.

Ligji mbi peticionet**Ligji mbi procesuimin e peticioneve me ndërmjetësimin e qytetarëve të Bremenit**

Senati – parlamenti i qytetit publikon ligjin vijues të cilin e ka aprovuar parlamenti i qytetit të lirë të Bremenit-parlamenti krahinor:

§ 1 E drejta në peticion

- (1) Gjithkush ka të drejtë që së bashku me të tjerët t'i drejtohet në mënyrë të shkruar parlamentit me kërkesa, ankesa, propozime dhe kritika. Garantohet qasja e së drejtës në peticion pa pengesa në kuadër të Ligjit të Bremenit mbi barazimin e mundësive për personat me invaliditet dhe për atë qëllim rregullat e shpallura ligjore.
- (2) Peticionet mund të jenë të lidhura me kryerjen, gjegjësisht lëshimet në kryerjen e përgjegjësisë së
 1. senatit;
 2. zyrtarëve të komunës krahinore apo të qytetit të Bremenit;
 3. organeve, enteve dhe fondacioneve publike nën mbikqyrjen e komunës krahinore apo të qytetit të Bremenit;
 4. ndërmarrjeve private apo bartësve tjerë të ndërmarrjeve publike me pjesëmarrje shumicë të krahinës apo komunës së qytetit të Bremenit, nëse kryejnë punë publike;
 5. ndërmarrjeve private apo bartësve tjerë të ndërmarrjeve publike nëse janë të kyçur në kryerjen e detyrave publike dhe peticioni ka të bëjë me realizimin e atyre detyrave.
- (3) Personat privat juridik kanë të drejtë në peticion. Personave privat juridik i takon e drejta në peticion nëse peticioni ka të bëjë me lëndën e cila është në kompetencën e tyre objektive.
- (4) Nëse personat janë të vendosur në institucione në të cilat i është marrë e drejta në peticion, peticionet e tyre, pa u kontrolluar, me ndërmjetësimin e udhëheqësisë së atij institucioni, i dërgohen parlamentit. E njëjta vlenë edhe për kthimin e postës atyre personave nga ana e parlamentit.
- (5) Peticioni mund të bëhet në emër të personit të tretë edhe pa urdhërin e personit

të tretë, kur ekzistojnë dëshmi të mjaftueshme mbi ekzistimin e pajtimit të tij/saj dhe kur nuk është në kundërshtim me intereset e atij personi të tretë.

- (6) Askush nuk guxon të jetë i dëmtuar për shkak të shfrytëzimit të së drejtës sipas këtij ligji.

§ 2 Forma e petitionit

- (1) Peticionet mund të bëhen në formë të shkruar apo mund të evidentohen me shkrim në zyrën e këshillit për peticione. Kërkesa duhet të përmbajë të dhënat personale (emrin dhe mbiemrin) të përpiluesit apo përpilueses së kërkesës dhe nënshkrimet e tyre.
- (2) Forma elektronike ka fuqinë juridike të formës së shkruar në rastet kur përmbanë të dhënat personale (emrin dhe mbiemrin) të autorit, adresën postale dhe kur përdoret në mënyrë të plotë formulari i plotësuar i dhënë në internet.

§ 3 Mosndërmarrja e shqyrtimit të kërkesës së petitionit dhe ndëshkimi

- (1) Nga shqyrtimi i kërkesës së petitionit mund të hiqet dorë kur
1. nuk është nënshkruar apo nuk është plotësuar përmes formularit të cilin e ka publikuar parlamenti në internet;
 2. nuk përmbanë emrin dhe mbiemrin dhe adresën e plotë të përpiluesit apo përpilueses së petitionit, apo adresa është e palexueshme;
 3. nuk përmbanë kërkesë konkrete apo kontekst të njohur dhe kuptimplotë;
 4. ka përmbajtje fyese, të dhunshme apo kërkesë joobjektive;
 5. është i drejtuar kundër personit të tretë dhe nuk është bërë në favor të interesit publik;
 6. sipas përmbajtjes apo formës së përmbajtjes apo plotësimit të saj paraqet fyerjen e ligjeve penale;
 7. nuk përmbanë elemente të reja lidhur me peticionin mbi të cilin tanimë është vendosur;
 8. me peticionin kërkohet vetëm informacion.
- (2) Peticionet të cilat bëjnë pjesë në kompetencën e këshillit parlamentar për peticione, këshilli ia përcjellë organeve përgjegjëse nëse këtë e aprovon përpiluesi apo përpiluesja e petitionit.

§ 4 Këshilli për peticione

- (1) Parlamenti krahinor formon këshillin për peticione në nivelin krahinor dhe kuvendi i qytetit formon këshillin për peticione në nivel të qytetit. Që të dy kuvendet zgjedhin anëtarët dhe zëvendësit e anëtarëve të këshillit.

- (2) Peticionet të cilat bëjnë pjesë në përgjegjësinë e qyrtarëve krahinor i zgjidhë kuvendi krahinor. Peticionet të cilat bëjnë pjesë në përgjegjësinë e qytetit i zgjidhë kuvendi i qytetit.
- (3) Të gjitha peticionet duhet dorëzuar këshillit përgjegjës për peticione për procesum.

§ 5 Të drejtat e këshillit për peticione

- (1) Këshilli për peticione apo anëtari i këshillit të cilit i është deleguar zgjidhja e petitionit, mund të dëgjojë personat të cilët dorëzojnë petitionin apo pjesëmarrësit tjerë si dhe të vizitojë personat në vend. Senati dhe zyrtarët krahinor, në kërkesë, duhen gojarisht apo me shkrim ta informojnë këshillin mbi peticione apo anëtarët e këshillit të cilëve i është deleguar zgjidhja e petitionit. Përveç kësaj, anëtari përgjegjës i senatit është i detyruar që në kërkesë të këshillit për peticione t'i japë për shikim aktet apo dokumentet tjera, që në çdo kohë t'i mundësojë qasje institucioneve publike me të cilat udhëheq, t'i kumtojë të gjitha informacionet e nevojshme dhe të ofrojë ndihmën administrative.
- (2) Për organet, institucionet dhe fondacionet publike në mënyrë analoge vlenë paragrafi 1, nëse i nënshtrohen mbikqyrjes krahinore.
- (3) Nëse peticioni ka të bëjë me kryerjen, gjegjësisht lëshimet në kryerjen e detyrave konkrete të ndërmarrjeve publike apo bartësve tjerë të autorizimeve publike, nëse janë të informuar me përmbushjen e detyrave të tyre dhe peticioni ka të bëjë me përmbushjen e atyre detyrave, Senati është i obliguar që këshillit për peticione, në kërkesë, t'i japë informacione gojore apo të shkruara.
- (4) Kur është fjala për peticionet me rëndësi të përgjithshme, këshilli për peticione mund të kërkojë qëndrimin e të dërguarit përgjegjës apo këshillit përgjegjës apo komitetit.
- (5) Qëndrimet, raportet dhe informacionet dorëzohen brenda katër javëve. Ka përjashtime kur, me arsyetimin mbi nevojën e zgjatjes së afatit, mund të aprovohet zgjatja e afatit. Nëse për shkak të natyrës së kërkesës së petitionit do të duhej të veprohet urgjentisht, afati për marrjen e qëndrimit mund të shkurtohet, dhe më së gjati deri në një javë.
- (6) Këshillit për peticione duhet dhënë të dhënat personale të domosdoshme të dorëzuesve dhe dorëzueseve të petitionit si dhe të dhënat personale të personave të tretë të interesuar në procedurë.
- (7) Me rastin e petitionit këshilli për peticione apo anëtari i këshillit të cilit i është deleguar zgjidhja e petitionit mund të vizitojnë burgun hetues apo institucionet

për kryerjen e sanksioneve, si dhe institucionet e punëve sociale dhe të shëndetësisë të krahinës apo kuvendit të qytetit të Bremenit në çdo kohë dhe pa paralajmërim. Prandaj duhet të ekzistojë mundësia që të flitet me cilindo person i cili gjendet aty, pa praninë e të tjerëve si dhe mundësinë e vizitës së të gjitha hapësirave. Anëtari përgjegjës i Senatit duhet të informohet paraprakisht mbi veprat e këtilla të cilat këshilli për peticione, gjegjësisht anëtari i këshillit planifikon t'i ndërmer.

- (8) Nëse gjatë zgjidhjes së petitionit këshilli për peticione vjen deri tek njohuritë të cilat nuk janë të përfshira me kërkesën e dorëzuesit/dorëzueses së petitionit, por të cilat janë ngushtë të lidhur me petitionin, hulumtimi parlamentar mund të zgjerohet edhe në atë segment.

§ 6 Dhënia e të dhënave personale

Këshilli për peticione mundet që, me qëllim të kryerjes së autorizimeve të veta, të dhënat personale t'ia dorëzojë Senatit dhe organeve tjera nëse ekziston supozimi se ekziston pajtimi i dorëzuesit/dorëzueses së petitionit mbi dorëzimin dhe nëse dorëzimi i të dhënave nuk është në kundërshtim me intereset e përgjithshme të personave të dhënat e të cilëve dërgohen, dhe të cilat duhet të mbrohen.

§ 7 Rregullimi i përkohshëm

Nëse kërkesa e petitionit ka të bëjë me masën e ardhshme të drejtpërdrejt, kryerja e të cilës do të pamundësonte apo në shumçka të vështirësonte zgjidhjen e kërkesës, këshilli për peticione, organit i cili ekzekuton masën mund t'i kërkojë shtyerjen e masës.

§ 8 Përpunimi i peticioneve masovike dhe përmbledhëse

- (1) Peticionet masovike janë ato peticione tek të cilat së paku 30 dorëzues dhe dorëzuese i drejtohen parlamentit me kërkesë të njëjtë, kurse si iniciator i petitionit nuk është cekur asnjë person apo grup personash. Peticionet masovike konsiderohen si një petition. Nënshkrueset dhe nënshkruesit shikohen sipas numrit. Informimi individual mbi vendimin e këshillit për peticione mund të zëvendësohet me deklarata për shtypin apo shpallje.
- (2) Peticionet përmbledhëse janë ato peticione tek të cilat parlamentit i drejtohen së paku 30 persona me kërkesë të njëjtë, dhe njëri person apo grup personash paraqitet si autor/autore e petitionit. Mbi përpunimin e petitionit përmbledhës do të informohen autorët/autoret e petitionit. Tek listat me nënshkrime të cilat paraqesin petition në vete, informimi individual do të bëhet me informimin e nënshkruesit apo nënshkrueses së parë, nëse nuk është emëruar personi i cili konsiderohet dorëzues/dorëzuese e petitionit.

§ 9 Peticionet publike

- (1) Peticione publike janë kërkesat me interes të përgjithshëm të drejtuara parlamentit, të cilat me pajtimin e dorëzuesit/dorëzueses mund të publikohen në faqen e internetit të parlamentit. Këto peticione këshillit për peticione mund t'ia dorëzojë çdokush, individualisht apo bashkë me të tjerët, me përdorimin e formularit elektronik të paraparë për këtë qëllim. Me këtë nen nuk është vendosur e drejta në publikimin e peticioneve publike, si i atillë.
- (2) Me publikimin e peticioneve publike, personat tjerë apo grupe personash, përmes internetit kanë mundësinë të nënshkruajnë peticionet apo të japin kontributin e tyre në diskutimin mbi kërkesën e peticionit.
- (3) Peticionet publike përpunohen si një peticion (peticion përmbledhës).
- (4) Peticioni publik, përfshirë edhe arsyetimin e tij, nuk do të lejohet nëse
 1. nuk plotëson kërkesat nga paragrafi 1;
 2. përmbanë kërkesa personale apo fyerje;
 3. fyen dinjitetin njerëzor;
 4. përmbanë qëndrime të gabuara, groteske, diskriminuese, raciste apo fyese;
 5. është kërkesë joobjektive apo përpiluesi i peticionit nisat nga supozimet e gabuara;
 6. thirret në kryerjen e veprave penale apo prishjen e rendit publik dhe rregullave ligjore apo me anë të peticionit kërkohen masa të cilat janë në kundërshtim me rendin kushtetues apo zakonet;
 7. përmbanë informacione të mbrojtura, përzihet në të drejtat personale të personave, si për shembull, me cekjen e emrave, reklamën prodhime komerciale apo veprime apo përmbanë ndonjë reklamë tjetër;
 8. përmbanë linka të cilat çojnë në ueb faqe tjera;
 9. i drejtohet parlamentit në gjuhën e cila shkelë dinjitetin e parlamentit
 10. nuk është i shkruar në gjuhën gjermane.
- (5) Parlamenti mund të tërhiqet nga publikimi i peticionit publik. Kjo sidomos vlenë kur
 1. këshilli për peticione gjatë mandatit ekzistues për një gjë e cila ka lëndë të njejtë apo të ngjashme, ka marrë vendim, por nuk janë theksuar elementet e reja me rëndësi për ndryshimin e vendimit;
 2. peticioni i cili ka kërkesën e njejtë animë ndodhet në shqyrtim parlamentar;
 3. peticioni është shkruar ashtu që të prishë paqen sociale, marrëdhëniet ndërkombëtare apo dialogun ndërkulturor apo
 4. është e qartë që peticioni nuk do të jetë i suksesshëm.

- (6) Për shtesa në diskutimin mbi petitionin publik si dhe nënshkrimet, vlejné kërkesat e njejta analoge si dhe për petitionin.
- (7) Gjatë kohëzgjatjes së nënshkrimit listat me nënshkrime apo forumi i diskutimit mund të mbyllet para skadimit të afatit nëse më nuk sigurohet diskutimi objektiv apo në masë të madhe bëhet e nevojshme shlyerja e shtesave për shkak të shkeljes së rregullave.
- (8) Publiku do të informohet në internet mbi rezultatin e procesimit të petitionit.
- (9) Peticioni i cili nuk është publikuar në procedurën e mëtutjeshme do të trajtohet si petition i cili nuk është publik. Dorëzuesit e petitionit do të informohen në mënyrë adekuatë.

§ 10 Këshillimi mbi lutjet dhe kërkesat e shënuara në petition

- (1) Këshillimet e këshillit për peticione sipas rregullës nuk janë publike.
- (2) Këshilli mund të zgjedhë mbi bërjen publike të këshillimit të tij atëherë kur me këtë nuk shkelen të drejtat apo intereset e personit të tretë dhe kur dorëzuesi gjegjësisht dorëzuesja e petitionit pajtohet me këtë.
- (3) Sipas rregullës, mbi peticionet publike këshillohet në mënyrë publike. Dëgjimet mbi ato lutje dhe kërkesa ndodhin rregullisht në mbledhjen publike.
- (4) Anëtarët e këshillit për peticione dhe gjithë përsinat tjerë të cilët marrin pjesë në procesin petitionues jopublik janë të detyruar që të ruajnë fshehtësitë edhe pas ndërprerjes së detyrës në këshillin për peticione.

§ 11 Rekomandimet përmblyëse

- (1) Këshilli për peticione i parlamentit krahinor përfundon veprimtarinë e tij në rastin e caktuar, përveç se atëherë kur janë përmbushur paragrafet nga neni 3, me rekomandimin e dhënë parlamentit krahinor, kurse këshilli për peticione i kuvendit të qytetit me rekomandimin dhënë kuvendit të qytetit. Rekomandimi përmbanë arsyetim të shkurtër të shkruar, teksti i të cilit duhet të marrë parasyshë intereset e dorëzuesit dhe dorëzueses së petitionit dhe pjesëmarrësve tjerë privat dhe të mos lejojë marrjen e asnjë konkluzioni lidhur me ata persona.
- (2) Rekomandimi vendoset në rendin e ditës së mbledhjes së ardhshme parlamentare, gjegjësisht të kuvendit të qytetit.

§ 12 Vendimet lidhur me kërkesat dhe lutjet e petitionit

- (1) Kuvendi parlamentar mundet
 1. petitionin t'ia përcjellë Senatit me lutje për ndihmë;
 2. të kërkojë nga Senati që dërguesin gjegjësisht dërguesen e petitionit ta informojë qartë dhe në gjuhë të kuptueshme mbi gjendjen juridike dhe objektive të gjërave;

3. këshillit për peticione t'i japë urdhër për përsëritjen e hulumtimit;
 4. të ndërmarrë iniciativë parlamentare;
 5. petitionin ta shpallë të përfunduar;
 6. Ta njohtë Senatin, grupet parlamentare, deputetët apo këshillat profesionale për petitionin;
 7. petitionin ta shpallë të pabazë.
- (2) Nëse peticioni, në pajtim me paragrafin 1 pika 1 e këtij neni, i përcillet Senatit me lutje për ndihmë, ai është i detyruar që në afat prej katër javëve ta informojë mbi atë se çka ka ndërmarrë lidhur me petitionin e dhënë edhe në raste tjera të njejta apo të ngjashme. Nëse Senati nuk i përgjigjet lutjes për ndihmë, senatorja apo senatori përgjegjës, në kërkesë të këshillit për peticione, duhet ta arsyetojë atë në formë të shkruar.
- (3) Diskutimi mbi rekomandimin mbahet para votimit në parlament vetëm atëherë kur atë e kërkon një grup parlamentar.

§ 13 Lajmërimi/Informimi i dërguesit apo dërgueses së petitionit

Kryetari apo kryetarja e këshillit përgjegjës për peticione lajmëron dërgueses apo dërguesin e petitionit mbi vendimin e parlamentit dhe me atë rast jep arsyet më të rëndësishme për atë vendim.

§ 14 Raporti mbi punën e këshillit për peticione

Këshilli përgjegjës për peticione i dorëzon raportin kuvendit parlamentar, gjegjësisht qytetar.

§ 15 Peticionet e papërfunduara

Peticionet të cilat në fund të mandatit ende nuk janë përfunduar, vazhdojnë të përpunohen në mandatin e ardhshëm, pa obligimin e bërjes së kërkesës së re nga ana e dërguesit/dërgueses së petitionit.

§ 16 Procedura

Procedura e veprimit me peticionet rregullohet me rregullën të cilën e vendosë këshilli për peticione.

§ 17 Hyrja në fuqi

- (1) Ligji hyn në fuqi më 1. janar të vitit 2010.
- (2) Njëherit, jashtë fuqisë vendoset Ligji mbi procesuimin e peticioneve i aprovuar nga ana e parlamentit të Bremenit më 26. mars të vitit 1991 me ndryshimet e fundit të bëra më 27. nëntor të vitit 2007.

Kushtetuta e Kalifornisë, Neni II**Paragrafi 1:**

E gjithë fuqia politike është në popullin. Qeveria formohet me qëllim të ruatjes, sigurisë dhe mirëqenies së tij, dhe ai ka të drejtë ta ndërrojë apo ta reformojë kur atë e kërkon e mira e përgjithshme publike.

Paragrafi 2:

Të drejtë vote ka qytetari/ja i Shteteve të Bashkuara i/e cili/a ka më shumë se 18 vjet dhe vendbanim të përhershëm në këtë shtet.

Paragrafi 2.5:

Do të merret parasyshtë vota të cilën e jep votuesi/ja gjatë zgjedhjeve, në pajtim me ligjet e këtij shteti.

Paragrafi 3:

Organi ligjdhënës do të definojë çështjen e vendit dhe do të sigurojë mënyrën e regjistrimit dhe zgjedhjeve të lira.

Paragrafi 4:

Organi ligjdhënës ndalon aktivitetet e parregullta të cilat ndikojnë në zgjedhje dhe siguron diskualifikimin e votuesve të cilët janë mentalisht të paaftë, të burgosur, apo në liri të kushtëzuar për shkak të dënimit për krim.

Paragrafi 5:

- a) Organi ligjdhënës do të kujdeset për zgjedhjet primare për partitë politike përfshirë edhe zgjedhjet e hapura primare presidenciale, kur kandidatët në listë janë aprovuar nga ana e Sekretarit të punëve shtetore, pasi që është vërtetuar se janë respektuar si kandidat për kryetar/e të SHBA anembanë shtetit apo në tërë Kaliforninë, edhe ata emrat e të cilëve janë vendosur në listën e kandidatëve përmes petitionit, me përjashtim të ndonjë kandidati i cili është tërhequr duke dhënë kërkesë të shkruar për tërheqjen e kandidaturës.
- b) Partia politike e cila ka marrë pjesë në zgjedhjet primare për pozitë të caktuar ka të drejtë të marrë pjesë në zgjedhjet e përgjithshme për atë pozitë dhe nuk do t'i pamundësohet që për zgjedhjet e përgjithshme të kandidojë kandidatin i cili ka fituar numrin më të madh të votave në krahasim me të gjithë kandidatët tjerë.

Paragrafi 6:

- a) Të gjitha administratat gjyqësore, shkollore dhe qytetare janë apartiake.
- b) Asnjë parti politike apo komitet qëndror i partisë politike nuk guxon të aprovojë, përkrahë apo ta kundërshtojë kandidatin për ndonjë pozitë apartiake.

Paragrafi 7:

Votimi është i fshehtë.

Paragrafi 8:

- a) Iniciativa është e drejtë e votuesit/es që të propozojë ligje dhe amandmane në Kushtetutën (e Kalifornisë) dhe t'i pranojë apo t'i refuzojë.
- b) Iniciativa mund të propozohet ashtu që Sekretarit të punëve shtetërore i paraqitet teksti i peticionit për ligjin e propozuar apo amandmanin e Kushtetutës, i garantuar me nënshkrim nga ana e një të pestës së votuesve/eve në rastin kur është në pyetje ligji, apo 8 përqind në rastin e amandmanit kushtetues nga numri i përgjithshëm i votuesve të cilët kanë votuar në zgjedhjet paraprake për Guvernator.
- c) Sekretari i punëve shtetërore pastaj, ligjin apo amandmanin e vendosë si propozim për votim në zgjedhjet e ardhshme të cilat nuk mund të mbahen më herët se 131 ditë pas aprovimit për votim apo për cilat do zgjedhje speciale të cilat mbahen në tërë Kaliforninë para zgjedhjeve të rregullta. Guvernatori mund të shpallë zgjedhje të jashtëzakonshme në tërë Kaliforninë për atë iniciativë.
- d) Iniciativa e cila merret me më shumë se një temë nuk mund të vëhet në votim apo të ketë ndonjë efekt.
- e) Masat e futura dhe të parapara me iniciativë të caktuar nuk do të aplikohen në mënyrë selektive në territoret e ndryshme të shtetit, varësisht nga përqindjet e fituara të votave për iniciativën e caktuar në territorin e dhënë, por do të aplikohen në mënyrë të barabartë.
- f) Iniciativa nuk do të përmbajë dispozita alternative apo kumulative ku një apo më shumë dispozita të këtilla do të bëhen ligj varësisht nga përqindja e votave për apo kundër masës së dhënë.

Paragrafi 9:

- a) Referendumi është e drejtë e votuesve/seve që të aprovojnë apo të refuzojnë ligjet apo pjesët e ligjeve, përveç ligjeve urgjente, ligjeve për shpalljen e zgjedhjeve, apo ligjeve me të cilat rregullohen tatimet në pronë apo financat për shpenzimet e rregullta të shtetit.

- b) Pyetja e referendumit bëhet me anë të bërjes së petitionit Sekretarit të shtetit, në të cilin është dhënë teksti i ligjit të propozuar apo amendmanit kushtetues dhe i cili në mënyrë të garantuar është nënshkruar nga ana e një të pestës së votuesve/ seve në rastin kur është në pyetje ligji, apo 8 përqind në rastin e amendmanit kushtetues në krahasim me numrin e përgjithshëm të votuesve të cilët kanë votuar në zgjedhjet e kaluara për Guvernator.
- c) Sekretari i punëve shtetërore pastaj e vendosë propozimin si pikë për votim në zgjedhjet e ardhshme të cilat mbahen jo më herët se 31 ditë pas aprovimit të propozimit për votim apo për të cilat do të shpallen zgjedhje speciale të cilat mbahen anembanë Kalifornisë para zgjedhjeve të rregullta. Guvernatori për atë propozim mund të shpallë edhe zgjedhje të jashtëzakonshme anembanë Kalifornisë.

Paragrafi 10:

- a) Iniciativa ligjore apo referendumi të cilin e voton shumica e votuesve/eve hyn në fuqi një ditë pas zgjedhjeve përveç se në rastin kur vet propozimi nuk rregullon çështjen e hyrjes në fuqi në mënyrë tjetër. Nëse peticioni për referendum është i shkruar në mënyrë që të ndryshojë një pjesë të ligjit të caktuar, mbetja e ligjit do të hyjë në fuqi menjëherë.
- b) Në qoftë se dispozitat e dy apo më shumë propozimeve të cilat kanë kaluar në votim kundërshtohen, do të merret parasyshë ai propozim i cili ka fituar më shumë vota.
- c) Organi ligjdhënës mund të ndryshojë apo të tërheqë ligjet e miratuara me anë të referendumit. Poashtu mund të ndryshojë apo të tërheqë ligjet e miratuara me anë të iniciativave me aprovimin e ligjit të ri i cili hyn në fuqi pasi të miratohet nga ana e votuesve në votim, përveç se në rastin kur vet ligji i aprovuar me iniciativë nuk lejon amendmanë apo tërheqjen e ligjit pa pranimin paraprak të votuesve.
- d) Para se të fillohet me grumbullimin e nënshkrimeve për iniciativë apo referendum, një kopje i dorëzohet prokurorit shtetëror i cili, siç e parasheh ligji, cakton emrin dhe përshkrimin e propozimit.
- e) Organi ligjdhënës do të rregullojë mënyrën në të cilën grumbullohen nënshkrimet, si do të paraqitet dhe të vërtetohet peticioni dhe si do t'i paraqitet propozimi votuesve.

Paragrafi 11:

- a) Të drejtën në iniciativë apo referendum votuesit/et mund ta praktikojnë në çdo qytet apo rreth, sipas rregullave të cilat do t'i caktojë organi ligjdhënës. Përveç

se në rastet e dhëna nën b) dhe c) ky paragraf nuk ka të bëjë me qytetet të cilat kanë kartën.

- b) Iniciativa e cila ka të bëjë me ndonjë qytet apo rreth nuk do të përfshijë apo përjashtojë cilëndo pjesë të qytetit apo rrethit në krahasim me aplikimin e masave apo efekteve të rregullave, në bazë të aprovimit apo mosaprovimit të iniciativës, apo në bazë të përqindjes së caktuar të votave të cilat përkrahin iniciativën nga ana e trupit votues në qytet apo rreth, apo në cilëndo pjesë të tyre.
- c) Iniciativa e cila ka të bëjë me ndonjë qytet apo rreth nuk do të përmbajë dispozita kumulative apo alternative ku një apo më shumë dispozita të këtilla do të bëhen ligj varësisht nga përqindja e votave për apo kundër masës së dhënë.

Paragrafi 12:

Trupit votues apo trupit ligjdhënës, përmes iniciativës, nuk do t'i jepen në votim apo të kenë çfardo efekti amandmanet në Kushtetutë apo propozimet ligjore të cilat i dhurojnë individit/es funksion, apo emërojnë apo identifikojnë cilëndo kompani private në kryerjen e ndonjë funksioni publik apo marrjen e fuqisë apo detyrës.

Paragrafi 13:

Revokimi është e drejtë e votuesve/eve që të revokojnë zyrtarin e zgjedhur.

Paragrafi 14:

- a) Procesi i revokimit të zyrtarit shtetror (të Kalifornisë) fillon me dorëzimin e petitionit Sekretarit të punëve shtetore, në të cilin ceken arsyet për revokim. Vlefshmëria e arsyeve të dhëna nuk merret në shqyrtim. Është aprovuar afati prej 160 ditëve për grumbullimin e nënshkrimeve.
- b) Peticionin për revokimin e zyrtarit shtetror (të Kalifornisë) duhet ta nënshkruajnë 12 përqind e trupit votues në krahasim me numrin e votave të përgjithshme të dhëna për atë pozitë në zgjedhjet paraprake; poashtu është e domosdoshme që në të gjitha 5 rrethet të grumbullohet 1 përqind e nënshkrimeve në krahasim me numrin e nënshkrimeve të përgjithshme për atë pozitë në zgjedhjet e kaluara. Numri i nënshkrimeve për revokimin e senatorit, anëtarëve/eve të Kuvendit, anëtarëve/eve të Këshillit për tatime, dhe gjyqtarëve të gjyqeve të shkallës së dytë dhe shkallës së parë duhet të përbëjë 20 përqind të numrit të përgjithshëm të votave për atë pozitë në zgjedhjet e kaluara.
- c) Sekretari i punëve shtetore do të përcjellë numrin e përgjithshëm të nënshkrimeve të vërtetuara të cilat i ka marrë ajo zyre.

Paragrafi 15:

- a) Votimin për revokimin e zyrtarit publik dhe, nëse është e nevojshme, votimin e

zyrtarit të ri, e shpallë guvernatori dhe ai do të mbahet brenda afatit prej 60 deri 80 ditëve nga data kur janë vërtetuar të gjitha nënshkrimet e nevojshme.

- b) Votimi për revokim mbahet brenda afatit prej 180 ditëve nga dita kur është vërtetuar numri i nevojshëm i nënshkrimeve, në mënyrë që të mund të mbahet në kohën e njejtë kur edhe zgjedhjet e ardhshme të rregullta, plotësisht apo pjesërisht në fushën e njejtë, ku planifikohet votimi për revokim, edhe atë vetëm në rastin kur dalja e paralajmëruar e votuesve/eve të regjistruar është së paku 50 përqind e trupit votues të përgjithshëm i cili ka të drejtë të marrë pjesë në votimin për revokim.
- c) Nëse shumica voton për revokim, zyrtari shkarkohet nga funksioni, dhe nëse ka kandidatë për ta zëvendësuar atëherë kandidati me numrin më të madh të votave vjen në pozitën e zyrtarit të shkarkuar. Vet zyrtari/ja revokimi i të cilit votohet, nuk mund të jetë mes kandidatëve të rinj për atë funksion, dhe nuk do të kandidohet për ndonjë funksion në pajtim me nënparagrafin d) Paragrafi 16, Neni VI.

Paragrafi 16:

Organi ligjdhënës rregullon mënyrën e distribuimit, dokumentimin, vërtetimin e nënshkrimeve, kandidaturat, dhe votimin për revokim.

Paragrafi 17:

Nëse është inicuar revokimi i Guvernatorit apo Sekretarit të punëve shtetore, të gjitha punët lidhur me obligimet e realizimit të procesit të revokimit, të cilat sipas rregullës i kryejnë këto dy funksione, i merr përsipër zëvendësi apo mbikqyrësi kryesor financiar, varësisht nga punët.

Paragrafi 18:

Zyrtarit të shtetit (të Kalifornisë) i cili nuk është revokuar me votim, shteti do t'ia kompenzojë shpenzimet të cilat i ka bartur personalisht dhe juridikisht. Revokimi i ardhshëm për zyrtarin e dhënë nuk mund të kërkohet më herët se gjashtë muaj pas votimit.

Paragrafi 19:

Organi ligjdhënës rregullon revokimin e zyrtarëve lokal. Ky paragraf nuk ka të bëjë me rrethet dhe qytetet me karta të cilat rregullojnë këtë çështje.

Paragrafi 20:

Mandatet e pozitave të votuara të cilat i rregullon kjo Kushtetutë, përveç se për anëtarët e trupit ligjdhënës, fillojnë të hënë e parë pas 1 janarit pas zgjedhjeve. Zgjedhjet do të mbahen gjatë vitit të fundit çift para skadimit të mandatit.

http://ballotpedia.org/wiki/index.php/Article_II,_California_Constitution

Qytetërimi dhe reforma e shkollimit – unë, e imja, mua

Solidaritet? Me shumë dëshirë, por vetëm në teori – në praktikë, qytetërimi liberal megjithatë nuk do të sakrifikojë më me dëshirë fëmijët për të mirën e përgjithshme shoqërore.

Fëmiu i ka gjashtë vjet. Prindërit e tij – ajo profesoreshë e gjimnazit, ai inzhener – u hamendën një kohë të gjatë. Megjithatë, në fund vendosën që të shpërngulen nga Gizingu (Giesing), lagje punëtore e Minhenit me përqindje të madhe të emigrantëve.

Banasa e re gjendet në një lagje ku familjet e vendosura mirë jetojnë në shtëpi të bukura ku edhe shokëve dhe shoqeve të ardhshme të klasës në mbrëmje para fjetjes i lexohen tregime, dhe ku është e zakonshme që pasardhësit të vijnë shkollat e muzikës dhe kurset e artit. Shoqëria, siç ceket në arsyen e shpërnguljes, duhet të bëhet më e mirë, më e barabartë dhe më e drejtë, por jo në llogari të fëmiut tim.

Vendimi i qytetareve dhe qytetarëve për referendum në Hamburg nuk paraqet zgjidhje të problemit të këtij qyteti liman, por shprehje ilustruese e konflikteve të cilat kanë të bëjnë me shoqërinë në tërësi, dhe janë kërcënim afatgjatë për strukturën sociale. Është fjala për çështjen fundamentale të së drejtës, sjelljes ndaj të dobëtve dhe barazpeshën e vërtetë mes lirisë personale dhe barazisë. „Drejtësia në arsim është përgjegje në pyetjen mbi drejtësinë në shoqërinë tonë“, tha ministresha e arsimit Anete Shavan (Anette Schavan) më herët gjatë një fjalimi. Dhe pikërisht për këtë është fjala në Hamburg – për mënyrën shumë konkrete të jetës.

Në qytetin liman votuan qytetarët dhe qytetarët edhe atë para së gjithash qytetërimi i pasur, i arsimuar nga pjesët e pasura të qytetit. Të tjerët nuk u paraqitën në votim, nuk treguan interesim apo ndoshta nuk kuptuan që po negociohej pikërisht për ardhmërinë e fëmijëve të tyre. Mobilizimi pati sukses për ata të cilët kanë të ardhura më të mira.

Qytetërimi i arsimuar, pra, pati sukses në kërkesën që djemtë dhe vajzat e tyre të mos mësojnë më shumë se sa që është e nevojshme me – nga perspektiva e tyre – nxënësit dhe nxënëset më të dobëta, më të varfëra dhe me nota më të këqija në klasë – në vend se të mësojnë së bashku gjashtë vjet, siç është e paraparë, fëmijët në Hamburg do t'i kalojnë bashkë në shkollë edhe më tutje vetëm katër vite shkollore.

Për atë arsye qytetërimi i arsimuar, i cili gjatë zgjedhjeve në masë të madhe votoi për koalicionin zi-gjellbër, tani lufton kundër asaj për të cilën është përcaktuar koalicioni?

Përgjegjja është njëherit e thjeshtë dhe e komplikuar: akademikët e Hamburgut përkrahin integrimin e të huajve, mundësitë e njejta arsimore dhe drejtësinë sociale, mirëpo vetëm derisa ata vetë të mos i bartin shpenzimet, apo derisa ato shpenzime të llogariten paraprakisht.

Qytetërimi i arsimuar është i gatshëm që në repartin e supermarketit me ushqim organik të paguajë çmimin e dyfishtë për copën e mishin nëse derri ka pasur një jetë të bukur. Mirëpo, nuk do t'i sakrifikojnë fëmijët e tyre për të mirën e përgjithshme.

Shkolla fillore në kohëzgjatje prej gjashtë vitesh do t'i përgjigjej, para së gjithash, më të dobëtve – ky është koncensus. Frika e cila ka kapluar qytetërimin e arsimuar bazohet në atë që më të dobët socialisht dhe materialisht prap do t'ua kufizojnë mundësitë fëmijëve të tyre – që djemtë dhe vajzat e tyre do të mësojnë më ngadalë për arsye se i frenojnë fëmijët e emigrantëve.

Përkthyer nga teksti i Zarina Pfaut (Sarina Pfauth)
20.07.2010.

1. Vendosja e kornizës juridike me anë të së cilës vendosen mekanizmat për procesimin e peticioneve dhe propozimeve tjera:
 - a) Format e defnuara qartë për bërjen e peticioneve dhe propozimeve – peticione të shkruara, gojore dhe elektronike;
 - b) Elementet e domosdoshme të peticioneve dhe propozimeve të defnuara qartë, të nevojshme për identifikimin e dorëzuesit, në pajtim me standardet e arritura demokratike në fushën e së drejtës në privatësi;
 - c) Elementet e domosdoshme të defnuara qartë të kërkesës nga peticioni apo propozimi
 - d) Afatet për procesim;
 - e) Obligimi i dërgimit të përgjegjes dorëzuesve të peticioneve, gjegjësisht propozimeve tjera;
2. Ekzistimi, gjegjësisht formimi i trupave të posaçëm në organet përfaqësuese në të gjitha nivelet e pushtetit për shqyrtimin e peticioneve dhe propozimeve tjera.
3. Vendosja e bashkëpunimit dhe mekanizmit efikas të këmbimit të informacioneve mes trupave të posaçëm në organet përfaqësuese të të gjitha niveleve të pushtetit:
 - a) Këmbimi i informacioneve mbi shqyrtimin e peticioneve dhe propozimeve tjera mes trupave republikan dhe krahinor,
 - b) Gjegjësisht këmbimi i informacioneve të trupave republikan dhe trupave në organet e njësisë së qeverisë lokale dhe
 - c) Këmbimi i informacioneve të trupave krahinor dhe trupave në organet e njësisë së qeverisë lokale nga territori i krahinës);
4. Vendosja e bashkëpunimit dhe mekanizmit efikas për këmbimin e informacioneve mes trupave të posaçëm në organet përfaqësuese të të gjitha niveleve të pushtetit dhe trupave të pavarur (mbrojtësi i qytetarëve në nivelin republikan dhe nivelin lokal, agjencioni për luftën kundër korrupsionit etj.).
5. Trupat e posaçëm në organet përfaqësuese duhet të veprojnë me qëllim të informimit të publikut të gjerë mbi ekzistencën e tyre, kompetencat dhe arritjet.

6. Përpunimi analitik i informacioneve me qëllim të identifikimit të problemeve kryesore dhe prioriteteve (për paraqitjen para trupit përfaqësues).
7. Trupat e posaçëm duhet rregullisht dhe publikisht ta informojnë trupin përfaqësues mbi punën e tyre.
8. Trupat e posaçëm duhet të stimulojnë qytetarët që të dorëzojnë peticione dhe propozime në mënyrë elektronike (përmes faqes së tyre të internetit).
9. Trupat e posaçëm duhet të ndërtojnë bashkëpunim efikas me sektorin joqeveritar (këmbimi i informacioneve profesionale, këmbimi i informacioneve mbi problemet shoqërore të cilat i kanë identifikuar organizatat joqeveritare).